

**PËRMBLEDHJE E
VENDIMEVE TË
KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

2024

PËRMBAJTJA

I.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJEVE FETARE	5
1.	Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit” kundër Pastorit të Kishës Evangjeliste P.V.,.....	5
2.	D.S., kundër Z.B., në cilësinë e punëdhënësit dhe V.N., në cilësinë e drejtores së Shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”, Shkodër.	9
3.	A.D., kundër Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë.	12
II.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE	15
4.	B.Ç., kundër Bashkisë Kavajë.....	15
5.	A.Xh., kundër Bashkisë Gramsh.....	18
6.	M.B., kundër Bashkisë Kavajë.....	21
7.	L.Z., kundër Bashkisë Shkodër	23
8.	M.C., kundër Bashkisë Kavajë.....	26
9.	A.Ll., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë.	28
10.	B.R., kundër Bashkisë Kavajë.....	32
11.	M.H., kundër Bashkisë Shkodër	35
12.	E.R., kundër Bashkisë Shkodër.....	38
13.	I.Sh., kundër Shoqërisë Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a.....	42
14.	L.Ll., kundër Bashkisë Lezhë.....	46
15.	G.K., kundër Shoqërisë Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a.....	49
III.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE	52
16.	N.Sh., si përfaqësuese ligjore e vajzës së saj minorene, A.Sh., kundër Bashkisë Korçë.....	52
IV.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË DHE SHTATZËNISË	57
17.	K.V., kundër Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a., (UKT).....	57
18.	S.S., kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”	60
19.	M.Rr., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit	65
V.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQËRORE.....	68
20.	A.A., kundër Përgjegjësit të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZV ASHK) Tropojë	68
21.	G.B., kundër Fondacionit “Save the Children Albania”	72
VI.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR	77

22.	J.H., kundër Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Zyrës Vendore Arsimore Tiranë	77
23.	M.H., kundër Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë.....	81
24.	Shoqata “Shpresë për të verbërit”, kundër Bashkisë Tiranë	85
25.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Tirana Parking	89
26.	V.D., dhe V.K., kundër Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë së Transportit “Llixha 2001” sh.p.k..	93
27.	M.S., kundër H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ dhe Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k..	96
28.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Njësisë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin..	99
VII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS DHE ETNISË.....	103
29.	D.B., kundër DVASHK Shkodër	103
30.	R.H., kundër Emisionit “Xhadat”, (MCN TV)	106
31.	F.Ll., kundër Bashkisë Kavajë	109
VIII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES FAMILJARE.....	113
32.	M.Z., në cilësinë e përfaqësueses ligjore të nipërve të saj E., dhe E.Z., kundër Bashkisë Tiranë	113
IX.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË.....	117
33.	Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë kundër Gardës së Republikës	117
X.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE.....	120
34.	J.M., kundër OST sh.a.....	120
XI.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR.....	125
35.	D.D., kundër D.B., Kryetar i Komisionit të Konkurrencës	125
36.	A.B., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k., L.Xh., dhe F.B.	131
37.	L.M., kundër Inspektoratit Shtetëror, Teknik dhe Industrial	134
38.	H.M., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.	137
39.	A.P., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.....	141
XII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMEN NDËRSEKTORIALE	145
40.	Z.T., kundër FSDKSH, MSHMS	145
41.	K.A., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Lezhë.....	150

42.	V.Xh., kundër Kopshtit Nr. 2, Tiranë dhe Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve/Bashkia Tiranë.....	154
-----	--	-----

Parathënie

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një organ publik i pavarur, i cili ka për funksion garantimin e zbatueshmërisë së Ligjit Nr. 10 221 datë 04/02/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Një ndër kompetencat më të rëndësishme që ky institucion ka, është ai i trajtimit të ankesave që mbërrijnë nga individë, grupe individësh dhe organizata të shoqërisë civile me qëllim konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e sjelljes diskriminuese të konstatuar.

Komisioneri mund të ngrejë edhe çështje kryesisht ose *ex officio*, si dhe ka të drejtë të vendosë sanksione administrative kundrejt subjekteve që nuk zbatojnë vendimet që kanë konstatuar diskriminim.

Qëllimi i kësaj përmbledhje vendimesh të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është që t’i shërbejë publikut të gjerë për ta informuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni, por sidomos edhe për t’a udhëzuar atë mbi shkaqet, format dhe fushat e diskriminimit me qëllim për një kuptueshmëri më të mirë të tyre.

Përmbledhjet e vendimeve janë hartuar në mënyrë të tillë që të japin aspektet më thelbësore të vendimit, por sigurisht për një hulumtim më të thellë do të nevojitej konsultimi i tyre në tërësi. Gjithashtu, funksioni i përmbledhjes së vendimeve ka për qëllim edhe të lehtësojë gjetjen e tyre sipas interesit të subjekteve, në faqen *web* të institucionit ku publikohen të gjitha vendimet.

Së fundmi, qëllim specifik është ai i nxitjes së operatorëve të së drejtës, juristë, avokatë, gjyqtarë, lektorë, studiues, studentë, punonjës administrate që të konsultojnë këto vendime për njohjen e praktikës së maturuar prej 10 vjetësh nga institucioni por, edhe për të shprehur sensin e tyre kritik mbi kuptimin dhe arsyeshmërinë e vendim-marrjes, si dhe të nxitjes së debatit juridik, social dhe politik mbi të drejtat e njeriut e më specifikisht të parimit të barazisë dhe atij të mosdiskriminimit.

Uroj që kjo përmbledhje të shërbejë për qëllimin e saj dhe të jetë një mjet i dobishëm për çdokënd të interesuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

PhD Robert Gajda

I. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJEVE FETARE

1. Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit” kundër Pastorit të Kishës Evangjeliste P.V.,

VENDIM NR. 23, DATË 19.01.2024

Shkaku: Bindjet fetare
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit” dhe komuniteti fetar që ata përfaqësojnë, janë diskriminuar si pasojë e gjuhës së urrejtjes të përdorur nga Pastori P.V., për shkak të bindjeve fetare.

FAKTET

Më datë 18.05.2023, në televizionin Euronews Albania, është transmetuar emisioni “Good Morning Albanians”, me tematikë “*Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për lirinë fetare*”. Në këtë emision ishin pjesëmarrës disa përfaqësues të komuniteteve fetare në Shqipëri, ndër ta edhe P.V.

Nga subjekti ankues, është pretenduar se gjatë bisedës së zhvilluar dhe shprehjes së mendimeve nga ana e P.V., janë përdorur deklarata shpifëse dhe me një gjuhë urrejtjeje kundër Shoqatës së DJ dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë.

Pikërisht për sa më lart, subjekti ankues, Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri”¹, ka paraqitur ankesë kundër P.V., ku pretendohet për diskriminim në formën e “*gjuhës së urrejtjes*”, për shkak të bindjeve fetare. Ndërsa sa i përket emisionit “Good Morning Albanians”, transmetuar në televizionin Euronews Albania, shoqata theksoi se nuk do ta shqyrtonte në kuadër të kësaj ankese, pasi do ta ndiqte në organe të tjera ligjzbatuese.

Sipas informacionit të dhënë nga subjekti ankues, Shoqata, në emisionin “Good Morning Albanians” të datës 18.05.2023, të transmetuar në televizionin Euronews Albania, i cili kishte si tematikë diskutimi “*Raportin e DASH për lirinë fetare*”. Duke ju referuar përmbajtjes së diskutimeve, P.V., ndër të tjera, në fjalën e tij thekson se Dëshmitarët e Jehovahit janë një sekt satanik, i rrezikshëm, anti Krisht dhe për shkak të predikimeve të tyre ata kanë shkuar deri në vetëvrasje. Në këtë kuptim, Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit” dhe komuniteti fetar që ata përfaqësojnë, portretizohen si persona të cilët paraqesin rrezik për besimtarët e tyre dhe shoqërinë në tërësi.

¹ Në vijim referuar edhe si Shoqata.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “*Gjuhën e urrejtjes*” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave);
- Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132);
- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 22, Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e 48 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Lidhur me shprehjet dhe gjuhën e përdorur nga P.V., në emisionin “Good Morning Albanians”, të datës 18.05.2023, Komisioneri analizoi regjistrimet e bëna në dispozicion përmes CD-së nga autoriteti përkatës që mban dhe autorësinë e këtij materiali, televizioni Euronews Albania.

Gjuha e përdorur nga P.V., është përcjellë në një kontekst të një debati të lindur si pasojë e diskutimit të një tematike krejtësisht tjetër, atë të Raportit të DASH për lirinë fetare. Komisioneri theksoi se gjuha e përdorur mund të nxisë komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “*Youtube*”, “*Facebook*”, etj., komente të cilat mund të jenë fyese, paragjyquese, denigruese dhe krejtësisht të papërshtatshme.

Duke qenë një Pastor i njohur dhe mbrojtës i shumë kauzave në shoqëri, P.V., ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Në mënyrë të veçantë rezultojnë se P.V., është person shumë aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij, ai mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet e ndryshme. Pavarësisht qëllimit, perceptimi që shkon tek publiku mund të jetë krejt ndryshe, sidomos kur ata portretizohen negativisht.

Komisioneri gjykoi se referimi i P.V., cituar më lart në këtë vendim, përbën një qëndrim jo profesional, jo informues, paragjyqës dhe nga ana tjetër krijon negativitet kundrejt një grupi specifik shoqëror që janë besimtarët e Dëshmitarëve të Jehovait duke i shqetësuar ato dhe duke

krijuar premisa për sjellje diskriminuese kundërt tyre. Gjithashtu, vlerësoi se, gjuha e përdorur nga P.V., krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovahit” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë.

Edhe pse deklaratat e bëra nga P.V., nuk drejtohen kundër individëve të caktuar, besimtarët e Dëshmitarëve të Jehovahit në Shqipëri, portretizohen dhe etiketohen si modele negative vetëm për shkak të besimit apo bindjeve të tyre fetare. Këto deklarata edhe pse nuk janë një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohen si deklarata që nxisin urrejtje. Pavarësisht qëllimit për të cilin janë thënë dhe pavarësisht se nuk i janë drejtuar një personi të caktuar, mënyra se si manifestohet një mendim i P.V., të cilat portretizojnë negativisht një grup shoqëror, perceptohet dhe portretizon Shoqatën “Dëshmitarët e Jehovahit” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, negativisht.

Komisioneri theksoi se, Shoqata dhe komuniteti fetar që ata përfaqësojnë janë portretizuar dhe etiketuar si modele negative edhe në të shkuarën, kur në muajin Korrik të vitit 2020, 2 (dy) anëtare të një familje u gjetën pa jetë në banesën e tyre, në zonën e ish Kombinatit në Tiranë, duke u evidentuar si pjesë e Shoqatës. Për shkak të dezinformimit mediatik dhe informacioneve të pavërteta kjo shoqatë dhe besimtarët e saj u etiketuan në mënyrë negative duke u stereotipizuar dhe stigmatizuar në opinionin publik.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga P.V., përbën gjuhë urrejtje kundër Shoqatës dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, për shkak të bindjeve fetare. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovahit” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, për shkak të bindjeve fetare nga P.V., në emisionin “Good Morning Albanians”, mbajtur më datë 18.05.2023, në televizionin Euronews Albania.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, P.V., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovahit” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, si dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.

- Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Euronews Albania², rekomandohet të marrë masa të menjëhershme për eliminimin/mbulimin e shprehjeve diskriminuese të përdorura nga P.V., në emisionin “*Good Morning Albanians*” të transmetuar më datë 18 maj 2023 apo pjesëve të shkurtuara të publikuara në faqen www.youtube.com apo rrjete të tjera sociale të cilat i administron, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijeni mbi këtë vendim.

² Shoqëria “Euro Balkans News” sh.p.k.

2. D.S., kundër Z.B., në cilësinë e punëdhënësit dhe V.N., në cilësinë e drejtores së Shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”, Shkodër.

VENDIM NR. 123, DATË 30.04.2024

Shkaku: Bindjet fetare
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Komunitetin Shën Françesk Saveri, Gjinnazi Privat “Atë Pjetër Meshkalla”³. Asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjes fetare.

FAKTET

Ankuesja D.S., ka hyrë në marrëdhënie pune me Komunitetin Shën Françesk Saveri, Gjinnazi Privat “Atë Pjetër Meshkalla”⁴ me anë të kontratës individuale të punës, për periudhën kohore 15.09.2014 - 30.06.2015, si mësuese matematike, part time me 9 orë/javë. Sipas deklarimit të palëve, kontrata e punës është rinovuar çdo vit shkollor me të njëjtat kushte. Në datë 01.09.2022, mes palëve është nënshkruar kontrata individuale e punës me afat 1 vjeçar, deri në datë 31.08.2023. Në bazë të kontratës së punës, rezulton se ankuesja do angazhohej për vitin shkollor 2022-2023, si mësuese në lëndën matematikë dhe mësuese kujdestare, me ngarkesë mësimore 22 orë/javë.

Në datë 31.05.2023, mes ankuses dhe drejtores së shkollës është zhvilluar një takim lidhur me ndryshimin e kontratës së punës, në të cilën do të bëhej ulja e ngarkesës mësimore në 14 orë/javë, për vitin mësimor 2023-2024. Me e-mailin datë 12.06.2023, ankuesja ka komunikuar me drejtuesit e shkollës në të cilin i ka vënë në dijeni se nuk e pranon kontratën e re me 14 orë mësimore, për në shtator 2023. Është pranuar nga të dyja palët në këtë proces, (ankuses/punëmarrëses dhe Komunitetit Shën Françesk Saveri/punëdhënësit), se mes tyre ka patur mosmarrëveshje lidhur me ndryshimin e ngarkesës mësimore dhe të kontratës së punës, të D.S., për vitin shkollor 2023-2024.

Ankuesja kundërshton arsyet e mosrinovimit të kontratës së punës dhe pretendon se e gjithë situata në punë ka ndodhur pas emërimit të drejtores V.N., (15 korrik 2022), për shkak të bindjes fetare, pasi nuk ka marrë pjesë në aktivitetin, tërheqje shpirtërore për nxënësit dhe në takimin e formimit injacian, duke shpjeguar se që nga fillimi i marrëdhënieve të punës në shkollë ka zbatuar me korrektësi detyrat e ngarkuara dhe nuk ka pasur asnjëherë vërejtje nga drejtuesit e shkollës.

³ Në vijim do i referohemi si “shkolla”.

⁴ Në vijim do i referohemi si “shkolla”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolli 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020 i MAS *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*.

KONKLUZIONE

Mbështetur në provat e administruara, Komisioneri konstatoi se, ankuesja ka filluar punë si mësuese e lëndës matematikë në shkollën *“Atë Pjetër Mëshkalla”*, Shkodër në vitin 2014 dhe në vitin 2015 ajo është promovuar duke u bërë mësuese me ngarkesë të plotë mësimore. Nga viti 2015 deri në vitin 2023, janë rreth 8 vite që ankuesja punon si mësuese në këtë shkollë. Gjatë kësaj periudhe ankuesja nuk ka pasur masa disiplinore, ka qenë e angazhuar si mësuese kujdestare dhe ka qenë kryetare e mësuesve të gruplëndës së matematikës. Komisioneri vlerësoi se, gjatë kësaj kohe, shkolla ka patur kohë të mjaftueshme për të vlerësuar etikën dhe disiplinën në punë të ankuses në raport me institucionin. Vetëm vitin e fundit shkollor, kur V.N., është emëruar drejtoreshë, nga ana e punëdhënësit u vunë re shkelje të kushteve të kontratës nga ana e D.S., dhe u vendos mosrinovimi i kontratës së punës me ngarkesë të plotë mësimore.

Ankuesja ka deklaruar se gjatë vitit shkollor 2022-2023 nuk ka marrë pjesë në aktivitetin, tërheqje shpirtërore për nxënësit dhe në takimin e formimit injacian.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

- Ankuses i është mohuar e drejta për t’u njohur, dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, para se të merrej masa disiplinore, lidhur me moskryerjen e detyrave dhe moszbatimin e kushteve të kontratës nga ana e saj dhe masa disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”*.
- Punëdhënësi nuk arriti të provojë se kishte dhe mësues të tjerë të cilëve i ishte ndryshuar kontrata e punës për arsye si të ankuses dhe datën kur ishin nënshkruar kontratat e punës me mësues të tjerë.
- Ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm, duke mos i rinovuar kontratën e punës.
- Mosrinovimi i kontratës së punës me ngarkesë të plotë mësimore dhe mospërzgjedhja si mësuese kujdestare, ka sjellë pasoja të pavaforshme për ankuesen në lidhje me pagën por

edhe në raport me vazhdueshmërinë e marrëdhënies së punës, e cila kushtëzohet nga ngarkesa mësimore që ka një mësues.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstatoi se, nisur nga dinamika e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre, pasojat negative vetëm për subjektin ankues nga ana e punëdhënësit, i kanë ardhur pasi nuk ka marrë pjesë aktivitetin, tërheqje shpirtërore për nxënësit dhe në takimin e formimit injacian, aktivitete fetare të cilat janë të parashikuara në kalendarin e aktiviteteve të shkollës të cilat janë pjesë dhe të misionit fetar të gjimnazit “Atë Pjetër Mëshkalla” të cilat zhvillohen jashtë procesit mësimor.

Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioneri vlerësoi se, provohej plotësisht se vendimi i punëdhënësit për të mos i rinovuar kontratën e punës me ngarkesë të plotë arsimore ankueses i ka ardhur si rezultat i mosmarrjes pjesë të ankueses në aktivitetet fetare që organizon shkolla.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri konstatoi se Z.B., në cilësinë e punëdhënësit dhe V.N., në cilësinë e drejtores së shkollës, kanë diskriminuar subjektin ankues në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes fetare të ankueses.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të subjektit ankues D.S., në të drejtën për punësim, për shkak të “bindjes fetare”, nga ana e Z.B., në cilësinë e punëdhënësit dhe V.N., në cilësinë e drejtores së shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”, Shkodër.

3. A.D., kundër Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë.

VENDIM NR. 153, DATË 24.05.2024

Shkaku: Bindjet fetare
Forma: Diskriminim në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi është diskriminuar nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë, duke mos e lejuar për të ndjekur praktikën e tij fetare të faljes në xhami, ditëve të premte, për rreth 2 orë, duke e privuar nga e drejta për ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë përmes kryerjes së riteve fetare.

FAKTET

Mbështetur në informacionin e administruar, A.D., është punonjës i Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, si dhe praktikant i fesë islame. Që nga emërimi i tij në punë, ka patur mirëkuptimin e eprorëve, siç theksohet edhe nga palët, për të ndjekur praktikën e tij fetare të faljes në xhami, çdo ditë të premte, si dhe duke u zëvendësuar gjatë këtij orari nga kolegë të tjerë.

Prej rreth 3 vitesh, që nga emërimi i D.D., si Administrator i Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, A.D., ka vijuar normalisht të ndjekë praktikën fetare të faljes në xhami ditëve të premte, në oraret 12:00-14:00. Gjatë kohës që ai nuk ka qenë prezent në punë, nga ana e eprorëve të tij është pranuar dhe zëvendësuar nga kolegët e tij.

Më datë 15.09.2023, ankuesi është larguar nga puna për të ndjekur praktikën e tij fetare të faljes së ditës së premte në xhami. Sakaq, D.D., në cilësinë e administratorit, ka urdhëruar Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për heqjen e ditës së punës dhe nuk është lejuar më të largohet nga vendi i punës për të ndjekur praktikën e tij fetare të faljes së ditës së premte në xhami.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit të 12, i saj;
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;

- Rregullorja “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Tiranë”, miratuar me Vendim Nr. 46111, datë 29.12.2022.

KONKLUSIONE

Mbështetur në analizimin e fakteve e provave të depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se subjekti ankues i ishte nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm, nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë, D.D., lidhur me:

- mohimin e të drejtës për ndjekjen e praktikës fetare të faljes në xhami çdo ditë të premte;
- heqjen e ditës së punës me justifikimin që nuk ka marrë leje tek eprori i tij i drejtpërdrejtë.

Komisioneri konstatoi se, ankuesi kishte rreth 8 vite që ushtronte detyrën e Specialistit të Informimit Qytetar pranë Njesisë Bashkiake Nr. 8, Tiranë. Fakti që ankuesi ka qenë besimtar dhe praktikant i fesë islame, rezultoi të ishte i njohur prej vitesh nga punonjësit por edhe Administratorët e Njesisë Administrative Nr. 8, duke përfshirë edhe D.D.

Mbështetur në përgjigjen e dhënë nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, përmes e-mail-it datë 22.04.2024, (citurar në pjesë II të këtij vendimi), për praktikantët e fesë islame është detyrim që namazin e xhumasë ta falin në ambientet e xhamisë dhe/ose të atyre ambienteve që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i ka caktuar për këtë funksion. Mosfalja e xhumasë sipas këtyre kriterëve e bën atë të pavlefshme. Nëse falja e xhumasë nuk kryhet në ambientet e xhamisë nuk konsiderohet e justifikuar.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, A.D., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, duke mos dhënë asnjë justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, lidhur me rrethanat apo atë çfarë ka ndryshuar në këtë moment, sa i përket moslejimit të ankuesit për ndjekjen e praktikës së tij fetare të faljes në xhami, ditëve të premte. Fakt për të cilin ai ka qenë në dijeni prej vitesh dhe i ka dhënë aprovimin në vazhdimësi.

Gjatë procedurës të shqyrtimit të ankesës, nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, nuk u provua asnjë pretendim në lidhje me faktin, nëse ofrimi i përshtatjes së arsyeshme për rastin e ankuesit, pra lejimi për të ndjekur praktikën e tij fetare të faljes në xhami, ditëve të premte, për rreth 2 orë, përbënte një barrë disproporcionale dhe të padrejtë, pra një barrë të tepruar. Edhe pse është kërkuar gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, Administratori, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë provë apo fakt lidhur me fluksin e shtuar të punës në Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, përse u pretendua prej tij. Gjithashtu, edhe pas ankesës së A.D., të paraqitur tek Komisioneri, Administratori i Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, nuk ka marrë asnjë masë për t’i ofruar një përshtatje të arsyeshme, duke mos e lejuar atë të ndjek praktikën fetare të faljes në xhami çdo ditë të premte.

Në analizë përse më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Administratori i Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, kishte

vendosur përpara një situatë diskriminuuese, për shkak të besimit fetar A.D., sa i përket moslejimit për të ndjekur praktikën e tij fetare të faljes në xhami, ditëve të premte, për rreth 2 orë, duke e privuar nga e drejta për ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë përmes kryerjes së riteve fetare.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të A.D., *në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme*, nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë, për shkak të bindjeve fetare.
- Në referim të pikës 1, Administratori i Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke i dhënë mundësinë për ushtrimin e lirisë së fesë përmes kryerjes së riteve fetare të faljes në xhami, ditëve të premte.

II. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

4. B.Ç., kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 26, DATË 23.01.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Kavajë. Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Ankuesi është banor i qytetit të Kavajës dhe në datën 12.01.2021, ka filluar punë në Institucionin e Bashkisë Kavajë, në pozicionin “Agronom”, pranë Njesisë Administrative Helmas, Bashkia Kavajë, Qarku Tiranë, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 24.08.2023. Gjatë kohës që ka punuar pranë Bashkisë Kavajë nuk ka asnjë masë disiplinore.

Me Urdhrin Nr. 568, datë 24.08.2023, Bashkia Kavajë ka vendosur lirimin nga detyra të ankuesit për shkak se janë konstatuar shkelje të ndryshme në veprimtarinë e përmbushjes së realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se Bashkia Kavajë nuk e ka njoftuar paraprakisht ankuesin për zgjidhjen e kontratës dhe as ka realizuar takim me të për t'i komunikuar arsyet e zgjidhjes së kontratës, duke mos i dhënë mundësinë të shprehet mbi këto arsye. E gjithë procedura e zgjidhjes së kontratës së punës ishte realizuar brenda 2 (dy) ditëve, konkretisht rezultoi se në datë 23.08.2023 janë kryer këto veprime: Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka dorëzuar Relacionin më datë 23.08.2023, në lidhje me konstatimin e shkeljeve të ndryshme në veprimtarinë e përmbushjes së realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara dhe ka kërkuar të merren masa administrative; e më pas ka dalë Urdhri për largimin nga detyra datë 24.08.2023. Rezultoi që ankuesi është zëvendësuar një ditë më pas në datën 25.08.2023 nga një punonjës tjetër.

Rezultoi se procedura për zgjidhjen e kontratës së punës nuk është respektuar nga ana e Bashkisë Kavajë, duke u cënuar rëndë e drejta e ankuesit për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Gjithashtu, motivacioni i deklaruar nga Bashkia Kavajë për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin, rezultoi i pabazuar në fakte e prova. Pra, rezultoi se ankuesi ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna ishte bërë pa një shkak të ligjshëm. Njëkohësisht, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar i Partisë Socialiste, pasi depozitoi pamje fotografike ku ai ka qenë jo vetëm pjesmarrës gjatë fushatës elektorale por është ekspozuar dhe me figura publike, përfaqësues të Partisë Socialiste, gjithashtu ka patur një rol më aktiv, atë të sekretarit në KZAZ Nr. 42, Kavajë, në zgjedhjet për Pushtetin Lokal të zhvilluara në 14 Maj, në qytetin e Kavajës.

Gjatë procedurës për shqyrtimin e ankesës Bashkia Kavajë nuk mbajti asnjë qëndrim dhe nuk dha shpjegime në lidhje me pretendimin për diskriminim. Bashkia Kavajë gjithashtu nuk depozitoi të gjithë dokumentacionin që ju kërkuar.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar në qytetet me një popullsi të vogël në numër, siç është Bashkia Kavajë, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri tjetrin, si dhe të kenë dhe dijeni lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i funksioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

Fakt tjetër i konstatuar është që ndërprerja e marrëdhënieve të punës e B.Ç., ka ndodhur në datën 24.08.2023, procedurë e cila ka ndodhur në një afat relativisht të shkurtër kohore nga emërimi i Kryetarit të ri të Bashkisë Kavajë, i cili është betuar si kryetar i kësaj bashkie në datën 14.06.2023.

Duke iu referuar faktit se ankuesi është anëtar i subjektit politik Partia Socialiste dhe faktit që Bashkia Kavajë nuk arriti të provojë se largimi nga puna ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e Bashkisë Kavajë kanë qenë të motivuara politikisht.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Bashkia Kavajë ka diskriminuar ankuesin B.Ç., në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e kontratës së punës nuk ka ndodhur për shkak

të konstatimit të shkeljeve të ndryshme në veprimtarinë e përmbushjes së realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara, por për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit B.Ç., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kavajë të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin B.Ç., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

5. A.Xh., kundër Bashkisë Gramsh

VENDIM NR. 32, DATË 05.02.2024

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim në formën e shoqërimit dhe në formën e shqetësimit
Fusha: Punësim
Statusi: Nuk ka rekomandim

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Gramsh. Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjeve politike të vajzës së tij.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Gramsh, me detyrë “shofer”. Ankuesi nuk ka pasur asnjë masë disiplinore apo vërejtje për mosrealizim detyrash apo ndonjë shkelje tjetër nga ana e punëdhënësit, deri në momentin e emërimit në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë. Sjelljet diskriminuese kundrejt tij e kanë filluar pas momentit të kandidimit të vajzës së tij, për anëtare e Këshillit Bashkiak Gramsh, si përfaqësuese e subjektit politik “Partia e Gjelbër” në zgjedhjet lokale të vitit 2023. Kryetarit i Bashkisë, menjëherë pasi mori detyrën për drejtimin e këtij institucioni, (i cili është pjesë e forcës politike, PS) ka ndërmarrë ndaj ankuesit një sërë veprimesh diskriminuese. Sipas ankuesit, shkak për këto sjellje të punëdhënësit është bërë përkrahja politike ndaj vajzës së tij, e cila i përket një partie politike të ndryshme nga ajo që i përket Kryetari i Bashkisë Gramsh.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolli 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- “*Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”;
- “*Karta Sociale Europiane*” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 15/2019, “*Për nxitjen e punësimit*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtrimeve të palëve, Komisioneri vlerësoi se, nga ana e Bashkisë, në cilësinë e punëdhënësit, nuk u sollën prova dhe argumenta bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se, kundrejt ankuesit është ndjekur procedura e rregullt ligjore për

dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim për zgjidhje të marrëdhënieve të punës”; se ka zbatuar parimin e kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t’i ishin krijuar mundësitë për t’u mbrojtur efektivisht “de jure” dhe “de facto”, lidhur me masën disiplinore, para se ajo të jepej e të bëhej fakt i kryer; si dhe, se ka zbatuar parimin e arsyeshmërisë e proporcionalitetit në dhënien e kësaj mase disiplinore. Kjo masë është e pabazuar, e paarsyetuar, joproporcionale dhe e padrejtë, për arsytet e poshtëcituar:

- Masa e dhënë ndaj ankuesit me paralajmërim për largim nga puna është masa e parafundit për largimin e tij puna, dhe në këto kushte ajo duhet të pëmbajë shkelje të tilla që të justifikojnë atë, si dhe të jenë në proporcion me këto shkelje.
- Nuk janë provuar nga ana e punëdhënësit shkelje të asaj natyre që të justifikojnë këtë masë disiplinore, pasi, *së pari*, procedura për dhënien e saj ka nisur mbi arsyen e 4 ditëve të pajustikuara të mungesës së tij në punë (pra, me pretendimin e mungesës në punë për më shumë se tre ditë rresht të pajustificuara) dhe vendimi për dhënien e masës bazohet vetëm mbi mungesën e dy ditëve punë të pajustificuara (dhe këto nuk janë ditë rresht: 13 dhe 17 korrik 2023). Punëdhënësi duket se ka konsideruar të drejtë, (pas verifikimit on-line të raporteve mjekësore të ankuesit për datat 12 dhe 14 korrik 2023) faktin e justifikimit të mungesës së tij në punë, për datat respektive kur ai ka qenë me raport mjekësor.
- *Së dyti*, pavarësisht faktit se ankuesi ka këmbëngulur që të verifikoheshin pamjet filmike të kamera në ambientin e punës për ditët objekt i masës disiplinore, nga ana e punëdhënësit nuk provohet që të jetë bërë një këqyrje e verifikim i kamerave për këto ditë, dhe as para KMD-së nuk u soll asnjë provë a parashtrim përsa ka pretenduar ankuesi.
- Duke qenë se verifikimi i kamerave është provë kyçe për vërtetimin ose jo të pretendimeve të ankuesit lidhur me prezencën e tij në punë për datat 13 dhe 17 korrik 2023, dhe duke qenë se kjo provë mund të ofrohej vetëm nga punëdhënësi, për shkak se ai e dispononte atë, Komisioneri vëren se, ishte detyrim i këtij të fundit të verifikonte sa më sipër. Kjo edhe në funksion të faktit se pikërisht bazuar mbi këto data ndaj ankuesit ishte propozuar masa disiplinore paralajmëruese për largimin nga puna.
- Po ashtu nga ana e Bashkisë nuk u depozituan prova e fakte, nëse kontrolli i ushtruar në ambientin e punës për punonjësin A.Xh., ishte mbi bazën e një urdhri të posaçëm verifikimi për të gjithë punonjësit apo rastësor, si dhe, nuk u soll asnjë e dhënë nëse ishin konstatuar edhe mungesa të punonjësve të tjerë në vendin e punës, përveç ankuesit dhe nëse po, cilat ishin masat e ndërmarra nga punëdhënësi, rast pas rasti. (Kjo pasi në seancë ankuesi theksoi faktin që nëse hapeshin e verifikoheshin kamerat, do të evidentoheshin qartë se kush kishte qenë në punë dhe kush jo, si dhe oraret e lëvizjeve të tyre, rast pas rasti).

Komisioneri ka vlerësuar se nga ana e punëdhënësit lidhur me procedurën e dhënies së kësaj mase disiplinore, është konsumuar shkelje e garancisë ligjore të ankuesit lidhur me zhvillimin e një procesi të rregullt e të drejtë lidhur me inicimin e ecures disiplinore kundrejt tij, duke i mohuar të drejtën për t’u mbrojtur efektivisht, si palë e cenuar në këtë proces.

Sa më sipër Komisioneri arriti në përfundimin se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm gjatë procesit disiplinor, në përfundim të të cilit nga ana e punëdhënësit, atij i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje paralajmëruese për largim nga puna”.

Në përfundim të analizimit të veprimeve të ndërmarra nga ana e punëdhënësit kundrejt ankuesit, si dhe të legjislacionit përkatës që normon marrëdhëniet e punës mes palëve, Komisioneri konstatoi se Bashkia, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim, pasi masat disiplinore kundrejt tij, nuk kanë ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive apo të ishin proporcionale në raport me shkeljen e prezumuar.

VENDIMI

- Konstatimin e e diskriminimit, të ankuesit A.Xh., në të drejtën për punësim, *në formën e shoqërimit*, dhe *në formën e shqetësimit*, për shkak të bindjeve politike dhe kandidimit të vajzës së tij A.Xh.,⁵ për anëtare e Këshillit Bashkiak Gramsh, nga ana e Bashkisë Gramsh.

⁵ Kandidimit të saj për anëtare e Këshillit Bashkiak Gramsh, në zgjedhjet vendore 2023, si përfaqësuese e Partisë së Gjelbër.

6. M.B., kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 46, DATË 13.02.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja M.B., ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Kavajë, me detyrë “Përgjegjëse në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, pozicion në të cilin ajo është emëruar më datë 04.04.2022. Ankuesja ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri në datën 08.08.2023, kur është liruar nga kjo detyrë. Referuar urdhrat të largimit nga detyra, të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, nuk jepet asnjë motivacion në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës me ankuesen. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kavajë deklaroi se, ankuesja është larguar nga puna për shkak të thyerjes së etikës, gjatë orarit të punës, evidentuar në mënyrë të përsëritur nga ankesat e qytetarëve të ndryshëm, të cilët janë paraqitur pranë sportelit të bashkisë dhe nuk kanë marrë shërbimin e duhur, por edhe janë fyer nga ankuesja.

Ankuesja pretendoi se, është diskriminuar për shkak të bindjeve të saj politike të majta, si mbështetëse e Partisë Socialiste, të cilat janë të kundërta me ato të punëdhënësit, Kryetarit të Bashkisë Kavajë, bindjet e të cilit janë të djathta.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerësoi se, arsyeja e deklaruar nga punëdhënësi për largimin nga puna, nuk rezultoi e provuar. Rezultoi se ankuesja ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi

largimi i saj nga puna ishte bërë pa një shkak të ligjshëm dhe në shkelje të plotë të procedurës dhe afateve të parashikuara nga Kodi i Punës. Bashkia Kavajë nuk arriti të provojë shkeljet e pretenduara. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankueses, pasi ajo i ka ekspozuar ato publikisht.

Ankueses i është zgjidhur kontrata e punës nga ana e Bashkia Kavajë, brenda një periudhe të shkurtër kohe, nga momenti i marrjes së detyrës nga ana e Kryetarit të Bashkisë Kavajë. Elementi kohë midis marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Kavajë, bindjet politike të të cilit janë të kundërta me ato të ankueses dhe momentit të zgjidhjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Kavajë, përforcojnë lidhjen shkakësore midis shkakut të diskriminimit bidjeve politike dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesja, nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Kavajë

Komisioneri vlerësoi se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara *krijojnë prezumimin* se, ankuesja M.B., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për shkak të bindjeve politike, nga Bashkia Kavajë. Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi se diskriminimi ka ndodhur*, punëdhënësi Bashkia Kavajë, *ka barrën e provës që të provojë të kundërtën*, pra që veprimet nuk përbëjnë diskriminim. Këtë, Bashkia Kavajë, mund ta realizonte duke treguar se, nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të ankueses, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankueses se zgjidhja e marrëdhënies së punës, është kryer për shkak të bindjeve politike.

Bashkia Kavajë, nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankueses se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve të saj politike. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Bashkisë Kavajë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen M.B., mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses M.B., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.

7. L.Z., kundër Bashkisë Shkodër

VENDIM NR. 53, DATË 05.03.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi L.Z., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi L.Z., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Shkodër dhe ka punuar në pozicionin Administrator Lagje. Ankuesi ka filluar punë në këtë pozicion në datën 14.07.2022. Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe Bashkisë Shkodër kanë vijuar normalisht deri kur me datë 21.07.2023 ankuesi është njoftuar nga punëdhënësi se duhet të paraqitet për zhvillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në njoftim citohet se shkaku për fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e kontratës së punës është *“riorganizimi i veprimtarisë së punës në institucionet e Bashkisë Shkodër”*. Gjatë takimit të zhvilluar me punëdhënësin, ankuesit i është komunikuar se, duke marrë parasysh pozicionin e tij të punës dhe kërkesat operationale të punës në bashki, pasi do të ndryshojë stafi i administratës së lagjeve të bashkisë, ankuesit do t’i shkëputen marrëdhëniet e punës me Bashkinë Shkodër. Në vijim të këtij takimi, Kryetari i Bashkisë Shkodër ka nxjerrë vendimin Nr. 207, datë 28.07.2023, me anë të të cilit, është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesin.

Rezultoi se, ankuesi L.Z., ishte anëtar i subjektit politik Partia Demokratike dhe në zgjedhjet e zhvilluara në vitin 2023 ka qenë anëtar KZAZ-je, në Qarkun Shkodër, si përfaqësues i i kësaj force politike.

Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai është anëtar dhe aktivist i Partisë Demokratike.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

KONKLUZIONE

Bashkia Shkodër pretendoi se, janë evidentuar veprime dhe/ose mosveprime të cilat kanë cenuar parimin e mirëbesimit për funksionimin e punës së administratorit të lagjes, në rastin konkret ankuesit L.Z., dhe është vlerësuar e domosdoshme rishikimi i organizimit të stafit të administratës të kësaj lagjeve në tërësi. Në lidhje me këtë pretendim, Bashkia Shkodër nuk arriti të provojë se cilat ishin veprimet dhe mosveprimet e ankuesit në cilësinë e administratorit të lagjes, të cilat kishin cenuar parimin e mirëbesimit midis Bashkisë Shkodër në cilësinë e punëdhënësit dhe ankuesit në cilësinë e punëmarrësit, të cilat nuk mund të lejonin vazhdimin e marrëdhënies së punës. Bashkia Shkodër pretendoi se procedura e rishikimit të organizimit të stafit të lagjes është kryer në mënyrë transparente, duke respektuar procedurat e përcaktuara edhe në nenin 144 të Kodit të Punës, por Bashkia Shkodër nuk depozitoi asnjë akt nëpërmjet të cilit të provonte se ky institucion kishte kryer ndonjë procedurë ristrukturimi ose riorganizimi të stafit të institucionit.

Komisioneri vlerësoi se, e drejta që Ligji Nr. 139/2015, i ka njohur Kryetarit të Bashkisë për të emëruar dhe shkarkuar administratorët e lagjes, nuk presupozon se, ushtrimi i kësaj të drejte ushtrohet në kundërshtim me Kodin e Punës, që në rastin objekt shqyrtimi, është legjislacioni që rregullon procedurën dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës së punës. Administratorët e lagjes, si në rastin konkret ankuesi, edhe mbi bazën e parashikimeve të Rregullores së Bashkisë Shkodër, ushtrojnë funksione të natyrës administrative dhe janë pjesë përbërëse e strukturës administrative të Bashkisë Shkodër.

Sipas strukturës dhe organikës së Bashkisë Shkodër, administratorët e lagjeve nuk janë pjesë përbërëse e Kabinetit të Kryetarit, anëtarët e së cilit, për analogji me parashikimet e Vendimit Nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, kanë status politik dhe marrëdhënia e tyre e punës është e një natyre të veçantë. Administratorët janë punonjës që nuk gëzojnë status të veçantë, i cili e bën punësimin e tyre, të lidhur dhe të kushtëzuar me qëndrimin në detyrë ose jo të Kryetarit të Bashkisë. Marrëdhënia e punës ndërmjet palëve është e rregulluar nga një kontratë individuale pune, që i nënshtrohet parashikimeve të Kodit të Punës dhe në asnjë dispozitë të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” apo të ndonjë akti tjetër përcaktohet një status i veçantë i Administratorit të Lagjes, në krahasim me punonjës të tjerë të Bashkisë Shkodër. Përfundimisht Komisioneri vlerësoi se, funksioni i Administratorit të Lagjes, nuk është funksion politik.

Lidhur me Administratorin e lagjes, legjislacioni i posaçëm për pushtetin vendor nuk përmban ndonjë parashikim lidhur me statusin juridik të tyre, ata nuk janë nëpunës civilë, por njëkohësisht

nuk janë as funksionarë politikë dhe as organe të zgjedhura. Komisioneri, vlerëson se funksioni i Administratorit të lagjes, i cili ushtrohet nga një i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, përderisa ligji nuk përcakton ndonjë afat të tillë, passjell që ky funksion gëzon të njëjtën mbrojtje sikurse parashikohet për çdo punëmarrës nga dispozitat e Kodit të Punës dhe Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Bashkia Shkodër nuk arriti të provojë, se zgjidhja e kontratës së punës dhe lirimi i ankuesit nga detyra “Administrator lagje” ka ndodhur për shkaqe ose arsye të justifikuara. Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi L.Z., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme nga ana e Bashkisë Shkodër, gjatë zgjidhjes së kontratës së punës dhe lirimimit nga detyra “Administrator lagje”.

Nga ana tjetër rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, *Bashkia Shkodër, e cila kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike.* Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Shkodër, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkakun i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit L.Z., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Shkodër.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Shkodër të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

8. M.C., kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 95, DATË 12.04.2024

Shkaku: Bindje politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Kavajë. Asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Në vitin 2020, ankuesja me urdhër të Bashkisë Kavajë, është transferuar nga detyra Drejtore në Kopshtin Nr. 1 (me ushqim), në detyrën Edukatore në Kopshtin Nr. 1 (me ushqim Godina 26 Marsi). Gjatë kohës që ka punuar pranë Bashkisë Kavajë nuk ka asnjë masë disiplinore.

Me Urdhrin Nr. 641, datë 31.08.2023, Bashkia Kavajë ka vendosur largimin nga detyra të ankueses dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare në datën 04.09.2023.

Ankuesja kundërshton largimin nga puna dhe pretendon se zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike të saj dhe të bashkëshortit të saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) *“Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”* (CEDAW);
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit/Bashkia Kavajë. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesja. Ankuesja ka parashtruar në ankesë se, fakti që bindjet e saj politike janë të kundërta me ato të punëdhënësit, ka sjellë si pasojë largimin e saj nga puna.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar në qytetet me një popullsi të vogël në numër, siç është Bashkia Kavajë⁶, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri tjetrit, si dhe të kenë dhe dijeni lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i funksioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

Fakt tjetër i konstatuar është që ndërprerja e marrëdhënieve të punës të M.C., ka ndodhur në datën 31.08.2023, procedurë e cila ka ndodhur në një afat relativisht të shkurtër kohor nga emërimi i Kryetarit të ri të Bashkisë Kavajë, i cili është betuar si kryetar i kësaj bashkie në datën 14.06.2023.

Komisioneri gjykoi se, elementi kohë midis marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Kavajë, bindjet politike të të cilit janë të kundërta me ato të ankuses dhe momentit të zgjidhjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Kavajë, përforcojnë lidhjen shkakore midis shkakut të diskriminimit bindjeve politike dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesja, nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Kavajë.

Bashkia Kavajë, nuk depozitoi informacionin që iu kërkua zyrtarisht nga Komisioneri, nëse në pozicionin e mbajtur nga ankuesja ishte emëruar ndonjë punonjës tjetër. Informacioni në lidhje me këtë çështje, disponohet vetëm nga ana e Bashkisë Kavajë. Fakti që Bashkia Kavajë nuk vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioneri në lidhje me këtë moment, do të merret në konsideratë për qëllime të të provuarit dhe marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me ankesën.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Kavajë ka diskriminuar ankuesen M.C., në të drejtën për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënies së punës nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, por për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuses M.C., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kavajë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

⁶ Sipas të dhënave të Censurit 2011, Bashkia Kavajë ka një popullsi prej 40,094 banorë.

**9. A.Ll., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik,
Bashkia Tiranë.**

VENDIM NR. 99, DATË 15.04.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi A.Ll., ka filluar punë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën 19.01.2021, në pozicionin e magazinierit, në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve. Gjatë periudhës që ankuesi ka ushtruar detyrën si magazinier nuk rezulton që ndaj tij të jetë marrë ndonjë masë disiplinore. Bazuar në vlerësimet vjetore të rezultateve në punë për vitin 2021 dhe 2022, rezulton se ankuesi është vlerësuar me 1 (një) “shumë mirë”, që përbën vlerësimin më të lartë.

Me datë 01.07.2023, me urdhër të punëdhënësit, ankuesi ka kaluar nga detyra e magazinierit në Sektorin e Financës të Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në detyrën e teknikut të mesëm, në Sektorin e Dispecerisë të Drejtorisë së Ndriçimit Publik, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Më datë 25.8.2023, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin “*Për lirim nga detyra*” sipas të cilit është disponuar si vijon : “*1. A.Ll., punonjës në Sektorin e Dispecerisë, në Drejtorinë e Ndriçimit Publik, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik zgjidhet Kontrata Individuale e Punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajistifikuar nga punëmarrësi për braktisje të punës. ...*”.

Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, pasi ndryshimi i pozicionit të tij të punës nga magazinier në teknik i mesëm dhe më pas zgjidhja e marrëdhënies së tij të punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, ka ndodhur për shkak se nuk ka pranuar kërkesën e titullarit të këtij institucioni për të marrë pjesë në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste për zgjedhjet vendore të zhvilluara në maj të vitit 2023. Ankuesi pretendon se, motivacioni i largimit nga detyra për braktisje të punës është i pavërtetë, pasi ai ka qenë në detyrë dhe nuk është kontrolluar apo nuk e kanë telefonuar asnjëherë në lidhje me mungesën në punë, sikurse pretendohet.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Referuar akteve të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, konstatohet se, detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës “magaznier” dhe “teknik i mesëm” janë shumë të ndryshme. Konkretisht, referuar detyrave dhe përgjegjësiave të vendosura në dispozicion në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e teknikut të mesëm, konstatohet se ky pozicion pune, përmban aspekte teknike që kanë nevojë për mjete mbrojtëse apo marrjen e masave tekniko-organizative për kryerjen e punimeve konform rregullave të sigurimit teknik. Gjatë shqyrtimit, punëdhënësi/ Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me arsyet, nevojën apo përmbushjen e kërkesave të imponuara nga detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushen nga një person i punësuar në pozicionin e teknikut të mesëm, për “lëvizjen brenda organikës” të ankuesit, sikurse e ka emërtuar urdhrin e saj për ndryshimin e pozicionit të punës së ankuesit nga magaznier në teknik i mesëm. Ankuesi deklaroi se ai ka qenë i detyruar për të vijuar punën në pozicionin “teknik i mesëm” pavarësisht se nuk ka qenë i kualifikuar për këtë pozicion pune, pasi i duhet të sigurojë të ardhura për familjen.

Komisioneri vlerëson se, arsyeja e deklaruar nga punëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, për zgjidhjen e kontratës së punës së ankuesit për pozicionin teknik i mesëm, rezultoi e paprovuara. Në këto kushte provohet se, largimi nga puna i ankuesit A.L., është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive, si dhe në shkelje të procedurës ligjore që duhet ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi A.L., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit/ Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë.

Në lidhje me shkakun e bindjeve politike, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin Nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: “... nocióni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike.” Në këtë kontekst,

Komisioneri, vlerëson si shkak të njohur nga LMD si “bindje politike” edhe mospasjen e bindjeve të caktuara politike.

Rezultoi e provuar se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik. Njëkohësisht, rezultuan të provuara si deklaratimet e ankuesit për mospasje të bindjeve politike dhe mos angazhim e tij në asnjë strukturë apo forcë politike, dhe po ashtu, rezultuan të provuara bindjet politike dhe angazhimi politik në aktivitete dhe fushatën e zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023 të Partisë Socialiste të titullarit të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë provë e drejtëpërdrejtë për të provuar kërkesën ndaj ankuesit për tu përfshirë dhe për të mbështetur fushatën e Partisë Socialiste në zgjedhjet vendore të zhvilluara në 14 maj 2023. Për trajtimin diskriminues, në pjesën dërmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtëpërdrejta. Janë provat e tërthorta ato që, çojnë në fakte të cilat mund të shërbejnë si baza për arritjen e një përfundimi lidhur me një fakt vendimtar.

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioneri konstatoi se, në Raportin Përfundimtar, në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023, Misioni i Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR-it) për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, konstaton se: *“MVZ-ja e ODIHR-it mori një sërë raportimesh të besueshme në lidhje me rastet kur punonjësve të bashkisë iu tha të mbështesnin ose të votonin për PS-në ose kur ishin paralajmëruar të mos e mbështesnin opozitën. MVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të tilla nga qarqet Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë.”*

Rezulton se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit, fillimisht me largimin e tij nga pozicioni i punës si magazinier në datën 01.07.2023 dhe më pas përfundimi i marrëdhënies së punës për pozicionin e punës teknik i mesëm në datën 25.08.2023, në të cilin ishte emëruar në datën 01.07.2023, kanë ndodhur brenda një periudhe të shkurtër kohe, nga zhvillimi i zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri gjykon se, elementi kohë, përforcojnë lidhjen shkakore midis shkakut të diskriminimit bindjeve politike, në rastin konkret të mospasjes së bindjeve politike dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesi, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik.

Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, ankuesi A.L., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për shkak të bindjeve politike, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë.

Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi se diskriminimi ka ndodhur*, punëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, Bashkia Tiranë, *ka barrën e provës që të provojë të kundërtën*, pra që veprimet nuk përbëjnë diskriminim. Këtë, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, mund ta realizonte duke treguar se,

nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të ankuesit, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës, është kryer për shkak të bindjeve politike.

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës për të dyja pozicionet, magazinier dhe më pas largimi përfundimtar nga pozicioni si teknik i mesëm, ka ndodhur për shkak të bindjeve politike. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin A.L.L., mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar, pra bindjet politike, që në rastin konkret është mospasja e bindjeve politike nga ankuesi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A.L.L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, Bashkia Tiranë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin A.L.L., në pozicionin e punës “Magazinier” ose në një pozicion të barazvlefshëm me të ose të përshtatshëm për ankuesin.

10. B.R., kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 208, DATË 31.07.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja B.R., ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Kavajë, me detyrë “Edukatore” në Kopshtin Nr. 1 Kavajë (vartës Kopshti 26 Marsi). Ajo ka filluar pune me date 15.12.2017. Pas përfundimit të periudhës së provës në këtë pozicion pune, marrëdhënia e punës ka vijuar normalisht deri në datë 14.09.2023, kur ankuses i është zgjidhur kontrata e punës me motivacionin se nuk ka arsimin e kërkuar.

Ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi në të cilën pretendon se motivacioni i deklaruar nga punëdhënësi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i pabazuar dhe se ndërprerja e marrëdhënies të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në lidhje me motivacionin/shkakun e deklaruar nga ana e punëdhënësit/Bashkia Kavajë për zgjidhjen e kontratës së punës “mungesa e arsimit adekuat”, pavarësisht se nuk përbën shkak të justifikuar për zgjidhjen e kontratës së punës, bazuar në faktet dhe provat e administruara, Komisioneri konstaton se, pretendimi i punëdhënësit se ankuesja nuk ka arsimin e përshtatshëm për të qenë edukatore kopshti, është i pabazuar.

Referuar Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 57 “Profesioni i mësuesit”, përcakton se: “1. Mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor.” Sipas përcaktimeve të ligjit të sipërcituar, kopshtet janë pjesë e arsimit parashkollor, dhe rrjedhimisht për t’u punësuar si edukatore në kopsht, duhet që personi të ketë fituar diplomë të ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor. Ankuesja zotëron Diplomë “Bachelor” në “Mësuesi – Arsimi Parashkollor”, lëshuar në datën 01.10.2012. Gjatë kohës që ankuesja ka ushtruar detyrën si edukatore, ka fituar kategorinë e III “Mësues i kualifikuar”. Në referim të nenit 57, të Ligjit Nr. 69/2012, të ndryshuar, dispozitë e cila përcakton arsimin e kërkuar për të ushtruar detyrën si edukatore kopshti, si dhe në bazë të provave të administruara rezulton se, ankuesja ka arsimin që kërkohet për pozicionin e punës edukatore kopshti. Rrjedhimisht, në këto kushte, motivacioni/shkaku që punëdhënësi/Bashkia Kavajë ka deklaruar në urdhrin për largimin nga puna të ankuses është plotësisht i pabazuar në ligj dhe në prova.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja B.R., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen/përfundimin e marrëdhënies së punës, nga ana e Bashkisë Kavajë. Bazuar në aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se, ankuesja i ka ekspozuar publikisht bindjet e saj politike.

Ankueses i është zgjidhur kontrata e punës nga ana e Bashkia Kavajë, brenda një periudhe të shkurtër kohe, nga momenti i marrjes së detyrës nga ana e Kryetarit të Bashkisë Kavajë. Elementi kohë midis marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Kavajë, bindjet politike të të cilit janë të kundërta me ato të ankuses dhe momentit të zgjidhjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Kavajë, përforcojnë lidhjen shkaksore midis shkakut të diskriminimit bidjeve politike dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesja, nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Kavajë.

Komisioneri vlerësoi se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë *prezumimin* se, ankuesja B.R., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për shkak të bindjeve politike, nga Bashkia Kavajë. Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi se diskriminimi ka ndodhur*, punëdhënësi Bashkia Kavajë, *ka barrën e provës që të provojë të kundërtën*, pra që veprimet nuk përbëjnë diskriminim. Këtë, Bashkia Kavajë, mund ta realizonte duke treguar se, nuk ka ndonjë lidhje shkaksore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të ankuses, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankuses se zgjidhja e marrëdhënies së punës, është kryer për shkak të bindjeve politike.

Bashkia Kavajë, nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuses se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve të

saj politike. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Bashkisë Kavajë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen B.R., mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses B.R., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kavajë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kavajë të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke rikthyer ankuesen B.R., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të

11. M.H., kundër Bashkisë Shkodër

VENDIM NR. 217, DATË 05.08.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim në formën e shoqërimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Shkodër. Asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, pas emërimit të kryetarit të ri të Bashkisë, duke e diskriminuar për shkak të bindjeve politike të bashkëshortit.

FAKTET

Subjekti ankues, ka nisur marrëdhënien e punës me Bibliotekën “Marin Barleti”, Shkodër, me datë 16.04.2002, në pozicionin e punës “Bibliotekare”, me punëdhënësin Bibliotekën.

Nuk rezulton i provuar e dokumentuar momenti se *kur* dhe procedura se *si*, kjo marrëdhënie pune mes ankuses dhe Bibliotekës, ka ndryshuar dhe është transferuar tek punëdhënësi tjetër/Bashkia Shkodër. *(Komisioneri thekson faktin se këto të dhëna rezultojnë nga këqyrja e Librezës së Punës së ankuses, pasi Bashkia nuk ka depozituar asnjë informacion apo shkresë që të dokumentojë/shënjojë këto momente.)*

Subjekti ankues detyrën e Kryebibliotekares pranë Bibliotekës, e ka kryer për periudhën nga viti 2002-28.02.2024.

Me Vendimin Nr. 101, datë 28.02.2024 “Për lirim nga detyra”, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, H është liruar nga detyra e Kryebibliotekares, Sektori i Librit dhe Mediatekës/Dega Ekonomike dhe e Kulturës, institucion në vartësi të Bashkisë Shkodër, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në dosjen personale të ankuses pranë Bashkisë, nuk rezulton të ketë asnjë vlerësim pune, performance për asnjë nga 22 vitet e punës së saj, si dhe nuk rezulton të ketë patur asnjë masë disiplinore kundrejt saj.

Shkresa për lirimin e ankuses nga detyra, shpreh vetëm motivacionin që i ka shërbyer punëdhënësit për ta larguar nga puna, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Ankuesja ka pretenduar se procedura për largimin e saj nga puna është bërë vetëm për motive politike, mbasi bashkëshorti i saj, A.H., në periudhën janar 2004 - mars 2007, ka qenë Kryetar i Bashkisë Shkodër, i propozuar nga Partia Demokratike. Gjithashtu, aktualisht është aktualisht anëtar i Këshillit Bashkiak Shkodër, i zgjedhur në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, si pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, duke përfaqësuar opozitën në Këshillin Bashkiak.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj të konstatojë diskriminimin nga ana e Bashkisë Shkodër dhe të urdhërojë rikthimin e saj në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion pune të ngjashëm me të.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolli 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- *“Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”*;
- *“Karta Sociale Evropiane”* e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 15/2019, *“Për nxitjen e punësimit”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se lidhur me qëndrimin e mbajtur nga Bashkia se pozicioni i punës si Kyebibliotekare, që ka mbajtur ankuesja në ish-Degën e Ekonomisë dhe Kulturës, Sektorin e Librit dhe Mediatekës është suprimuar, Komisioneri vlerëson se është i pabazuar në akte e prova, bazuar në analizën si më poshtë vijon:

Bashkia, nuk arriti t’i provojë e faktojë pretendimet e veta lidhur me largimin e ankuses nga detyra për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës. Bashkia nuk arriti të faktojë e provojë në mënyrë objektive e të arsyeshme se:

- Kishte një suprimim real dhe të provueshëm të pozicionit të punës që mbante ankuesja;
- Se detyrat funksionale dhe përgjegjësitë e Përgjegjëses së Bibliotekës në strukturën aktuale (2024) kishin pësuar ndryshime dhe nuk ishin të njëjta me ato të Kryebibliotekares në strukturën e vjetër (2023);
- Kishte ndjekur një procedurë transparente gjatë procesit të ristrukturimit, lidhur me njoftimet dhe njohjen e ankuses me aktet e nevojshme;
- Ishte ngritur dhe kishte funksionuar Komisioni i Ristrukturimit, konform qëllimit dhe kompetencave të tij;
- Ky Komision kishte shqyrtuar në mënyrë efektive rastin e suprimimit të pozicionit të punës për ankueses, apo të ishte shprehur për të, lidhur me mundësitë e risistemimit të saj në një pozicion tjetër sipas kualifikimeve të saj;

- Ka kryer një procedurë rekrutimi transparente dhe në përputhje me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës, lidhur me emërimin e punonjësës në pozicionin e Përgjegjësës së Bibliotekës;
- Referimi i largimit të saj nga detyra bazuar në nenin 153 të Kodit të Punës (si zgjidhje e menjëhershme nga marrëdhëniet e punës), bën pjesë tek rastet e parashikuara në dispozitat ligjore që normojnë marrëdhënien e punës mes palëve dhe se zgjidhja e kontratës së punës është bërë pa shkaqe të justifikuara;
- Kishte zbatuar parimin e kontradiktorialitetit në procesin e ndjekur prej saj lidhur me largimin e ankueses nga detyra.

Duke iu referuar faktit se ankuesja është bashkëshortja e A.H., i cili i ka të ekspozuara, të ditura e deklaruar botërisht bindjet dhe përkatësinë e tij politike, si dhe faktit që Bashkia Shkodër, nuk arriti të provojë se veprimet e masat e ndërmarra prej saj kundrejt ankueses, kanë ndodhur për një shkak të ligjshëm, janë të justifikuara objektivisht dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht. Kjo Bashki në zgjedhjet vendore të Majit të vitit 2023, është fituar dhe drejtohet nga B.B., përfaqësues i Partisë Socialiste. Ankuesja është liruar nga detyra në shkurt 2024, me motivacionin e suprimimit të vendit të punës (ristrukturimit të Institucionit). Komisioneri gjykon se, elementi kohë midis marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Shkodër dhe momentit të zgjidhjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Shkodër, përforcojnë lidhjen shkaksore midis shkakut të diskriminimit, bindjeve politike, dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesja, nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Shkodër.

Në mungesë të një justifikimit ligjor, të bazuar në prova dhe objektiv lidhur me veprimet e Bashkisë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm, mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja, pra bindjet dhe përkatësia politike e bashkëshortit e ndryshme nga ajo e Kryetarit të Bashkisë dhe shoqërimi i saj me të.

VENDIMI

- Konstatimin e *diskriminimit për shkak të shoqërimit*⁷, të subjektit ankues, M.H., në të drejtën për punësim, për shkak të *bindjeve politike*, nga ana e Bashkisë Shkodër.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Shkodër, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

⁷ Për shkak të bindjeve dhe përkatësisë politike të deklaruar, të bashkëshortit të ankueses, A.Xh.

12. E.R., kundër Bashkisë Shkodër

VENDIM NR. 219, DATË 05.08.2024

Shkaku: Bindjet politike (*për shkak të bindjeve politike, të bashkëshortit dhe bashkëshortes së djalit të ankueses*)
Forma: Diskriminim në formën e shoqërimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qënë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Shkodër. Ajo është larguar nga puna pa një shkak të ligjshëm, duke u diskriminuar për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të bashkëshortit dhe bashkëshortes së djalit të saj.

FAKTET

Ankuesja E.R., ka qënë në marrëdhënie pune me Bashkinë Shkodër, me detyrë Bibliotekare, Sektori i Librit dhe Mediatekës, pranë Degës Ekonomike të Kulturës, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër.

Fillimisht ankuesja ka filluar punë si punonjëse në Bibliotekën “Marin Barleti”, Shkodër, Fondi i Perëndimit, në datën 16.02.2003.

Marrëdhia e punës ka vijuar normalisht deri në momentin kur, me shkresën datë 01.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër me lëndë “*Njoftim për fillimin e procedurave për përfundimin e marrëdhënieve të punës me Kod Pune*”, ankueses i është komunikuar se pozicioni i saj i punës “Bibliotekare”, Sektori i Librit dhe Mediatekës, pranë Degës Ekonomike të Kulturës, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër është mbyllur dhe se, Komisioni i Ristrukturimit i ngritur me urdhrin Nr. 113, datë 31.01.2024, pasi kishte shqyrtuar rastin, kishte vendosur fillimin e procedurave për përfundimin e marrëdhënieve të punës, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në vijim, me urdhrin datë 28.02.2024 “*Për lirim nga detyra*”, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, ndër të tjera, është vendosur: “*1. Lirimin e E.R., nga detyra bibliotekare, Sektori i Librit dhe Mediatekës, Dega Ekonomike e Kulturës në varësi të Bashkisë Shkodër, për shkak të ristrukturimit të institucionit. 2. Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar të bëhet, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirit ...*”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;

- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8576, datë 03.02.2000, “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 126, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Mbështetur në provat e administruara, rezultoi e provuar se, ankuesja, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, nga ana e Bashkisë Shkodër. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të bashkëshortit dhe bashkëshortes së djalit të ankueses.

Funksioni publik që bashkëshorti i ankueses ka mbajtur si ish Kryetar i Bashkisë Shkodër, funksioni që bashkëshortja e djalit ka mbajtur si, deputete e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktualisht anëtare e Këshillit Bashkiak, në Bashkinë Shkodër, janë fakte nga të cilat mund të prezumohet se, punëdhënësi/Bashkia Shkodër, ka patur dijeni për bindjet politike të këtyre personave, të cilët kanë një lidhje të ngushtë me ankuesen.

Bazuar në informacionin e administruar nga Komisioneri në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tij për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, rezulton se Bashkia Shkodër ka ndërprerë marrëdhëniet e punës edhe me punonjës të tjerë, të cilët kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke pretenduar veprime diskriminuese dhe largim nga puna për shkak të bindjeve politike, pas marrjes së detyrës si Kryetar i Bashkisë Shkodër nga ana e B.B.,⁸ për të cilat Komisioneri me vendim ka konstatuar diskriminim për shkak të bindjeve politike nga ana e Bashkisë Shkodër⁹. Para marrjes së detyrës si Kryetar i Bashkisë Shkodër nga B.B., kjo bashki drejtohej nga B.S., i cili ka qenë përfaqësues i Koalicionit Bashkë Fitojmë, ndërsa është një fakt i njohur publikisht që ndër vite Bashkia Shkodër është drejtuar nga kryetar bashkie të cilët kanë qenë përfaqësues të Partisë Demokratike.

Rezultoi se, ankueses i është zgjidhur kontrata e punës nga ana e Bashkia Shkodër, pas marrjes së detyrës nga ana e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, B.B. Ky i fundit ka marrë detyrën si Kryetar i Bashkisë Shkodër, pas zgjedhjeve të datës 14 maj 2023, ndërsa zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen ka ndodhur në datën 28.02.2024. Komisioneri gjykon se, elementi kohë midis marrjes

⁸ Ankesat e depozituara pranë KMD-së: Ankesa Nr. 163 Regj., datë 07.09.2023, L.Z., kundër Bashkisë Shkodër; Ankesa Nr. 29 Regj., datë 04.03.2024, H.H., kundër Bashkisë Shkodër;

⁹ Vendimi i KMD Nr. 53, datë 05.03.2024, L.Z., kundër Bashkisë Shkodër.

së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Shkodër dhe momentit të zgjidhjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Shkodër, përforcojnë lidhjen shkaksore midis shkakut të diskriminimit, bindjeve politike, dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesja, nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënies së saj të punës me Bashkinë Shkodër.

Bazuar në informacionin e depozituar nga Bashkia Shkodër nëpërmjet *emailit* të datës 24.06.2024 rezultoi se, para procesit të ristrukturimit, konkretisht në datën 20.11.2023, është punësuar B.S., në detyrën Bibliotekare, në Sektorin e Librit dhe Mediatekes, në ish Degën Ekonomike të Kulturës. Bashkia Shkodër shpjegon se, emërimi i punonjësës është bërë për shkak të vakancës që ka rezultuar në muajin nëntor 2023. Me largimin e ankueses nga puna, Bashkia Shkodër deklaroi se detyrat që më parë kryheshin nga ana e ankueses, tashmë kryhen nga punonjësja B.S.

Në kuadër të ristrukturimit rezulton se, numri i pozicioneve të punës “Bibliotekare” ka pësuar një reduktim me 2 (dy) pozicione më pak sipas strukturës së re. Ristrukturimi ka filluar në muajin dhjetor 2023, nëpërmjet miratimit në Këshillin Bashkiak të VKB Nr. 54, datë 29.12.2023 dhe ka vijuar më pas me miratimin e strukturës së re të Bashkisë Shkodër. Sikurse pasqyrohet në relacionin e Bashkisë Shkodër, i cili shoqëron propozimet për ndryshime strukturore para Këshillit Bashkiak, procesi i ristrukturimit bazohet në analizat paraprake të ndërmarra nga ana e bashkisë. (këto analiza paraprake nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit) Në këto kushte, nëse projeksioni në lidhje me pozicionet e punës “Bibliotekare” ka qenë për reduktimin e tyre, punësimi i një punonjësë të re në datën 20.11.2023, nuk është tregues i një vlerësimi objektiv të situatës të kryer në lidhje me ristrukturimin nga ana e Bashkisë Shkodër.

Nga aktet e administruara rezultoi se, ankuesja ka përfunduar studimet e larta në vitin 2006, pranë Universitetit të Shkodrës Luigj Gurakuqi, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Dega “Histori Gjeografi”. Rezulton gjithashtu se, ankuesja ka kryer Shkollën Dytjeçare të Bibliotekonomisë (sistemi pa shkëputje nga puna, 2004-2006) pranë Bibliotekës Kombëtare, e cila në referim të nenit 27, pika 8, të Ligjit Nr. 8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është institucioni, që drejton, organizon dhe kryen trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të bibliotekave të vendit.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, rezultoi se, Bashkia Shkodër ka vlerësuar dhe ka vijuar marrëdhënien e punësimit me punonjësën B.S., e cila duke qenë se është punësuar në datën 20.11.2023 (pavarësisht se nuk u administrua asnjë akt në lidhje me punësimin e saj) në datën 05.02.2024, kur ankueses i është komunikuar fillimi i procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës për shkak të suprimimit të vendit të punës në kuadër të ristrukturimit, ka qenë një punonjësë në periudhë prove. Ndërsa, ka vlerësuar dhe vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës me ankuesen, e cila ka qenë në marrëdhënie pune në mënyrë të pandërprerë në pozicionin si “Bibliotekare” për më shumë se 21 vite. Në bazë të fakteve dhe provave të administruara, Komisioneri e gjen këtë vendimarrje të Bashkisë Shkodër të pa bazuar dhe objektivisht të pa justifikuar.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, Bashkia Shkodër e ka diskriminuar ankuesen E.R., në formën e diskriminimit për shkak të shoqërimit, në të drejtën për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënies së punës nuk ka ndodhur për shkaqe të justifikuara objektivisht, por për shkak të bindjeve politike, të bashkëshortit dhe bashkëshortes së djalit të ankuses.

VENDIMI

- Konstatimin e *diskriminimit në formën e shoqërimit*¹⁰ të ankuses E.R., në të drejtën për punësim, për shkak të *bindjeve politike*, nga ana e Bashkisë Shkodër.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Shkodër të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur, duke rikthyer ankuesen E.R., në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

¹⁰ Për shkak të bindjeve politike të bashkëshortit të ankuses, O.R, dhe bashkëshortes së djalit, I.U. (R).

13. I.Sh., kundër Shoqërisë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a.

VENDIM NR. 226, DATË 19.08.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a. Ajo është larguar nga puna pa një shkak të ligjshëm, duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja I.Sh., ka qënë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a.,¹¹, me detyrë “Mjeke”, pozicion në të cilin ajo është emëruar me urdhrin Nr. 290, datë 16.08.2022, të Administratorit të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a.

Me anën e këtij urdhri është krijuar një marrëdhënie pune mes të dy palëve, e cila rregullohet përmes Kontratës të Shërbimit Nr. 1225 Prot., datë 16.08.2022 dhe qëllimi i kontratës është rregullimi i marrëdhënieve juridike të punës, si dhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të secilës palë. Kjo kontratë është më afat të përcaktuar një vjeçar dhe përfundon në 16.08.2023.

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a., me Nr. NUIS J66902052A, referuar Ekstraktit Historik, të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri Aksionare”, figuron e regjistruar në datën 01.07.1996, por themeluar në datën 28.09.2000 sipas Aktit të Themelimit, e cila ka si objekt: *Prodhim dhe shitje e ujit të pijshëm, ndërmarrjeve shtetërore, enteve private dhe popullatës, mirëmbajtje e rrjetit ujësjetllës.*

Ndërkohë, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 302, datë 11.05.2022 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe nga marrëveshja e lidhur nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bashkive të Qarkut Shkodër, datë 19.01.2023 (Bashkia: Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe)”,* është krijuar Shoqëria Rajonale “Ujësjetllës Kanalizimeve Shkodër” sh.a., me NIPT: M378197010¹².

Më datën 10.07.2023 me Vendimin Nr. 03 të Asamblesë së Aksionerëve *“Për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin e aksionarit të ri të Shoqërisë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër” sh.a.”*, është bërë kalimi i Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a., pranë Shoqërisë Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a.

¹¹ Emërtim të cilin kishte shoqëria para bashkimit me Shoqërinë Rajonale të “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a.

¹² Marrëdhëniet e punës ankuesja i ka patur me shoqërinë e mëparshme Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a.

Në bazë të Akt Marrëveshjes (*Kontratë Bashkëpunimi*), lidhur mes palëve: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër, sh.a., dhe Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., ndër të tjera është dakordësuar se: *Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., merr përsipër të transferojë aktivitetin, si dhe pronësinë e aktiveve si dhe detyrimet, në datën 31.08.2023.*

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., kishte paguar me pagën e plotë të muajit gusht deri në datën 31.08.2023 ankuesen dhe pse kontrata e shërbimit të saj, përfundonte në datën 16.08.2022.

Po në datën 31.08.2023, rezultoi se në bazë të Vendimit Nr. 07, datë 31.08.2023 *“Për marrjen në punë me kohë të pjesshme”*, është vendosur: *“Të miratojë marrjen në punë me kontratë me kohë të pjesshme pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër”, sh.a., mjekun me pagë mujore 60.000 lekë.”*

Ankuesja kishte vijuar të punonte pranë Shoqërisë dhe është paguar për këtë shërbim deri në datën 31.08.2023, ditë kur është mbyllur aktiviteti i Shoqërisë së mëparshme (Ujësjiellës Kanalizimeve Shkodër sh.a.) dhe Kontrata e Shërbimit të ankueses.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM Nr. 639, datë 07.09.2026 *“Për rregullat, procedurat dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”*;
- VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe nga marrëveshja e lidhur nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bashkive të Qarkut Shkodër, datë 19.01.2023 (Bashkia: Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe)”*.

KONKLUZIONE

Bazuar në aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se, ankuesja i ka ekspozuar publikisht bindjet e saj politike. Rezulton se ankuesja, I.Sh., është anëtare e Partisë Demokratike të Shqipërisë, që nga viti 1992. I.Sh., ka një aktivitet të njohur politik prej themelimit të PD, si anëtare e kësaj partie për Degën Shkodër, anëtare e kryesisë së PD Dega Shkodër dhe drejtuese e

departamentit të shëndetësisë. Ankuesja aktualisht është anëtare e kryesisë në PD, Dega Shkodër dhe anëtare e Këshillit Kombëtar të PD të Shqipërisë, si dhe mban postin si Kryetare e grupit opozitar të koalicionit "Bashkë Fitojmë" në Këshillin Bashkiak Shkodër. I.Sh., ka kontribuar si komisionere e vëzhguese në disa procese zgjedhore, si dhe ka qenë pjesëmarrëse në vijimësi në aksionet opozitare të organizuara dhe të demonstruara nga Partia Demokratike.

Rezultoi se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit/Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Qarku, sh.a. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesja.

Komisioneri vlerësoi se, në kushtet kur Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a., është transferuar në Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, kjo e fundit ka mbartur detyrimet, shlyerjen e tyre të marra përsipër në bilancin e transferimit si dhe të gjitha detyrimet e ardhme që rrjedhin nga kontratat dhe angazhimet e kaluara apo aktuale të Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a., (*Neni 2, pika 7 i Akt Marrëveshjes datë 13.07.2023*), atëherë dhe detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin në këtë rast do t'i mbarten kësaj shoqërie.

Bazuar në informacionin e administruar nga Komisioneri në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tij për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, rezulton se Shoqëria Rajonale "Ujësjetllës Kanalizime Shkodër" sh.a., ka ndërprerë marrëdhëniet e punës edhe me punonjës të tjerë¹³, të cilët kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke pretenduar veprime diskriminuese dhe largim nga puna për shkak të bindjeve politike.

Gjithashtu rezultoi që pranë Komisionerit të jenë paraqitur ankesa¹⁴ duke pretenduar veprime diskriminuese dhe largim nga puna për shkak të bindjeve politike nga Bashkia Shkodër, pas marrjes së detyrës si Kryetar i Bashkisë Shkodër nga ana e B.B. Para marrjes së detyrës si Kryetar i Bashkisë Shkodër nga B.B., kjo Bashki drejtohej nga B.S., i cili ka qenë përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Sa më sipër, nga ana e Komisionerit dhe pse u konstatua se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e shoqërisë së mëparshme asaj të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimi Shkodër sh.a., u analizua dhe qëndrimi i Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizimi Shkodër sh.a., qëndrim i cili nuk ishte bashkëpunues gjatë trajtimit të kësaj ankese, në kushtet kur kjo e fundit ka mbartur detyrimet, shlyerjen e tyre të marra përsipër në bilancin e transferimit si dhe të gjitha detyrimet e ardhshme që rrjedhin nga kontratat dhe angazhimet e kaluara apo aktuale të Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a., (*Neni 2, pika 7 i Akt Marrëveshjes datë 13.07.2023*).

¹³ Ankesa Nr. 36, Regj., datë 11.03.2024 G.K., kundër Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër, sh.a.

¹⁴ Ankesat e depozituara pranë KMD-së: Nr. 29 Regj., datë 04.03.2024, M.H kundër Bashkisë Shkodër, Nr. 28 Regj, datë 01.03.2024, E.R., kundër Bashkisë Shkodër.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a., ka diskriminuar ankuesen I.Sh., në të drejtën për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënies së punës nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, por për shkak të bindjeve politike. Për rrjedhojë Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a., ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuses I.Sh., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Shoqërisë e “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” sh.a.

14. L.Ll., kundër Bashkisë Lezhë

VENDIM NR. 227, DATË 19.08.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër (për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të vajzës së saj)
Forma: Diskriminim në formën e shoqërimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qënë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Lezhë. Ajo është transferuar pa një shkak të ligjshëm, në një pozicion tjetër pune, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të vajzës së saj.

FAKTET

Ankuesja në vitin 2000, është emëruar në pozicionin si bibliotekare pranë Bashkisë Lezhë. Me Urdhrin Nr. 434, datë 15.11.2023, Bashkia Lezhë ka ngritur Grupin e Punës për rishikimin e strukturës së Bashkisë Lezhë. Në vijim, Kryetari i Bashkisë Lezhë, me urdhrat përkatës, ka miratuar shtesat dhe ndryshimet e strukturës dhe organikës të Bashkisë Lezhë, si dhe ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit të Bashkisë Lezhë.

Pas ndryshimit të strukturës së Bashkisë Lezhë, më datë 15.12.2023, ankuesja është njoftuar për të zhvilluar bisedime, lidhur me transferimin e marrëdhënieve të punës, për arsye të shkurtimit të vendit të punës.

Pas kundërshtimit të transferimit, më datë 06.03.2024, Bashkia Lezhë ka njoftuar ankuesen për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për arsye të refuzimit të transferimit, të vendit të punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 126, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;

- Udhëzimi Nr. 1, datë 01.03.2016 *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit”*, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Mbështetur në provat e administruara, rezultoi se ankuesja ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Lezhë, përse i takon procesit të përzgjedhjes së saj si punonjëse që i mbyllet pozicionin i punës dhe transferimit të saj.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se vajza e saj ishte aktiviste opozitare për çështjet lokale dhe qendrore dhe gjatë fushatës për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023, ka mbështetur kandidatin e koalicionit opozitar “Bashkë Fitojmë”, P.Gj., i cili ishte kundërshtar i Kryetarit të Bashkisë Lezhë, duke provuar në këtë mënyrë aktivitetin e saj opozitar dhe ekspozimin e tyre publikisht. Në këtë kuptim, jemi në kushtet kur shkakun e diskriminimit nuk e mbart drejtpërdrejtë ankuesja, por personi që shoqërohet me të. Ankuesja ka provuar njëherësh lidhjen familjare me A.Ll., dhe faktin që aktiviteti publik i saj është i kundërt me ato titullarit të subjektit punëdhënës, gjë që ka pasqyruar trajtimin e saj të padrejtë dhe të pafavorshëm përse i takon procesit të përzgjedhjes së saj si punonjëse që i mbyllet pozicionin i punës dhe transferimit të saj.

Bashkia ka parashtuar si argumente para Komisionerit se, arsyeja e përzgjedhjes së ankueses si punonjëse që do transferohej, është bërë për shkak të rënies së numrit të aktiviteteve dhe të lexuesve të rinj. Ndërkohë që Bashkia, nuk arriti t’i provojë e faktojë pretendimet e veta kundrejt ankueses, pra që rënia e aktiviteteve dhe numrit të lexuesve ishte vetëm tek salla e lexuesve të rinj, ndërkohë që provohet që Bashkia Lezhë nuk ka bërë një analizë krahasuese të aktiviteteve dhe lexuesve për të gjithë punonjësit specialistë të Bibliotekës.

Aktiviteti politik dhe si aktiviste e shoqërisë civile të A.Ll., në qytetin e Lezhës ka qenë publik dhe i njohur, për më tepër që me shkresën e protokolluar pranë Bashkisë Lezhë me Nr. 18707, datë 21.12.2023, ankuesja e ka shprehur që transferimi i saj është një diskriminim i hapur politik.

Gjithashtu, ankuesja në cilësinë e provës ka dërguar pranë Komisionerit dhe një komunikim me mesazhe mes Kryetarit të Bashkisë P.N dhe vajzës së ankueses A.Ll., të bërë në datë 19.05.2023, në të cilin kanë komunikuar lidhur me një postim të bërë nga A.Ll., lidhur me kërkesën për dorëheqje që i është bërë L.Ll., nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës. Nga ana e Komisionerit është kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion rreth këtij komunikimi, por nga ana e Bashkisë Lezhë nuk ka pasur një përgjigje. Në këtë kuptim Komisioneri vlerëson se Bashkia Lezhë ka pasur dijeni për aktivitetin publik të A.Ll.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, njëkohësisht duke iu referuar faktit se pasojat negative ndaj ankueses janë kryer në periudhën pas zgjedhjeve të datës 14.05.2023, Komisioneri krijoi bindjen se përzgjedhja e ankueses si punonjëse për tu transferuar, nuk motivohet nga shkaqe ligjore. Duke iu referuar faktit se ankuesja është nëna e A.Ll., e cila është aktiviste opozitare për çështjet lokale dhe qendrore dhe gjatë fushatës për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023, ka mbështetur kandidatin e koalicionit

opozitar “Bashkë Fitojmë”, P.Gj., i cili ishte kundërshtar i Kryetarit të Bashkisë Lezhë, dhe faktit që Bashkia Lezhë, nuk arriti të provojë se përzgjedhja e ankueses për tu transferuar ka ndodhur për arsye të ligjshme apo të ishte i arsyeshëm dhe i justifikuar, krijohet bindja se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Gjithashtu, nisur nga praktika e KMD-së në kuadër të shqyrtimit të ankesave të tjera në fushën e punësimit (*marrëdhënieve të punës*) kundër Bashkisë Lezhë, gjatë periudhës së marrjes e ushtrimit të detyrës nga Kryetari aktual i Bashkisë, P.N., rezulton se Komisioneri ka konstatuar në vendimmarrjet e tij, sjellje diskriminuese të këtij institucioni ndaj punëmarrësve, pikërisht për shkak të bindjeve dhe angazhimit të tyre politik¹⁵, si aktivistë të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Bashkia Lezhë, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e saj për punësim, pasi përzgjedhja e saj si punonjëse për tu transferuar, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të vajzës së saj.

Sa më sipër Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtuar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Lezhë, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të vajzës së saj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankueses L.L., në të drejtën për punësim, *në formën e shoqërimit*, për shkak të bindjeve dhe aktivitetit politik të vajzës së saj, nga ana e Bashkisë Lezhë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Lezhë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës.

¹⁵ Citojmë vendimet Nr. 155, datë 20.08.2021 dhe Nr. 26, datë 24.01.2022, të KMD-së.

15. G.K., kundër Shoqërisë Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a.

VENDIMI NR. 252, DATË 23.09.2024

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qënë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a. Ai është larguar nga puna pa një shkak të ligjshëm, duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi ka filluar marrëdhëniet e punës me Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a., që nga data 15.01.2020 deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës më datë 11.01.2024.

Ankuesi ka mbajtur detyra të ndryshme dhe konkretisht në bazë të Urdhrit të Brendshëm Nr. 11, datë 15.01.2020 të Administratorit të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, është urdhëruar që G.K., të fillojë punë pranë kësaj shoqërie me detyrën “*Hidraulik në Sektorin e Kujdesit ndaj Klientit*”. Lidhur me zbatimin e këtij urdhëri është lidhur dhe Kontrata Provizore Nr. 71, datë 16.01.2020, me një afat prej 3 muaj.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 20, datë 03.02.2020 “*Për komandim të përkohshëm*” të Administratorit të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a., është urdhëruar që G.K., të komandohet përkohësisht në pozicionin “*Përgjegjës Grupi Task-Forcë*”. Në zbatim të këtij urdhëri është rinovuar dhe Kontrata Individuale me Nr. 514 Prot., datë 17.04.2022, kontratë e cila është lidhur me një afat të pacaktuar.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 247, datë 13.10.2020 “*Për ndryshim pozicioni*” të Administratorit të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a., është urdhëruar që G.K., të kalojë nga pozicioni “*Përgjegjës Grupi Taks Forcë*”, me detyrë “*Faturist*”.

Ndërkohë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 302, datë 11.05.2022 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe nga marrëveshja e lidhur nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bashkive të Qarkut Shkodër, datë 19.01.2023 (Bashkia: Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe)*”, është krijuar Shoqëria Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër” sh.a., me NIPT: M378197010.

Më datën 10.07.2023 me Vendimin Nr. 03 të Asamblesë së Aksionerëve “*Për zmadhimin e kapitalit dhe pranimin e aksionarit të ri të Shoqërisë Rajonale “Ujësjellës Kanalizime Qarku*

Shkodër”, është bërë kalimi i Ujësllës Kanalizime Shkodër sh.a., pranë Shoqërisë Rajonale “Ujësllës Kanalizime Qarku Shkodër” sh.a.

Në bazë të Vendimit Nr. 5, datë 31.08.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësllës Kanalizime Qarku Shkodër, është miratuar "Organigrama dhe niveli i pagave i Shoqërisë Rajonale “Ujësllës Kanalizime Qarku Shkodër” sh.a.

Pas ndryshimeve të mësipërme, në bazë të Urdhërit Nr. 71, datë 08.09.2023 “Për emërimin në detyrë-Njësia Fushë Arrëz” të Administratorit të Shoqërisë të “Ujësllës Kanalizime Shkodër” sh.a, është urdhëruar ndër të tjera që G.K., të emërohet “Operator faturimi Fushë Arrëz”.

Në bazë të Urdhrit Nr. 41, datë 11.01.2024 “Për lirim nga detyra” të Administratorit të Shoqërisë Rajonale të Ujësllës Kanalizime Shkodër sh.a., është urdhëruar lrimi nga detyra të G.K., për arsye të mos paraqitjes në punë pa shkaqe të justifikuara gjatë muajit dhjetor 2023.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 639, datë 07.09.2026 "Për rregullat, procedurat dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”;
- VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe nga marrëveshja e lidhur nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bashkive të Qarkut Shkodër, datë 19.01.2023 (Bashkia: Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe)".

KONKLUSIONE

Nga provat e administruara, rezultoi e provuar se, ankuesi, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësllës Kanalizime Shkodër sh.a. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit G.K.

Referuar akteve të administruara rezulton se, administratori i Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a., në kohën që ka ndodhur sjellja diskriminuese e pretenduar M.M.,

ka qenë njëkohësisht administrator i Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. Rezulton se, M.M., është shkarkuar nga detyra si administrator i Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., në datën 18.07.2022, pas marrjes së drejtimit të Bashkisë Shkodër nga B.S., përfaqësues i subjektit politik Partia Demokratike.

Nga aktet e administruara rezulton se, M.M., të paktën që prej datës 01.09.2023, kur është bërë kalimi efektiv i Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., tek Shoqëria Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër” sh.a., kjo e fundit punëdhënësi i ankuesit, ka ushtruar detyrën si administrator i Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime, Qarku Shkodër” sh.a.

Ndërkohë sipas akteve të vëna në dispozicion nga ankuesi vërtetohet fakti se G.K., është anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe ka kontribuar si Komisioner në disa procese zgjedhore si përfaqësues i saj. Këtë fakt G.K., e ka përforcuar dhe me fotot e vëna në dispozicion gjatë fushatës së fundit zgjedhore si përkrahës i B.S., të publikuara në rrjetet sociale të kandidatit B.S., por dhe të ankuesit. Gjithashtu rezulton që ankuesi ka qenë pjesë e spotit publicitar¹⁶ të kandidatit për kryetar bashkie B.S. Pra aktivizmi i tij politik për forcën politike të Partisë Demokratike të Shqipërisë, si përkrahës dhe mbështetës i B.S., në zgjedhjet vendore të zhvilluara në datën 14 maj 2023, fakt i cili ka qenë i dukshëm dhe publik, ka ndikuar drejtpërdrejt në ndërprerjen e marrëdhënieve të tija të punës.

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, Shoqëria Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike dhe nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit të gjithë informacionin e kërkuar zyrtarisht. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a., i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin G.K., mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar, pra bindjet politike.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqëria Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a., e ka diskriminuar ankuesin G.K., në të drejtën për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënies së punës nuk ka ndodhur për shkaqe të justifikuara objektivisht, por për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit G.K., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike nga ana e Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” sh.a.

¹⁶ <https://www.facebook.com/watch/?v=960842444792602>

III. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE

16. N.Sh., si përfaqësuese ligjore e vajzës së saj minorene, A.Sh.,¹⁷ kundër Bashkisë
Korçë

VENDIM NR. 81, DATË 28.03.2024

Shkaku: Gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Në gjykatë

Fëmija i ankueses, si anëtare e familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike, është diskriminuar nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike, duke i mohuar mundësinë për të përfituar bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për të, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues.

FAKTET

Fëmija i ankueses ndjek klasën e 7-të në Shkollën 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, Korçë. Vitin e kaluar shkollor, ajo ka përfituar bursë nga ana e shkollës, në zbatim të VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Për vitin shkollor 2023-2024, nuk ishte vënë në dijeni nga ana e shkollës, lidhur me përfitimin e bursës dhe afatet për plotësimin e dokumentacionit sipas kriterit “familje në nevojë” (parashikuar në VKM-në Nr. 511, datë 27.07.2022, e ndryshuar), por për këtë informacion ishte informuar rastësisht. Sakaq, kishte përgatitur dokumentacionin e kërkuar dhe ishte paraqitur për ta dorëzuar pranë shkollës së vajzës së saj. Nga ana e drejtuesve të shkollës i është sqaruar se ishin udhëzuar nga ana e Bashkisë Korçë se përfitues të bursave për këtë vit shkollor, do të ishin vetëm nxënësit që vijnë nga familje të rregjistruara si punëkërkuar të papunë dhe jo ata që vijnë nga familje në nevojë.

Fëmija i ankueses nuk është kualifikuar përfitues i bursës për vitin shkollor 2023-2024, nga ana e Bashkisë Korçë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

¹⁷ Referuar Certifikatës familjare datë 19.09.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, vërtetohet se familja përbëhet nga 3 anëtarë. A.Sh., dhe N.Sh., janë prindër të fëmijës A.Sh.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës;
- GJEDNJ Çështjet Molla kundër Greqisë, Fábíán kundër Hungarisë, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, Çështja Thlimmenos kundër Greqisë, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D., dhe A., kundër Mbretërisë së Bashkuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012, *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 121/2016, *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996, *“Për statusin e jetimit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996, *“Për statusin e të verbrit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000, *“Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 57/2019, *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10289, datë 17.06.2010, *“Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit”*;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, *“Për statusin e invalidëve të punës”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 18/2017 *“Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”*;
- Vkm Nr. 666, datë 10.10.2019, i Këshillit të Ministrave *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*;
- VKM Nr. 866, datë 24.12.2019, ka miratuar *Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020-2023*;
- VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015, ka miratuar *Planin Kombëtar të Veprimeve për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020*;
- Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve të administruara, Komisioneri arriti në përfundimin se, nxënësja A.Sh., (fëmija i ankueses), fëmijë i një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike, i ishte nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë, lidhur me përjashtimin nga e drejta e përfitimit të bursës, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c), të VKM-së me Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se Këshilli i Ministrave për të garantuar të drejtën për arsim të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike si nga pushteti

qendror dhe ai vendor, ka parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i përkasin kësaj kategorie, që janë në kushte të vështira ekonomike.

Komisioneri gjeti kontradiktor dhe të pa arsyetuar qëndrimin e Bashkisë, lidhur me faktin se në të njëjtat kushte ekonomike të familjes së nxënës A.Sh., për vitin shkollor 2022-2023 ajo i ka miratuar bursën e studimeve bazuar në pikën 2.1/c, të VKM-së objekt të kësaj ankese, ndërsa për vitin shkollor 2023-2024 nuk ja ka miratur atë.

Po ashtu, trajtimi i familjes me ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë, automatikisht të çon në pasjen dijeni prej saj, të gjendjes ekonomike dhe të ardhurave të pamjaftueshme të kësaj familjeje.

Komisioneri vlerësoi se, Bashkia kishte interpretuar në mënyrë të gabuar pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së respektive, kur citon se, sipas kësaj pike duhet të trajtohen me bursë nxënësit në pamundësi financiare, pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, pasi, ajo përcakton shprehimisht se: “: ... *përfitojnë bursë ... c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë ... në pamundësi financiare ...*”.

Pra, cilësimet: *pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë*, janë togfjalësja të shtuar nga ana e Bashkisë dhe janë konsideruar prej saj si kushte kumulative, gjë që bie ndesh me pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së përkatëse, pasi përfitues sipas kësaj pike të VKM-së, duhet të jenë nxënësit, “... *fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë ... në pamundësi financiare ...*”. Pra, VKM-ja e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare.

Përfundimisht, Komisioneri vlerësoi se, fëmija i ankueses, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishte përfitues i bursës, njëlloj si në vitin shkollor paraardhës 2022-2023, si fëmijë i një familjeje në nevojë, njohur, pranuar dhe dëshmuar me dokumentacion (vërtetim për trajtimin me ndihmë ekonomike) prej Bashkisë Korçë.

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykoj se, Bashkia Korçë ka keqinterpretuar klasifikimin që i bën nxënës A.Sh., fëmija i ankueses, si subjekt që nuk përfshihet tek kategoria përfituese, sipas pikës 2.1/c, të VKM-së respektive. Justifikimi i dhënë prej Bashkisë nuk është i arsyeshëm dhe objektiv. Ai ishte haptazi në kundërshtim me parashikimin ligjor të VKM-së së analizuar.

Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se fëmija i ankueses, si anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike, ishte vënë në pozita jo të favorshme, duke i mohuar mundësinë për të përfituar bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për të, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues. Pra, fëmija i ankueses ishte vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike të familjes së saj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të nxënësës A.Sh.,¹⁸ për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë, si fëmijë e një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike.
- Bashkia Korçë të marrë masa efektive, për trajtimin me bursë, për vitin shkollor 2023-2024, të nxënësës A.Sh., bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar.
- Me qëllim për të shmangur situata të tjera të ngjashme, si në rastin konkret, rekomandohet Bashkia Korçë, të marrë masa paraprake efektive, për rregullimin e situatave të tilla.
- Rekomandohet që Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë-Pustec dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë të udhëzojnë drejtoritë e shkollave, lidhur me detyrimin e tyre për grumbullimin dhe përcjelljen në Bashki të dokumentacionit të dorëzuar nga prindërit e fëmijëve që aplikojnë për përfitimin e bursës.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka trajtuar edhe 31 ankesa me të njëjtin objekt kundër Bashkisë Korçë, ku ka konstatuar vendimet si më poshtë:

- Nr. 66, datë 18.03.2024;
- Nr. 78, datë 21.03.2024;
- Nr. 80, datë 28.03.2024;
- Nr. 82, datë 28.03.2024;
- Nr. 83, datë 28.03.2024;
- Nr. 90, datë 03.04.2024;
- Nr. 109, datë 24.04.2024;
- Nr. 111, datë 24.04.2024;
- Nr. 115, datë 26.04.2024;
- Nr. 116, datë 26.04.2024;
- Nr. 121, datë 30.04.2024;
- Nr. 122, datë 30.04.2024;
- Nr. 125, datë 30.04.2024;
- Nr. 126, datë 30.04.2024;
- Nr. 127, datë 07.05.2024;
- Nr. 128, datë 07.05.2024;
- Nr. 131, datë 15.05.2024;
- Nr. 141, datë 20.05.2024;
- Nr. 142, datë 20.05.2024;
- Nr. 149, datë 21.05.2024;
- Nr. 162, datë 31.05.2024;
- Nr. 166, datë 31.05.2024;
- Nr. 167, datë 31.05.2024;

¹⁸ Përfaqësuar nga nëna, N.Sh.

- Nr. 168, datë 31.05.2024;
- Nr. 169, datë 31.05.2024;
- Nr. 170, datë 31.05.2024;
- Nr. 171, datë 31.05.2024;
- Nr. 172, datë 31.05.2024;
- Nr. 173, datë 31.05.2024;
- Nr. 199, datë 15.07.2024;
- Nr. 200, datë 15.07.2024.

IV. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË DHE SHTATZËNISË

17. K.V., kundër Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a., (UKT)

VENDIMI NR. 38, DATË 07.02.2024

Shkaku: Gjinia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a. Asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të gjinisë.

FAKTET

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në detyra të ndryshme me Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., që nga data 30.06.2004 deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës më datë 18.05.2023. Me Vendimin Nr. 898, datë 09.09.2021 “Për ndryshim të pozicionit të punës”, K.V., ka kaluar nga pozicioni i punës “Specialist Ekonomist”, Sektori Mbështetës, Njësia Tirana Nr. 1, në pozicionin Inxhinier Matje/Sektori i Faturimit, Njësia Tirana Nr. 1.

Me shkresën Nr. 1385, datë 02.11.2022, Drejtori i Njesisë Zonale 1, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të UKT-së ka propozuar masën disiplinore “Largim nga puna” për K.V., me arsyetimin se: “Punonjësja me detyrë ing.matje në sektorin e faturimit, ka thyer rregullat e etikës dhe komunikimit gjatë orarit zyrtar të punës, lidhur me faturuesin e zonës C-2, R.M., situatë e cila u agravua deri në konflikt verbal dhe fizik ndërmjet dy punonjësve të sipërpërmendur”.

Në procesverbalin e mbajtur në të njëjtën ditë, të firmosur nga Drejtori i Njesisë dhe dy punonjës, përshkruhet ngjarja ku pretendohet se ankuesja ka debatuar me një faturues për shkak të mos kryerjes me korrektësi të detyrës funksionale nga ana e tij dhe debati ka agravuar deri në konfrontim fizik mes tyre.

Në përfundim, UKT ka vendosur zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me K.V., për arsye:

- Moskryerjen e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë UKT sh.a.;
- Moszbatim i kushteve të përcaktuara në Kontratën Kolektive të Punës;
- Thyerje e Kodit të Etikës, sjellje e parregullt gjatë kohës së punës me eprorin dhe kolegët”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) *“Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”* (CEDAW);
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtimeve të palëve, Komisioneri vlerësoi se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, ankuesja K.V, është diskriminuar për shkak të gjinisë, pasi:

- Ankueses i është mohuar e drejta për t’u njohur, dëgjuar, mbrojtur, parashtuar fakte dhe prova, para se të merrej masa disiplinore, lidhur me moskryerjen e detyrave dhe moszbatimin e kushteve të kontratës nga ana e saj.
- Ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me punonjës të R.M.

UKT sh.a., pretendoi se ndaj punonjësit R.M., nuk është marrë masë disiplinore për ngjarjen e datës 02.11.2022, pasi është vlerësuar se nuk ka qenë shkaktari i veprimeve që sollën dhunën fizike dhe për moskryerjen e detyrave ka qenë fakti se në rast pretendimi për moskryerje me rregull të detyrave të punonjësve, ankuesja duhej që të niste procedim disiplinor.

Pretendimet e UKT-së, ishin kontradiktore bazuar në faktin se në procesverbalin e mbajtur nga Njësia Zonale 1, në datë 02.11.2022, përshkruhet se nga të dyja palët ka pasur sharje dhe ofendime verbale dhe konflikt fizik. Rezulton se të dyja palët në konflikt, kanë pretenduar përdorimin e ndërsjelltë të një gjuhe të papërshtatme dhe të konfliktit fizik dhe të dy janë të pajisur me raport mjekësor për dëmtime të ardhura nga konflikti fizik i tyre.

Nga ana e punëdhënësit nuk u sollën prova dhe argumente bindës që të mund të provonin apo për ligjin faktin se procedura e ndjekur për largimin e ankueses nga puna, ishte bërë në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon marrëdhëniet e punës punëdhënës-punëmarrës.

Në këtë kontekst, subjektit ankues, nga ana e UKT-së, duhet t'i ishin siguruar të gjitha garancitë ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, në mënyrë që ajo si punëmarrëse të kishte mundësi reale për t'u mbrojtur efektivisht, me qëllim që shkeljet e evidentuara nga ana e punëdhënësit në shkresën për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, të mund të shqyrtoheshin në respektim të plotë të procedurës disiplinore.

Nga provat dhe informacioni i vënë në dispozicion nga palët rezulton se nga ana e UKT-së nuk është analizuar ngjarja e konfliktit mes dy punonjësve, arsyet dhe shkalla e përgjegjësisë të secilit prej tyre. Rezulton se për punonjësen K.V., është propozuar dhe është marrë masa ekstreme, ajo e largimit nga puna ndërsa për punonjësin R.M., nuk është propozuar dhe nuk është dhënë asnjë marrë disiplinore, pavarësisht se rezulton se ka pasur ofendime verbale dhe konflikt fizik mes punonjësve. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vlerësim të trajtimit të punonjësve të bërë nga ana e UKT-së, gjykon se ka një disproporcionalitet të theksuar të masës disiplinore të marrë ndaj K.V., krahasuar me R.M., dhe i vetmi shpjegim i këtij trajtimi të pabarabartë mes punonjësve, ka lidhje me gjininë e ankueses.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, punëdhënësi nuk ka provuar se:

- Ankuesja ka marrë dijeni për dy nga arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës: moskryerja e detyrave dhe moszbatimi i kushteve të kontratës kolektive;
- Që është trajtuar në mënyrë të barabartë me punonjësin R.M., lidhur me konfliktin mes tyre.
- Masa disiplinore e largimit nga puna për ankuesen ishte proporcionale në raport me shkeljen e evidentuar.
- Masa disiplinore e largimit nga puna vetëm për ankuesen nuk ka lidhje me gjininë e saj.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a., kishte diskriminuar subjektin ankues në të drejtën për punësim, për shkak të gjinisë së ankueses.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses K.V., në të drejtën për punësim, për shkak të gjinisë nga ana e Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a.

18. S.S., kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

VENDIM NR. 130, DATË 13.05.2024

Shkaku: Shtatzënia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja S.S., është diskriminuar për shkak të shtatzënisë për të gëzuar akses të barabartë në punësim.

FAKTET

Ankuesja është e punësuar pranë Bashkisë Shkodër dhe njëkohësisht punon si pedagoge e jashtme me kohë të pjesshme pranë USH-së. Ankuesja ka shprehur interesin e saj për t’u riangazhuar si pedagoge e jashtme me kohë të pjesshme pranë USH, Fakultetit Ekonomik, Departamenti Financë-Kontabilitet, për vitin akademik 2022-2023. Rezulton se në momentin shprehjes së interesit për t’u riangazhuar si pedagoge me kohë të pjesshme pranë Departamentit Financë-Kontabilitet, në Fakultetin Ekonomik të USH-së, ankuesja ka qenë shtatzënë.

Me vendimin e datës 26.10.2022, komisioni i përzgjedhjes dhe vlerësimit të pedagogëve të jashtëm që kanë aplikuar për vitin akademik 2022-2023, i ngritur pranë Departamentit Financë Kontabilitet, në Fakultetin Ekonomik, të USH, ka vendosur, që për nevoja të departamentit do propozohen për riangazhim në mësimdhënie gjithsej 13 pedagogë, midis të cilëve edhe ankuesen S.S. Pala ankuese deklaroi se, pasi ishte njoftuar si aplikante fituese kishte përcaktuar ngarkesën mësimore së bashku me njësinë bazë/Departamentin Financë-Kontabilitet, e cila i mundësonte ankueses që të ushtronte mësimdhënien në semestrin e parë, ndërsa ngarkesa më e madhe mësimore ishte përcaktuar në semestrin e dytë.

Në datën 12.12.2022, ankuesja ka lindur fëmijën e saj. Ankuesja për një periudhë prej 63 (gjashtëdhjetë e tre) ditë, nga 12.12.2022 – 12.02.2023, ka qenë me raport për leje barrë lindje, duke cilësuar se ankuesja është e aftë për punë në datën 13.02.2023.

Me vendimin e datës 12.01.2023 Rektori i USH-së, ka vendosur aktivizimin e 23 pedagogëve si staf akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023 dhe deklarimin “on-line” në sistemin elektronik të DRT të pedagogëve që do të zhvillojnë mësim në FE për semestrin e parë, për periudhën janar-shkurt 2023. Ankuesja S.S., nuk përfshihet në listë. Nga të dhënat e administruara rezulton se, kontratat e pedagogëve të jashtëm të Departamentit Financë-Kontabilitet, në Fakultetin Ekonomik të USH-së janë nënshkruar gjatë periudhës 12.12.2022 – 22.02.2023.

Ankuesja S.S., pavarësisht se është përzgjedhur nga komisioni i përzgjedhjes së pedagogëve të jashtëm, i ngritur pranë Departamentit Financë-Kontabilitet, në Fakultetin Ekonomik, të USH, për t'u riangazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2022-2023, USH nuk ka nënshkruar me ankuesen, kontratën e punës si pedagoge e jashtme me kohë të pjesshme.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) *“Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”* (CEDAW);
- Konventa Nr. 183 *“Mbrojtja e amësisë, 2000”*, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO);
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 korrik 2006, mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e ndryshuar);
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*.

KONKLUZIONE

Ankuesja rezulton se plotëson dhe përmbush të gjitha kriteret për t'u punësuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë USH, Fakulteti Ekonomik, Departamenti Financë-Kontabilitet. Nga aktet e administruara rezulton e provuar se, ankuesja në momentin e aplikimit dhe përzgjedhjes si aplikante fituese për pedagoge me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023 ka qenë shtatzënë, por jo në kushtet e ndonjë ndalimi ligjor për të punuar, pasi nuk ka qenë me raport për leje barrë lindje gjatë periudhës ligjore kur gruas shtatzënë/gruas që ka lindur i ndalohet të punojë.

Komisioneri vlerëson se, momenti i nënshkrimit të kontratës është i ndryshëm nga momenti i kryerjes së punës/mësimdhënies nga ana e pedagogut. Shpërndarja e ngarkesës mësimore dakortësohet midis pedagogut dhe njësisë baze/Departamentit të Financë Kontabilitetit në rastin konkret.

Bazuar në të dhënat e administruara rezulton se, Rektori i USH ka nënshkruar kontratat e punës me pedagogët me kohë të pjesshme të Departamentit Financë Kontabilitet deri në datën 22.2.2023. Konkretisht, bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga USH gjatë seancës dëgjimore

rezulton se, në datën 22.02.2023 USH ka nënshkruar kontratën e punës me E.K. Bazuar në dokumentacionin e administruar rezulton se, E.K., ka patur ngarkesë mësimore për semestrin e dytë. Rezulton se, Rektori i USH ka nënshkruar në datën 12.12.2022 kontratën e punës me pedagogen M.U., e cila rezulton që të ketë patur ngarkesën e saj mësimore vetëm në semestrin e dytë.

Gjatë lejes së barrë lindjes së detyrueshme, gruas 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes i ndalohet të punojë, por jo të hyjë në një marrëdhënie punësimi apo të nënshkruajë një kontratë pune.

Referuar procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Punësimit në USH, Komisioneri konstaton se, nga data 26.10.2022 kur ankuesja është shpallur fituese me vendimin e Departamentit të Financë Kontabilitetit, kalimit të afatit 5 ditor të ankimit parashikuar nga neni 21, të Rregullores dhe përcjelljes me datë 01.11.2022, nga ana e Dekanit të Fakultetit Ekonomik tek Rektori i USH, të kërkesave për angazhim të pedagogëve për vitin akademik 2022-2023, Rektori i USH ka patur detyrimin që të nënshkruajë kontratat me pedagogët e shpallur fitues, përfshi ankuesen, brenda 7 ditëve.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë ankuesja S.S., është diskriminuar për shkak të shtatzënisë, pasi:

- Ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me mos nënshkrimin e kontratës së punës si pedagoge me kohë të pjeshme për vitin akademik 2022-2023;
- Ankuesja e mbart shkakun e mbrojtur/ndaluar të diskriminimit, atë të shtatzënisë;
- USH, në cilësinë e punëdhënësit, ka dekaruar dhe ka pranuar se nuk ka nënshkruar kontratën e punës me ankuesen për shkak se ajo ka qenë me leje barrë lindje të detyrueshme për shkak të shtatzënisë, fillimisht me lejen e paralindjes dhe më pas me lejen e detyrueshme 63 ditore pas lindjes së fëmijës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, USH, pretendoi se ankuesja ndodhej në kushtet e ndalimit ligjor pasi ka qenë me leje barrë lindje të detyrueshme në kohën që ka shprehur interesin për t'u aktivizuar si staf akademik pranë USH. Ky pretendim i USH rezultoi i pabazuar, pasi gjatë kohës që ankuesja ka shprehur interesin dhe kanë përfunduar procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes nga komisioni përkatës pranë Fakultetit Ekonomik, Departamenti Financë Kontabilitet në datë 26.10.2022, ankuesja nuk ka qenë me leje barrë lindje të detyrueshme dhe përzgjedhja e ankuses si fituese i është komunikuar Rektorit të USH në datën 01.11.2022 nga ana e Fakultetit Ekonomik. Ankuesja ka marrë lejen e detyrueshme të paralindjes në datën 14.11.2022.

GJED, shprehet se: “... një grua nuk është e detyruar t’ia zbulojë punëdhënësit shtatzëninë e saj gjatë procesit të rekrutimit, ose në çdo fazë tjetër të punësimit”.¹⁹

Ankuesja ka patur mundësi efektive që të kryejë punën e saj deri në datën 14.11.2022 kur ka marrë lejen e detyrueshme të paralindjes, si dhe pas kthimit të saj nga leja e barrë lindjes prej 63 ditësh, pas lindjes së fëmijës.

USH pranoi se nuk ka nënshkruar kontratën e punës me ankuesen, pasi ajo ka qenë me leje barrë lindje të detyrueshme për periudhën 35 ditore para lindjes dhe për periudhën 63 ditore pas lindjes. Sipas USH, nënshkrimi i marrëdhënies së punës me ankuesen në kushtet e trajtimit me raportë për barrë lindje, përveç se përbën shkelje të ligjit, duke e deklaruar ankuesen si punonjëse aktive ndërkohë që ajo ishte përfituese e pagesave nga sigurimet shoqërore duke krijuar mbivendosje përfitimesh pasi do të merrte pagë nga USH, do të përbënte rrezik për jetën e nënës dhe fëmijës, për shkak të daljes së ankuses në punës gjatë periudhës që ligji e konsideron si “leje të detyrueshme”.

Komisioneri thekson se, momenti i nënshkrimit të kontratës së punës dhe kryerja e punës nga ana e ankuses, janë dy momente të ndryshme. Kodi i Punës, ndalon në mënyrë të shprehur, punën për gratë shtatzëna 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes, por jo punësimin e grave shtatzëna. Sipas Kodit të Punës, gratë shtatzëna ose me fëmijë në gjë nuk mund të punësohen në punë të rënda ose të rrezikshme, që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës. USH, nuk pretendoi se puna e cila do të kryhej nga ankuesja, në rastin konkret mësimdhënia në një institucion të arsimit të lartë, përfshihet në punët e rënda ose të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

Pas periudhës 63-ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore. USH nuk i ka ofruar mundësinë ankuses për të nënshkruar kontratën e punës me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023 edhe pas përfundimit të periudhës 63 ditore të pas lindjes edhe pse ajo ishte vlerësuar dhe përzgjedhur nga komisioni përkatës se përmbushte të gjitha kriteret për tu punësuar si staf akademik me kohë të pjesshme në USH. Pretendimi i USH se, ankuesja në asnjë moment nuk ka deklaruar ndërprerjen e lejes, do të ishte i bazuar në rast se USH do të provonte se i ka ofruar ankuses mundësinë e nënshkrimit të kontratës së punës pas kalimit të periudhës 63 ditore të paslindjes. Ndërprerja nga ana e ankuses e lejes së lindjes pas periudhës 63 ditore në kushtet kur nuk ka patur mundësinë të nënshkruante kontratën e punës, do të sillte si pasojë humbjen e të drejtës për të ripërfituar nga sigurimet shoqërore.

Komisioneri vlerëson se, trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm i ankuses, lidhur me mos nënshkrimin e kontratës së punës me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023 për shkak të

¹⁹ C-32/93, *Carole Louise Webb kundër EMO Air Cargo (UK) Ltd.*, 14 korrik 1994; C-320/01, *Wiebke Busch kundër Klinikum Neustadt GmbH & Co. Betriebs-KG*, 27 shkurt 2003.

shtatzënisë, nuk ka një justifik objektiv dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë Komisioneri konstaton se ankuesja është diskriminuar për shkak të shtatzënisë për të gëzuar akses të barabartë në punësim.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuses S.S., për shkak të *shtatzënisë*, në të drejtën për punësim, nga ana e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” duhet të marrë masa për ndalimin në të ardhmen të praktikave të ngjashme diskriminuese, të cilat kufizojnë të drejtën e grave për të patur akses të barabartë në punësim për shkak të shtatzënisë.

19. M.Rr., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

VENDIM NR. 268, DATË 15.10.2024

Shkaku: Gjinia dhe shtatzënia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në pozicionin e Ndhmës Specialistes në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Tiranë, pranë Forcës së Posaçme Operacionale. Ajo është transferuar në një strukturë tjetër policore gjatë periudhës së lejes së lindjes, duke u diskriminuar për shkak të gjinisë dhe shtatzënisë.

FAKTET

Ankuesja M.Rr., është punonjëse e Policisë së Shtetit prej rreth 7 vitesh. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ankuesja është emëruar në detyrën, Ndhmës specialist, në Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale, në Strukturën e Posaçme “*Operacioni Forca e Ligjit OFL*”, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjatë periudhës së lejes së lindjes, është vënë në dijeni se me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “*Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie*”, ankuesja me detyrë Ndhmës specialiste, në Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale për Mbështetjen Hetimore/Kërkimin, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale “Për shkak të implementimit të strukturës së re organike dhe nevoja pune”, është transferuar dhe emëruar në detyrën, Oficer i patrullës së përgjithshme trup shërbimi, në Seksionin e Patrullës së Përgjithshme, në Komisariatin e Policisë Nr. 4, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokolli 12 i saj;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) “*Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*” (CEDAW);
- Konventa Nr. 183 “*Mbrojtja e amësisë, 2000*”;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;

- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Rregullorja e Policisë së Shtetit;
- VKM Nr. 1139, datë 24.12.2020 “Për strategjinë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet 2021-2026 dhe të planit të veprimit 2021-2023”;
- Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore (2004).

KONKLUSIONE

Nga provat e administruara, rezultoi që gjatë implementimit të strukturës së re të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale, kanë qenë me leje lindje, ankuesja dhe 2 (dy) kolege të saj. Lidhur me këtë dhe për të bërë krahasimin nëse ankuesja dhe koleget e saj kanë qenë në të njëjtat kushte, Komisioneri iu drejtua me e-mail DPPSH-së, më datë 02.10.2024, duke i kërkuar informacion sa i përket kohës kur kanë filluar lejen e lindjes dhe kthimit prej saj, të kolegeve të ankueses. Duke qenë se DPPSH-ja nuk vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, nuk arriti të provojë pretendimin se ankuesja dhe koleget e saj kanë qenë në të njëjtat kushte me të.

Gjithashtu, nga 25 punonjësit e policisë së transferuar nga Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale në struktura të tjera, janë rikthyer 2 prej tyre. Edhe pse Komisioneri kërkoi informacion sa i përket gjinisë së punonjësve të rikthyer në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, informacion i cili nuk iu vu në dispozicion, nga analiza e bërë parashtrimeve të bëra nga ana e ankueses, të cilat nuk janë kundërshtuar nga DPPSH, presumohet se punonjësit e rikthyer janë burra. Gjithashtu, edhe pse nga ana e ankueses përmes një kërkesë me shkrim është parashtruar fakti që të shihet mundësia e rikthimit në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale dhe arsyet përkatëse, kjo kërkesë nuk është marrë në konsideratë nga ana e strukturave të DPPSH-së, duke mos rikthyer atë por duke rikthyer dy punonjës të tjerë burra.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, DPPSH dështoi të provonte përpara Komisionerit se:

- Cilat ishin konkretisht nevojat e punës për të justifikuar transferimin si dhe të tregonte që transferimi i ankueses ishte i vetmi mjet efektiv për të plotësuar këto nevoja.
- Nuk solli para Komisionerit fakte dhe prova, sa i takon kritereve të vendosura dhe procedurës së ndjekur për të vlerësuar punonjësit që duhet ti nënshtroheshin transferimit gjatë implementimit të strukturës së re të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale.
- Kishte arsye objektive dhe të justifikuar për të transferuar ankuesen gjatë periudhës së lejes së lindjes, në një pozicion pune ku ishte e detyruar të punonte me 3 (tre) turne, duke mos marrë në konsideratë mbrojtjen ligjore të ofruar nga neni 64, i Ligjit Nr. 108/2014 “Për

Policinë e Shtetit”, i cili ndalon punën e natës për punonjëset e policisë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gjë.

- Edhe pse ka patur mundësinë e rikthimit të ankueses në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, nuk ka kthyer atë por ka kthyer dy punonjës të tjerë burra, në pozicionin e Ndhmës specialistit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkak të gjinisë dhe shtatzënisë së ankueses.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses M.Rr., në të drejtën për punësim, për shkak të *gjinisë* dhe *shtatzënisë*, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës si Ndhmës specialiste, pranë Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale ose një pozicion pune të pershtatshëm dhe në respektim të standardeve dhe detyrimeve ligjore të sipërpërmendura në këtë vendim.

V. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQËRORE

20. A.A., kundër Përgjegjësit të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
(ZV ASHK) Tropojë

VENDIM NR. 114, DATË 24.04.2024

Shkaku: Gjendja shoqërore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja është diskriminuar nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Tropojë, pasi mohimi i të drejtës për punësimin e saj, duke keqinterpretuar dhe keq zbatuar legjislacionin në fuqi, është motivuar për shkak të gjendjes së shoqërore të saj, paragjykit si person nën hetim nga organet përkatëse.

FAKTET

A.A., ka përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në programin “Edukim Fizik dhe Sporte”. Ajo ka aplikuar përmes portalit e-Albania, për zhvillimin e Praktikës Profesionale pranë institucioneve arsimore të ZVAP Tropojë, por është refuzuar nga kjo e fundit me arsyetimin se ankuesja ka qenë në proces hetimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Në faqen e Facebook, ZVAP Tropojë ka publikuar²⁰ “Njoftim mbi vendet e lira të punës pas procedurave të Lëvizjes Paralele për vitin shkollor 2023-2024 në IAP të ZVAP Tropojë”. Referuar publikimit të bërë, ankuesja ka konstatuar se në ZVAP Tropojë janë 4 (katër) vende të lira për mësues të edukimit fizik.

Në këto kushte, përmes Postës Shqiptare, ka dërguar pranë ZVAP Tropojë, dokumentacionin dhe aplikimin e saj për punësimin në një prej vendeve të lira të publikuara për mësues të edukimit fizik.

ZVAP Tropojë, nuk ka pranuar aplikimin e ankuses me arsyetimin se ajo nuk kishte depozituar dokumentacionin dhe aplikimin e saj për punësimin në një prej vendeve të lira të publikuara për mësues të edukimit fizik. Sakaq, për këtë arsye nuk ishte vlerësuar nga ZVAP Tropojë dosja e ankuses për vitet shkollore 2022-2023 dhe 2023-2024.

²⁰https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid0kC5tQ6jzrS4y8o3VnLWeSSC8WxvbnWqovjCMzhRyKsJE_A4MjuRcbKVGeFZZUovMI&id=100064187433283&mibextid=WiMSqg
https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02b88Qn4gLETyGzDGEwUqD6XHNNbHkijNJx2Lkw1egTraK7wvdm13rDiqkXhjbY1dGl&id=100064187433283&mibextid=WiMSqg

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Protokolli 12-të i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Konventa për Dhunën dhe Ngacmimin, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO, 1986)
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr. 17, datë 26.7.2023, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2012 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar;*
- Urdhri Nr. 100, datë 25.02.2022, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “*Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe zhvillimin e Praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit*”.

KONKLUZIONE

Referuar fakteve të administruara, Komisioneri gjykoi se ankuesja nuk ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme, nga ana e ZVAP Tropojë, sa i përket mospranimit të aplikimit të saj për zhvillimin e praktikës profesionale, pasi, referuar akteve nënligjore cituar në vendim, ZVAP Tropojë ka vepruar në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Sa i përket aplikimit të ankueses për punësimin e saj në një prej vendeve të lira të publikuara për mësues të edukimit fizik, në institucionet arsimore të ZVAP Tropojë, Komisioneri konstatoi se ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e ZVAP Tropojë, përse i takon mohimit të të drejtës për punësim.

Njëkohësisht, rezultoi i provuar e dokumentuar fakti që ankuesja e mbarte shkakun e gjendjes shoqërore, si person nën hetim lidhur me akuzat për disa vepra penale, si: “Shpërdorim detyrë”, “Falsifikim të dokumenteve”, “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, “Kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik”, etj.

Komisioneri konstatoi se, ZVAP Tropojë, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për emërimin e mësuesve në arsimin parashkollor, nuk provoi se:

- Ankuesja nuk është punësuar si mësuese e edukimit fizik në një nga pozicionet e lira në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tropojë për shkak se nuk ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar apo për shkak të mosplotësimit të kriterëve të pozicionit të punës;
- Nuk u sollën prova, fakte a dokumente që dokumentacioni i kërkuar ankueses (vërtetim nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetim nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim), i është kërkuar edhe kandidatëve të tjerë të cilët janë emëruar apo kanë aplikuar për punësim në pozicionet e lira si mësues të edukimit fizik, në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tropojë. Në këtë rast, vetëm ankuesja është ngarkuar me detyrimin e dorëzimit të vërtetimit nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetimit nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim.

Për më tepër, Komisioneri evidentoi se, nga ana e ZVAP Tropojë, duke interpretuar në mënyrë të gabuar legjislacionin në fuqi, ankuesja është vënë në të njëjtat pozita me të dënuarit me vendim penal të formës së prerë apo ata të dënuar për vepra penale të natyrës seksuale edhe pse ajo nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e sipërpërmendura. Pra, haptazi ishte keqzbatuar dhe keqinterpretuar kompetenca e ZVAP Tropojë, duke e vënë ankuesen në kushte të pabarabarta me persona të tjerë dhe duke i kërkuar dokumentacion shtesë nga ai i kërkuar kandidatëve të tjerë, si dhe nga ai i kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Pra, haptazi ishte keqinterpretuar dhe keqzbatuar legjislacioni në fuqi, duke mos e pranuar kërkesën për punësimin e saj, me arsyetimin se nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar (*vërtetim nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetim nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim*) dhe duke e vënë në pozita të barabarta me persona të dënuar për vepra penale të natyrës seksuale.

Komisioneri vëren gjithashtu se, ZVAP Tropojë, ka patur dijeni lidhur me faktin që ankuesja ka qenë nën hetim nga ana e Prokurorisë Tropojë dhe në gjykim nga ana e Gjykatës Kukës, për shkak se këtë dokumentacion e ka dorëzuar në momentin që ka aplikuar për zhvillimin e praktikës profesionale.

Në këtë kontekst, ZVAP Tropojë, me veprime konkludente ka dëshmuar se pikërisht se për këtë shkak i ka mohuar të drejtën për punësimin e saj si mësuese e edukimit fizik, duke paragjykuar se ajo ishte person nën hetim nga organet përkatëse, dhe ky fakt provohet nga përgjigjet e përcjella ankueses dhe KMD-së nga ana e ZVAP Tropojë, duke cenuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të subjektit ankues, A.A., në të drejtën për punësim, nga ana e ZVAP Tropojë, për shkak të gjendjes shoqërore të saj.

- Konstatimin e mosdiskriminimit, të subjektit ankues, A.A., në të drejtën për punësim, nga ana e ZVAP Tropojë, për shkak të gjendjes arsimore.
- Në referim të pikës 1, ZVAP Tropojë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke pranuar aplikimin e A.A., për punësimin e saj si mësuese e edukimit fizik me kontratë me afat të caktuar, nga jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë", në një nga pozicionet e lira të punës në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tropojë.

21. G.B., kundër Fondacionit “Save the Children Albania”

VENDIM NR. 154, DATË 27.05.2024

Shkaku: Gjendja shoqërore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Fondacionit “Save the Children Albania”. Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës dhe nuk i është rinovuar kontrata, duke e diskriminuar për shkak të gjendjes shoqërore, si person nën hetim nga organet përkatëse.

FAKTET

Që nga Marsi i vitit 2020 e në vazhdim, ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Fondacionit “Save the Children Albania” si drejtues i projektit “Shkollat për Shëndetin”.

Donator i projektit në kuadër të të cilit është punësuar ankuesi është Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe projekti zbatohet nga Fondacioni “Save the Children Albania” nën mbikqyrjen e organizatës mëmë “Save the Children Switzerland”, kjo e fundit organizatë e cila është shpallur fituese e këtij projekti. Afati i përfundimit të këtij projekti është data 28 Shkurt 2025.

Referuar termave të referencës të publikuara në tenderin e shpallur nga donatori për projektin “Shkollat për Shëndetin” në lidhje me pozicionin “Drejtues Projekti”, konstatohet se, kërkohet në mënyrë specifike që drejtuesi i projektit të ketë eksperiencë në fushën e shëndetësisë.

Ankuesi ka qenë pjesë e dokumentacionit të aplikimit për tenderin e shpallur nga donatori Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, si drejtues i propozuar i këtij projekti. G.B., ka patur gjithsej 4 kontrata me afat të përcaktuar 1 vjeçar me Fondacionin “Save the Children Albania”.

Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe punëdhënësit kanë vijuar normalisht deri në momentin kur në bazë të Vendimit Nr. 102, datë 18.08.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ankuesi është vendosur person nën hetim.

Rezulton se, nëpërmjet *e-mailit* të datës 21.08.2023, Drejtorja Ekzekutive e Fondacionit “Save the Children Albania”, i ka komunikuar stafit të projektit se, “Save the Children” kishte pezulluar përkohësisht kompetencat nënshkruese të ankuesit dhe roli i tij përfaqësues i projektit do të qëndronte në pritje deri në një njoftim tjetër.

Në vijim, ankuesi është njoftuar nga ana e punëdhënësit se marrëdhënia e punës do të përfundojë në afatin e përfundimit të kontratës në datë 28.02.2024, për shkak se, në kuadër të procesit të ristrukturimit bazuar në kërkesat operationale të Fondacionit ishte vendosur që pozicioni i punës së ankuesit nuk do të jetë më në strukturën organizative të Fondacionit.

Më datë 18.12.2023, punëdhënësi/Fondacioni “Save the Children Albania” i ka komunikuar ankuesit vendimin për zgjidhjen e kontratës individuale të punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokollin 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Mbështetur në analizimin e fakteve e provave të administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se ankuesi G.B., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm, nga ana e punëdhënësit/Fondacioni “Save the Children Albania”, lidhur me dy momente:

- Pezullimin e kompetencave si drejtues i projekti “Shkollat për Shëndetin”;
- Zgjidhjen e kontratës së punës për pozicionin e sipërcituar dhe mosrinovimit të saj.

Ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e punëdhënësit/Fondacioni “Save the Children Albania” përsa i takon pezullimit të kompetencave të pozicionit të tij të punës si drejtues i projektit “Shkollat për Shëndetin”.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, statusi i tij si person nën hetim, gëzon mbrojtje në kuadër të shkakut të “gjendjes shoqërore, i cili është një shkak që gëzon mbrojtje nga diskriminimi sipas nenit 1, të LMD dhe bazuar në provat e administruara, provohet se ankuesi e mbart shkakun e pretenduar.

Punëdhënësi/Fondacioni “Save the Children Albania” gjatë shqyrtimit të ankesës pranoi se, shkakut ose arsyeja e pezullimit të kompetencave të ankuesit si drejtues i projektit “Shkollat për Shëndetin” ishte fakti që ankuesi ishte marrë si person nën hetim.

Në këto kushte Komisioneri vlerësoi se, trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi lidhur me pezullimin e kompetencave është pasojë e drejtëpërdrejtë e statusit të ankuesit si person nën hetim dhe rrjedhimisht e shkakut të mbrojtur “gjendja shoqërore”. Në këto kushte kur provohet lidhja shkakësore midis trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi dhe shkakut të mbrojtur, bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon punëdhënësit/Fondacionit “Save the Children Albania” që të tregojë që ky trajtim mund të justifikohet. Siç është theksuar edhe më sipër, një justifikim i tillë duhet të jetë objektiv dhe i arsyeshëm ose, me fjalë të tjera, ai duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Punëdhënësi deklaroi se, ndërprerja e përkohshme e disa kompetencave të ankuesit, pa e cenuar pagën, ka patur si me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen nga paragjykimet e të gjithë aktorëve që janë pjesë e projektit. Fondacioni thekson se, si një organizatë me eksperiencë të gjatë përballen çdo ditë me vlerësime, llogaridhënie dhe raporte transparence tek donatorët, është e pamundur të shmanget vëmendja e donatorit në prani të këtyre lajmeve (i referohet çështjes penale ku ankuesi është person nën hetim) dhe ndaj personave që kanë impakt në menaxhimin e projekteve.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i synuar nga ana e punëdhënësit për të ruajtur dhe mbrojtur organizatën nga paragjykimet e aktorëve që janë pjesë e projekti, është në vetvete paragjyqës, për sa kohë që si person nën hetim, ankuesi prezumohet i pafajshëm, për sa kohë që nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë që e deklaron atë fajtor për konsumimin e veprave penale të të cilat akuzohet. Rrjedhimisht, punëdhënësi nuk mund të pretendojë si qëllim të ligjshëm mbrojtjen nga paragjykimi e të tretëve, duke paragjykuar ankuesin, i cili gëzon të drejtën e prezumimit të pafajësisë.

Në kushtet kur, qëllimi i synuar nga ana e punëdhënësit lidhur me kufizimin e kompetencave të ankuesit (disa prej kompetencave), nuk vlerësohet si një qëllim i ligjshëm, është e panevojshme që të vijohet me analizën dhe vlerësimin nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Në lidhje me momentin e pezullimit të kompetencave, konstatohet se ndryshe nga pretendimi i punëdhënësit se pezullimi i kompetencave (disa prej tyre) ka qenë i përkohshëm, pezullimi i kompetencave ka vijuar deri në përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit dhe këtij të fundit nuk i janë rikthyer në asnjë moment kompetencat e pezulluara në datë 21.08.2023 dhe pavarësisht faktit se, në bazë edhe të vlerësimeve të bëra nga ana e vetë punëdhënësit masat e marra kishin patur efekte pozitive.

Megjithatë, edhe nëse qëllimi i synuar do të konsiderohej si i ligjshëm, Komisioneri vlerësoi se, nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Punëdhënësi deklaroi se sa i takon G.B., i cili mbante një pozicion drejtues dhe duhej të shmangej paraqitja e tij publike dhe duke marrë shkas nga përmasat mediatike që mund të merrte çështja, u vlerësua pezullimi i kompetencave të tij si drejtues projekti. Gjatë seancës dëgjimore, Drejtoresha Ekzekutive e Fondacionit “*Save the Children Albania*” deklaroi gjithashtu se, masat e marra kishin dhënë rezultat dhe nuk pati asnjë interesim nga mediat të cilat të kërkonin informacion apo ndonjë pronocim në lidhje me punën e ankuesit pranë fondacionit.

Sa më sipër, rezultoi se punëdhënësi e lidh ruajtjen dhe mbrojtjen e reputacionit të organizatës me shmangien mediatike dhe mos ekspozimin në media. Duke mbajtur në konsideratë se: pezullimi i kompetencave për përfaqësimin nga ana e ankuesit të Projektit dhe të drejtën e nënshkrimit për një periudhë të pacaktuar edhe pse punëdhënësi pretendoi se pezullimi i kompetencave ishte i përkohshëm; mos rikthimi i kompetencave të pezulluara edhe pasi punëdhënësi ka vlerësuar se masat kishin dhënë efekte pozitive dhe nuk kishte patur interesim nga ana e mediave apo fakti që, punëdhënësi mund të përdorte mjete më pak kufizuese dhe që mund të shkaktonin padrejtësinë minimale të ankuesit, duke parapërgatitur deklaratën publike në rast të interesimit nga ana e medias, Komisioneri vlerëson se, nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura pra pezullimi i kompetencave të ankuesit dhe qëllimit që kërkohet të realizohet, ruajtja dhe mbrojtja e reputacionit të organizatës.

Nuk mund të mos mbahet në konsideratë fakti se, ankuesi nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit dhe çështja për të cilën ankuesi është marrë si person nën hetim daton në vitin 2015 dhe nuk ka të bëjë me pozicionin e punës së ankuesit si Drejtues Projekti pranë punëdhënësit. Në këtë kuptim edhe interesi mediatik, nëse do kishte patur, ishte i lidhur me veprime të prezumuara të ankuesit për një periudhë kohore të shumë viteve më parë, me situatë dhe subjekte krejtësisht të ndryshme nga punëdhënësi. Për rrjedhojë, nuk kuptohet lidhja shkakësore dhe objektiviteti e proporcionaliteti i masave të marra, me qëllimin hipotetik që synohej të arrihej.

Bazuar në arsyet dhe analizën e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin të cilit i është nënshtruar ankuesi, në lidhje me pezullimin e disa kompetencave të tij si drejtues i projektit “Shkollat për Shëndetin”.

Gjithashtu, Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesi, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e Fondacionit “*Save the Children Albania*”, në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës dhe mosrinnovimit të saj. Nga ana tjetër, rezultoi i bazuar dhe i provuar shkaku i mbrojtur “gjendja shoqërore” pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues për

zgjidhjen e kontratës së tij të punës, si dhe fakti që punëdhënësi ka patur dijeni për shkakun e mbrojtur, pra për statusin e ankuesit si person nën hetim.

Duke mbajtur parasysh:

- të gjitha faktet dhe rrethanat e marra në shqyrtim në kuadër të analizës së bërë lidhur me procesin e ristrukturimit dhe konkluzionin e arritur se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës dhe mosrinovimin e saj si drejtues projekti;
- faktin se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm për sa i përket pezullimit të disa kompetencave si drejtues projekti dhe se arsyeja e pezullimit e deklaruar nga vetë punëdhënësi, ka qenë fakti që ankuesi është marrë si person nën hetim;
- faktin që punëdhënësi deklaroi se, situata e ankuesit dhe statusi i tij si person nën hetim, përbën arsye për paragjykim ndaj organizatës nga ana e aktorëve të projektit por edhe vlerësimeve të organizatës në përgjithësi nga ana e donatorëve;
- faktin se, nëse për punëdhënësin pezullimi i disa kompetencave të ankuesit ishte vlerësuar si një mjet për të ruajtur dhe mbrojtur organizatën nga paragjykimet e aktorëve të projektit, vijimi i marrëdhënies së punës me ankuesin do të përbënte për punëdhënësin një situatë në të cilën paragjykimi i pretenduar do të vazhdonte për sa kohë që ankuesi do të vijonte marrëdhënien e punës me punëdhënësin.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, Fondacioni “Save the Children Albania” e ka diskriminuar ankuesin G.B., në të drejtën për punësim, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës për pozicionin “Drejtues i Projektit Shkollat për Shëndetin”, për shkak të gjendjes së shoqërore, pra gjendjes/statusit të tij si person nën hetim nga organet përkatëse.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit G.B., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes shoqërore, nga ana e Fondacionit “Save the Children Albania”.
- Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, Fondacioni “Save the Children Albania”, duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - ✓ Të rivendosë në vend të drejtën e shkelur duke e rikthyer (rinovuar kontratën) ankuesin në pozicionin e punës “Drejtues i Projektit Shkollat për Shëndetin”.
 - ✓ Të marrë masa për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla diskriminuese.

VI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

22. J.H., kundër Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Zyrës
Vendore Arsimore Tiranë

VENDIM NR. 47, DATË 14.02.2024

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën “1 Maji”, Tiranë, e ka vënë ankuesen në pozita të pafavorshme dhe e ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar të saj.

FAKTET

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është nëna e fëmijës R.N., e datëlindjes 30.04.2015, e cila për vitin shkollor 2023-2024, ka qenë nxënëse në klasën e I-rë në Shkollën “1 Maji”, Tiranë. Vajza është me aftësi të kufizuar (*qëndron në karrocë*) dhe nuk akseson dot shkollën pasi godina e saj nuk ka ashensor. Vajza ka ndjekur parashkollorin në këtë shkollë gjatë vitit 2022-2023 dhe klasa ka qenë e vendosur në katin e parë të shkollës dhe nuk pengohej aktiviteti mësimor. Gjatë vitit 2023-2024, vajza ka ndjekur klasën e parë dhe mësimin e zhvillonte në katin e tretë të shkollës. Për këtë arsye, vajza ngjitej dhe zbriste nga klasa në krahë nga familjarët. Gjatë aktivitetit mësimor ajo asistohet nga mësuesja kujdestare, mësuesja ndihmëse (2 orë) dhe stafi psiko-social. Vështirësitë e vajzës në këtë shkollë lidheshin me:

- Mungesën e një tavoline dhe karrige për fëmijët me aftësi të kufizuar.
- Mungesën e tualeteve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.
- Mungesën e aksesueshmërisë së ambienteve të tjera të shkollës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 *“Për statusin e invalidit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Gjatë shqyrtimit të ankesës, nga palët u pranua fakti se Shkolla 9-vjeçare “1 Maji”, Tiranë, nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë, u arrit në përfundimin se, ky objekt arsimor nuk plotëson standardet dhe kriteret teknike të parashikuara nga VKM Nr. 1503/2008.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se, Shkolla 9-vjeçare “1 Maji”, në Bashkinë Tiranës, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që ndjekin arsimin në këtë objekt arsimor. Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se, fëmija me aftësi të kufizuara R.N., trajtohej në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike e vendoste atë përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të nxënësve që nuk kanë aftësi të kufizuara dhe nuk përballen me barriera/pengesa sikundër nxënësit me aftësi të kufizuara, nga Bashkia Tiranë.

Sa më sipër, rezultoi plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur, që në rastin konkret është aftësia e kufizuara, dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshkruar fëmija R.N., e cila është me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe përdoruese e karrocës me rrota, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë, të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar, e në mënyrë të veçantë mungesës së ashensorit në godinën e Shkollës 9-vjeçare “1 Maji”, Tiranë.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se, Shkolla 9-vjeçare “1 Maji” përveç rampës në katin e parë për të aksesuar hyrjen në shkollë nuk plotëson kushtet/standartet për të mundësuar aksesimin e ambienteve të tjera në këtë shkollë nga personat me aftësi të kufizuara, sipas

parashikimeve ligjore në fuqi. Në këto kushte, duke mos përmbushur këto standarde, shkolla nuk ishte e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Bashkia Tiranë nuk depozitoi asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë e shkollës për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi. Çfarë investimesh janë realizuar ndër vite në institucionet arsimore dhe a kanë prekur këto investime aspekte që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë e godinave. Çfarë masash janë marrë për evidentimin e nevojave për përshtatshmërinë e godinës së shkollës. A është bërë një planifikim i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatet kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstatoi se, Bashkia Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka reaguar ndaj këtij problemi, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji”, përfshi edhe vajzën e ankueses.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji” në Bashkinë Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për fëmijën R. N, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Tiranë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt arsimor.

Në këto kushte, Komisioneri arriti në përfundimin se, Bashkia Tiranë, nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar fëmija me aftësi të kufizuara R.N., vajza e ankueses, e cila ndjek arsimin e detyrueshëm fillor në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji” duke e diskriminuar në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të fëmijës R.N., në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Tiranë.
- Konstatimin e mosdiskriminimit nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë.
- Bashkia Tiranë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përshpejtuar aksesueshmërinë në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji”, Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- Bashkia Tiranë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve arsimore, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet aksesueshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

23. M.H., kundër Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë

VENDIM NR. 67, DATË 18.03.2024

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Nxënësi O.H., është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, në të drejtën e tij për t'u arsimuar nga ana e Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë dhe Zyrës Vendore e Arsimit Tiranë.

FAKTET

Ankuesi M.H., është babai i një djali me aftësi të kufizuar të quajtur O.H., i datëlindjes 05.07.2003 dhe përfaqëson në këtë proces, djalin e tij, i cili është banues në Laprakë, Bashkia Tiranë. O.H., është vlerësuar me dy diagnoza, e para çrregullim i spektit autik dhe e dyta aftësia e kufizuar intelektuale (prapambetje mendore).

Ky fakt është evidentuar dhe në Planit të Edukimit Individual (PEI) për vitin mësimor 2022-2023 të vënë në dispozicion nga ana e Gjimnazit “Aleks Buda”, ku nxënësi O.H., është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, diagnostifikuar me sindromën down dhe prapambetje mendore të rëndë.

Djali i ankuesit, nxënësi O.H., ka përfunduar klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët me kohë të plotë në vitin shkollor 2021-2022, pranë shkollës 9-vjeçare publike “Dhora Leka” Tiranë. Më datë 15.09.2022 është mundësuar regjistrimi i tij në klasën e X (dhjetë) në vitin shkollor 2022- 2023 në Gjimnazin “Aleks Buda” Tiranë.

Me shkresën datë 07.12.2022 të ZVAP Tiranë, me lëndë: “*Dërgim i orëve për nxënësit me aftësi të kufizuar*”, drejtuar Gjimnazit “Aleks Buda”, është rekomanduar që për nxënësin O.H., të caktohet mësuese ndihmëse për 18 orë.

Referuar Vlerësimit Psiko-Edukativ datë 31.5.2023 të Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë, ndër të tjera janë rekomanduar strategji dhe mënyra për të ndihmuar nxënësin dhe për të lehtësuar situatën, por dhe nevojën për të ofruar shërbime.

Nxënësi O.H., ka përfunduar klasën e X (dhjetë) gjatë vitit shkollor 2022-2023 dhe ka rezultuar ngelës në gjashtë lëndë mësimore. Gjatë gjithë vitit shkollor, referuar informacionit të administruar, është vlerësuar nga komisioni multidisiplinar dhe është trajtuar me mësues ndihmës me 18 (tetëmbëdhjet) orë mësimore në ditë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plan i Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se nxënësi O.H., djali i ankuesit, i është nënshtruar një një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke u ngelur në klasë në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi që rregullojnë arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar dhe si pasojë i është refuzuar vazhdimi i klasës e X (dhjetë), pranë Gjimnazit “Aleks Buda”, për vitin shkollor 2023-2024. Rezulton gjithashtu e provuar si nga përgjigjet e Gjimnazit, por dhe të shprehura nga V.B., që arsyeja e mosregjistrimit në klasën e X (dhjetë) (nxënës i cili ishte i regjistruar), është mosha e nxënësit, qëndrim i cili u vlerësua i padrejtë si nga MAS dhe ZVAP Tiranë.

Komisioneri gjatë shqyrtimit të ankesës konstatoi:

- Nxënësi O.H., djali i ankuesit M. H, është trajtuar në mënyrë të diferencuar, të padrejtë, të pafavorshme krahasuar edhe me nxënësit tjerë me AK, duke u ngelur në klasë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Nxënësi O.H., ishte në vijimësi dhe nuk mund të diskutohej më regjistrimi i tij në këtë Gjimnaz, pasi ishte e njëjta situatë si një vit më parë, arsyetim i cili u mbështet gjatë procedurës hetimore dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë.
- Gjimnazi, nuk ka marrë asnjë masë paraprake për të diskutuar apo dhënë zgjidhje situatës së krijuar, por ka vendosur ndërprerjen e arsimit për nxënësin O.H., në kundërshtim me parashikimet ligjore për arsimin parauniversitar.

- Zyra Vendore e Arsimit Tiranë, nuk rezulton që të ketë dërguar dosjen e plotë me rekomandimet konkrete në lidhje me nxënësin O.H., nuk rezulton të ketë përdorur të gjithë mekanizmat dhe kapacitetet e saja për të ndjekur, identifikuar por dhe kontribuar më shumë në lidhje me nxënësit me AK, që situata të tilla mos të përsëriten.
- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk ka rishikuar në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të personave me AK në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave.

Ndërkohë, për arsye të mënyrës se si është vepruar nga ana e Gjimnazit në lidhje me rastin e nxënësit O.H., gjatë vitit mësimor 2022 - 2023, nga DRAP Durrës, me Vendimin Nr. 23/2023 datë 31.10.2023, është vendosur: *“Të jepet masë disiplinore “Vërejtje” për drejtoren e Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë, V.B.,”* por që pavarësisht këtij fakti në vlerësim të Komisionerit përgjegjësia sa i takon rastit objekt shqyrtimi është dhe e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, e cila nuk e ka monitoruar rastin dhe nuk ka patur një bashkëpunim efektiv institucional me Gjimnazin “Aleks Buda” për trajtimin e këtij rasti, situatë e cila mund të ishte shmangur nëse ky institucion do të kishte zbatuar detyrimet ligjore që ZVAP-ja ka sipas Rregullores *“Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*, miratuar nga MASR me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020.

Komisioneri konstatoi se, në rastin objekt shqyrtimi, trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar nxënësi O.H., është pasojë e drejtpërdrejtë e faktit që ai është person me aftësi të kufizuar.

Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, ka argumentuar se nxënësi O.H., është refuzuar për t’u regjistruar në klasën e X (dhjetë), për vitin shkollor 2023-2024, për shkak se ka mbushur moshën 18 vjeç, duke ju referuar parashikimeve të Ligjit Nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.

Ndërkohë sqarojmë që nxënësi O.H., ka qenë i regjistruar në këtë Gjimnaz për vitin shkollor 2022-2023, në bazë të shkresës Nr. 8762 Prot., datë 15.09.2022 të Zyrës Arsimore Shkodër, ku ndër të tjera është cituar se: *“Ky nxënës përbën një rast përjashtimor dhe me prioritet edhe pse ka tejkaluar moshën e përcaktuar në LAPU, pasi është me aftësi të kufizuar (Sidroma down). Mbështetur në orientimin e MAS për rastin, si dhe referuar të drejtave të përcaktuara me ligj dhe akte ndërkombëtare, nxënësit me aftësi të kufizuara referuar edhe përcaktimeve që jep Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, të mos i privohet e drejta për arsimim në institucionin arsimor, të cilin ai e ka zgjedhur si më të përshtatshëm. ZVA aprovon regjistrimin në klasën e dhjetë me kohë të plotë të këtij nxënësi për mos i sjellë vështirësi të tjera të gjendjes së tij shëndetësore dhe psikologjike.”*

Komisioneri konstaton se, Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, së pari nuk duhet ta kishin ngelur nxënësin në klasë, e më pas të kishin refuzuar regjistrimin e nxënësit O.H., në klasën e X (dhjetë),

si përsëritës, duke qenë se ai ishte nxënës i këtij gjimnazi dhe kishte ndjekur vitin shkollor 2022-2023.

Fakti që Gjimnazi, nuk ka patur në vëmendje interesin më të lartë të nxënësit dhe detyrimet që qeveria shqiptare është e angazhuar në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik, ka vendosur në kushte të diskriminuese nxënësin O.H., për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar të drejtën për arsim, nxënësit i është refuzuar e drejta për regjistrimin në gjimnaz, atij nuk i është ofruar asnjë alternativë tjetër, e parashikuar në Ligjin Nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, por thjesht nga ana e Gjimnazit është kthyer përgjigje që pranimi i tij nuk mund të bëhet për arsye të moshës së tij mbi 18 vjeç.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi në tërësi se, ngelja në klasë e nxënësit me aftësi të kufizuar si dhe refuzimi për të regjistruar nxënësin O.H., në klasën e X (dhjetë) nga ana e Gjimnazit “Aleks Buda”, nuk është një veprim i mbështetur në një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë dhe Zyra Vendore e Arsimit Tiranë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë diskriminuar nxënësin O.H., për shkak të aftësisë së kufizuar, në të drejtën e tij për t’u arsimuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të nxënësit O.H., në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë.
- Në referim të pikës 1, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, të rishikojë në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave sipas legjislacionit në fuqi.
- Në referim të pikës 1, Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë të marrë masa që të ndalojë dhe të mospërsërisë në të ardhmen praktika të ngjashme me rastin e nxënësit O.H.
- Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, të marrin masa që në të ardhmen të mbahet në vëmendje nga ana e tyre, mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

24. Shoqata “Shpresë për të verbërit”, kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 93, DATË 11.04.2024

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Shërbime
Statusi: Në proces

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë në trotuaret në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët.

FAKTET

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj për mbrojtjen e anëtarëve të saj që janë persona me aftësi të kufizuar në shikim. Pala ankuese pretendon se, mungesa e aksesueshmërisë (shiritat vijëzues dhe semaforët akustikë) në segmentin rrugor, nga kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, në rrugën e Durrësit, Bashkia Tiranë, diskriminon personat me aftësi të kufizuar në shikim, të cilët për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në këtë segment rrugor, nuk mund të lëvizin dhe të jetojnë në mënyrë të lirë dhe të pavarur.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUSIONE

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, në rrugën e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, në Bashkinë Tiranë, mungonin shiritat vijëzues/vijat relievore për orientimin e personave që nuk shikojnë dhe semaforët nuk janë të pajisur me sinjalizim zanor/akustikë për personat që nuk shikojnë. Këto mungesa/mangësi përbëjnë pengesë infrastrukturore dhe nuk lejojnë, pengojnë ose vështirësojnë personat me aftësi të kufizuara në shikim për të lëvizur të lirë dhe të pavarur.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Tiranë, në segmentin rrugor, rruga e Durrësit, Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, nuk ka respektuar standardet e miratuara që duhet të përmbushin sipërfaqet publike, rrugët për këmbësorë, trotualet dhe semaforët, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në shikim. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara në shikim, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuara. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara në shikim, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk e kanë këtë aftësi të kufizuar, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, Bashkia Tiranë, nuk paraqiti asnjë informacion dhe dokumentacion përpara Komisionerit lidhur me planifikimin e fondeve për përshtatjen/aksesueshmërinë e rrugëve vendore, trotualet dhe sinjalizimit rrugor për personat me aftësi të kufizuara, përfshi personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Bashkia Tiranë nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë dhe shërbimet që ofrohen në aksin rrugor që është objekt i ankesës në shqyrtim, si një aks qarkullimi kryesor në Bashkinë Tiranë, Komisioneri vlerëson se, rruga e Durrësit, nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, është një segment rrugor me frekuencë të lartë të frekuentimit në jetën e përditshme nga qytetarët, ndryshe nga rrugë të tjera

dytësore që në varësi të pozicionit dhe shërbimeve që ofrohen, mund të mos lindi nevoja që të frekuentohen në mënyrë të përditshme. Rezulton se në gjatësinë e këtij segmenti rrugor janë të vendosura dhe ofrojnë shërbime të përditshme shumë institucione publike dhe private që ofrojnë shërbime kryesore të nevojshme për banorët e këtij qyteti si: Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucione arsimore, institucione financiare, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore etj. Për të funksionuar në mënyrë efektive dhe të sigurt në punë, arsim dhe jetën e përditshme, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses fizik në të njëjtat hapësira, punësim, mallra, shërbime dhe pjesëmarrje në komunitet, si të gjithë qytetarët e tjerë.

Pavarësisht se nga ana e Bashkisë Tiranë nuk u vendos në dispozicion asnjë informacion në lidhje me investimet e realizuara në këtë segment rrugor, është një fakt i njohur publikisht se, rikonstruksioni i segmentit rrugor objekt shqyrtimi, është bërë vitet e fundit. Komisioneri konstaton se, Bashkia Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike²¹ që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, të Bashkisë Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara në shikim, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se, nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Tiranë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shikim në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në këto kushte, Komisioneri konstatoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara në shikim. Për rrjedhojë Komisioneri arriti në përfundimin se, trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara në shikim, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në shikim, nga ana e Bashkisë Tiranë, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, Tiranë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Tiranë, të marrë masa të menjëhershme për:

²¹ VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

- a. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në segmentin rrugor, rruga e Durrësit nga Kryqëzimi tek Muzeu e deri tek Zogu i Zi, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha rrugëve vendore, trotuarëve dhe sinjalizimit rrugor, për të cilat nevojitet aksesueshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

25. Fondacioni “Së Bashku” kundër Tirana Parking

VENDIM NR. 120, DATË 29.04.2024

Shkaku: Aftësi e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces

Diskriminim i personave me aftësi të kufizuar, lidhur me garantimin e vendeve të parkimit.

FAKTET

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Pretendimet e palët ankuese konsistojnë në tre momente:

- numri i vendeve të parkimit të dedikuara për personat me aftësi të kufizuar në Tiranë është nën nivelin 5% të përcaktuar nga kuadri ligjor në fuqi;
- vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi;
- mosfunksionimi i ashensorëve në Sheshin “Skënderbej” dhe Sheshin “Italia”;
- mbjatatja e vendeve të parkimit të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që të mos zihen nga mjete të tjera.

Sipas palës ankuese, një situatë e tillë diskriminon personat me aftësi të kufizuara të cilët për shkak të numrit të vogël të vendeve të parkimit të rezervuara për ta, mungesës së standardeve të vendeve të parkimit dhe fakti që vendet e parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara nuk janë të lira, pasi zihen nga mjete të tjera, nuk mund të lëvizin lirisht dhe në baza të parabarta me të tjerët në territorin e administruar nga Tirana Parking.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;

- Ligji Nr.. 8378/1998 *“Kodi Rrugor i republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- Vendimi Nr. 48, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak Tiranë (VKB) *“Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”*;
- VKB Nr. 49, datë 11.11.2015 *“Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe të tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”*.

KONKLUZIONE

Referuar të bëra në VKM Nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, që duhet të përmbushin parkimet për personat me aftësi të kufizuara, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Të dhënat e administruara tregojnë se, jo të gjitha sheshparkimet për të cilat është dhënë informacion, plotësojnë kërkesën ligjore që të paktën 5% të vendeve të parkimit në raport me numrin total të vend parkimeve, të jenë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Të dhënat e administruara tregojnë se, lidhur me vendet e parkimit në rrugë, nuk plotësohet kërkesa ligjore që të paktën 5% të vendeve të parkimit në raport me numrin total të vend parkimeve, të jenë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me respektimin e standardeve për vendet e parkimit të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, Komisioneri konstaton se, kuadri ligjor i zbatueshëm dhe kriteret teknike dhe standardet që duhet të përmbushin vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara, përcaktohen në VKM Nr. 1503/2008. Në rastin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara, Tirana Parking duhet të kishte respektuar kriteret dhe përcaktimet e parashikuara nga VKM nr. 1503/2008 dhe jo kriteret dhe përcaktimet e përgjithshme që bëhen në lidhje me vendet e parkimit në VKM Nr. 153/2000. Komisioneri arrin në përfundimin se, vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara nuk janë në përputhje me standardet dhe kriteret teknike të përcaktuara nga legjislacioni i cili gjen zbatim në këtë rast dhe rrjedhimisht ato nuk janë të aksesueshme nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Sa i takon mbajtjes së lirë të vendeve të parkimit të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, Tirana Parking deklaroi se, nuk ka kompetencë për marrjen e masave administrative ndaj

drejtuesve që kryejnë kundravajtje rrugore, ku përfshihen edhe parkimet në kundërshtim me sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Masat administrative kryesore “gjobë” dhe masat plotësuese “heqja e mjeteve”, të parashikuara në nenet 156, 157 të Kodit Rrugor, vendosen vetëm nga shërbimet e policisë rrugore, respektivisht nga Policia Rrugore pjesë e Ministrisë së Brendshme dhe Policia Bashkiake. Në vijimësi ka kërkuar dhe vijon të kërkojë ndihmën e Policisë Bashkiake për marrjen e masave administrative për drejtuesit e mjeteve që parkojnë mjetet në vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me mosfunksionimin e ashensorëve të vendosur tek Sheshi “Skënderbej” dhe Sheshi “Italia” Tirana Parking parashit se, ashensorët ishin çaktivuar nga ana e tyre për arsye sigurie dhe se kishte hartuar dhe miratuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2024, ku është përcaktuar marrja e shërbimit të ekspertizës për ashensorët. Ekspertët e licensuar do të bëjnë qartësimin e gjendjes teknike të ashensorëve dhe hartimin e preventivave të shërbimeve që do të kryhen për marrjen e certifikimeve të sigurisë për të gjithë ashensorët.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM Nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët shfrytëzimin e hapësirave publike. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në hapësirat publike, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesimi për të marrë shërbimet e ofruara.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me garantimin e parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se, Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008. Masat e ndërmarra nga ana e Tirana Parking, për të rritur numrin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara janë të pamjaftueshme, pasi kërkesa në lidhje me numrin e vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara, jo më pak se 5% e numrit total të vendeve të parkimit, të jetë

përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, duhet të ishte respektuar që prej fillimit të ofrimit të shërbimit të parkimit publik nga ana e këtij institucioni.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me parkimet për personat me aftësi të kufizuara nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i bashkisë Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, në lidhje me garantimin e vendeve të parkimit të personave me aftësi të kufizuara në territorin e bashkisë.
- Tirana Parking, institucion varësie i Bashkisë Tiranë, të marrë masa për të siguruar që, brenda 6 (gjashtë) muajve:
 - ✓ vendet e parkimit për personat me aftësi të kufizuara të plotësojnë standardet teknike të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
 - ✓ të garantohet detyrimi i përcaktuar në Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, sipas të cilit 5% e vendeve të parkimit duhet të përshtaten për personat me aftësi të kufizuara”.

26. V.D.,²² dhe V.K.,²³ kundër Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë së Transportit “Llixha 2001” sh.p.k.

VENDIM NR. 129, DATË 13.05.2024

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik për personat me aftësi të kufizuara nga ana e Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë së Transportit “Llixha 2001” sh.p.k.

FAKTET

Ankuesit kanë udhëtuar nga qyteti i Elbasanit në Llixha. Pas nisjes së autobusit faktorino i ka kërkuar të bëj pagesën e plotë të biletës duke mos i njohur librezën e verbërisë. Pas debatit të zhvilluar mes tyre dhe faktorinos janë detyruar të bëjnë pagesën e biletës. Gjithashtu, ankuesit kanë udhëtuar me të njëjtin autobus nga Llixhat për në drejtim të Elbasanit dhe janë përballur me të njëjtën situatë sërish, duke mos iu njohur librezat e verbërisë së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit Nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;

²² Referuar Librezës së Verbërisë Nr. 13077, të lëshuar nga SHSSH, ankuesja është e verbër Grupi i II-të.

²³ Referuar Librezës së Verbërisë Nr. 23333, të lëshuar nga SHSSH, ankuesja është e verbër Grupi i II-të.

- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
- Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara përfitojnë lehtësira në udhëtim, subjektet ankues, nuk kanë përfituar nga transporti rrethqytetas në linjën e ofruar nga Shoqëria “Llixha 2001”, për arsye të cituara më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Bashkia Elbasan ka pasur të gjithë mundësinë për zgjidhjen e situatës konkrete, nisur nga fakti që transporti rrethqytetas është funksion i saj, ekskluziv, për t’ia garantuar të gjithë banorëve të saj²⁴, duke garantuar përkujdesje sociale të veçantë për personat me aftësi të kufizuara²⁵. Pikërisht në funksion të faktit, që transporti rrethqytetas është funksion ekskluziv i Bashkisë, Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, në nenin 10, shkronja “c”²⁶, të tij parashikon edhe vendosjen e tarifës së shërbimit urban nga vetë Bashkia. Gjithashtu, neni 85, i Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikon se fondet për kompensimin e transportit qytetas përballohen nga Bashkitë;
- Që kishte marrë masa apo kishte kryer veprime konkrete për të kryer monitorimin e shërbimit të operatorëve të transportit të udhëtarëve, me të cilët Bashkia ka marrëdhënie kontraktuale, për periudhën gjatë viteve 2019-2023.

²⁴ Në referencë të neneve 22 dhe 23, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

²⁵ Në referencë të nenit 24, të Ligjit Nr. 139/2015. “Për vetëqeverisjen vendore”.

²⁶ Neni 10, shkronja c), i Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) parashikon: “Tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.”.

- Shoqëria “Llixha 2001”, nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi, lidhur me lehtësimin e transportit rrethqytetas për personat me aftësi të kufizuar, të verbër.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Elbasan dhe Shoqëria “Llixha 2001” nuk kanë vepruar në bazë të kompetencave, që i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mosofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare. Komisioneri vëren se, Bashkia Elbasan dhe Shoqëria “Llixha 2001” kanë dështuar në marrjen e masave për heqjen e të gjitha pengesave institucionale, për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuar, të verbër.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Elbasan dhe Shoqëria “Llixha 2001”, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, kanë vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankueset, sa i takon ofrimit të transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacioni në fuqi.

Komisioneri konstatoi sjellje diskriminuese ndaj subjekteve ankues, si persona me aftësi të kufizuar, të verbër, pasi rezultoi se Bashkia Elbasan dhe Shoqëria “Llixha 2001” nuk kanë marrë masa për të siguruar të drejtat ligjore të tyre, lidhur me udhëtimin falas në transportin rrethqytetas.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetaseve: V.D., dhe V.K., nga ana e Bashkisë Elbasan.
- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetaseve: V.D., dhe V.K., nga ana e Shoqërisë “Llixha 2001” sh.p.k.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Bashkia Elbasan të marrë masa të menjëhershme, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie, duke hartuar një plan monitorimi për shoqëritë e transportit të licencuara nga ana e saj.
- Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, Shoqëria “Llixha 2001”, të marrë masa të menjëhershme, për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria “Llixha 2001” sh.p.k., duhet të marrë masat e mëposhtme:
 - ✓ Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimin për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - ✓ Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori.

**27. M.S., kundër H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ dhe Shoqërisë
“ELALBA-1” sh.p.k.**

VENDIM NR. 182, DATË 10.06.2024

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik për personat me aftësi të kufizuara nga ana e shtetasit H. M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ dhe Shoqërisë “ELALBA-1” sh.p.k.

FAKTET

Ankuesi ka udhëtuar në autobusin e linjës Durrës-Tiranë me targë AAxxxNJ për në Tiranë. Pas nisjes së autobusit fatorino i ka kërkuar të bëj pagesën e plotë të biletës duke mos i njohur librezën e verbërisë. Pas debatit të zhvilluar mes tij dhe fatorinos nuk është lejuar të udhëtojë pa paguar biletën e plotë, duke i kërkuar për zbritur edhe nga autobusi me urdhër të pronarit të tij. Sakaq, ankuesi është detyruar të paguaj biletën e plotë të udhëtimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi Nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

- Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara përfitojnë lehtësira në udhëtim, subjekti ankues, nuk ka përfituar nga transporti ndërrurban në linjën e ofruar nga H.M., pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ. Nga ana e H.M., nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situate konkrete dhe as në vijimësi.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ, i certifikuar për kryerjen e shërbimeve të rregullta për linjën Tiranë-Durrës-Tiranë nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi, lidhur me lehtësimin e transportit ndërrytetas për personat me aftësi të kufizuara, të verbër.
- H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ, ka pasur veprime abuzive të përsëritura në drejtim të personave të verbër duke mos pranuar udhëtimin me gjysëm çmimi.
- H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ, nuk ka informuar për veprime konkrete të ndërmarra për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se H.M., si ortak dhe pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ nuk ka vepruar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare. Komisioneri vëren se, H.M., ka dështuar në marrjen e masave për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit ndërrytetas për personat me aftësi të kufizuara, të verbër.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, ka vendosur përpara një situate diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesin, përse i takon ofrimit të transportit me gjysëm pagese të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe në detyrimet e licencës.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstatoi se, H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxxNJ, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuara, në zbatim të detyrimeve ligjore që asaj i burojnë drejtëpërdrejtë nga ligji dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla.

Komisioneri konstatoi se të gjitha veprimet dhe mosveprimet në shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi bazën e të cilave rregullohet transporti urban ndërqytetas, nga ana e H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ, kanë krijuar një mjedis frikësues dhe ofendues ndaj ankuesit për shkak të aftësisë së kufizuar.

Nëpërmjet vendimarrjeve të tij, Komisioneri ka konstatuar mos zbatimin e lehtësirave në transportin ndërqytetas të personave të verbër nga ana e Shoqërisë “ELALBA-1” dhe ka kërkuar nga ky subjekt marrjen e masave për të garantuar lehtësitë në transport për personat e verbër, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Shoqëria “ELALBA-1” me anë të komunikimit shkresor ka informuar se vendim-marrja Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është bërë e ditur të gjithë punonjësve të Shoqërisë dhe se i është bërë e qartë të gjithë drejtuesve të mjeteve që të zbatojnë me përgjegjësi kërkesat e ligjit, lidhur me përfitimin e transportit falas dhe 50% për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër, por rastet e moszbatimit të lehtësirave për personat e verbër janë përsëritur vetëm me drejtuesin e mjetit H.M., që është dhe aksioner i Shoqërisë.

Komisioneri evidentoi se, H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ nuk ka marrë asnjë masë në drejtim të ndalimit dhe mospërsëritjes në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

Në përfundim, Komisioneri konstatoi sjellje diskriminuese ndaj subjektit ankues, M.S., pasi rezultoi se H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ, nuk ka marrë masa për të siguruar të drejtat ligjore të tij, lidhur me udhëtimin me gjysëm pagese në transportin ndërqytetas.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit M.S., për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, H.M., si pronar i mjetit me targa AAxxxNJ, të marrë masa të menjëhershme për:
 - ✓ Afishimin në vende të dukshme të mjetit me targa AAxxxNJ, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara në Çertifikatën Nr. 4, datë 12.05.2023.
 - ✓ Mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe të sigurojë dhe garantojë lehtësitë në transport ndaj personave të verbër.

28. Fondacioni “Së Bashku” kundër Njesisë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin

VENDIM NR. 198, DATË 10.07.2024

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë në trotuaret në rrugën kryesore, përballë Njesisë Administrative dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët.

FAKTET

Fondacioni “Së bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë, diskriminon personat me aftësi të kufizuar në Njësinë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

Në rrugët dhe trotuaret e territorit të Njesisë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, mungon përshtatshmëria e rrugëve dhe trotuareve në segmentin rrugor përballë Njesisë Administrative Mamurras dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras dhe personat me aftësi të kufizuara nuk mund të marrin në mënyrë të lirë dhe të pavarur shërbimet e tyre në territorin e administruar nga Bashkia Kurbin.

Nga informacioni i administruar rezulton se, segmenti rrugor përballë Njesisë Administrative Mamurras dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras, nga pamjet fotografike të rrugës të sipërcituar, të vëna në dispozicion nga pala ankuese, rezulton që është e paaksesueshme, duke e bërë të pamundur aksesueshmërinë e saj në mënyrë të pavarur nga personat me aftësi të kufizuara.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018), mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

KONKLUZIONE

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se, Bashkia Kurbin, kryesisht në trotuaret në rrugën kryesore përballë Njesisë Administrative dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, Bashkia Kurbin, parashtroi se në vitet në vijim do të marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin, projektimin dhe zbatueshmërinë lidhur me përshtatshmërinë e rrugëve me qëllim funksionimin e tyre nga të gjitha grup-moshat me karakteristika të veçanta. Bashkia Kurbin nuk paraqiti asnjë informacion dhe dokumentacion përpara Komisionerit lidhur me planifikimin e fondeve për përshtatjen/aksesueshmërinë e rrugëve/trotuareve kryesore për personat PAK dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Bashkia Kurbin nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë dhe shërbimet që ofrohen në aksin rrugor që është objekt i ankesës në shqyrtim, si një aks qarkullimi kryesor në Njësinë Administrative Mamurras, Bashkisë

Kurbin, Komisioneri vlerësoi se, rruga kryesore përballë Njesisë Administrative dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras është një aks me frekuencë të lartë të frekuentimit në jetën e përditshme nga qytetarët, ndryshe nga rrugë të tjera dytësore që në varësi të pozicionit dhe shërbimeve që ofrohen, mund të mos lindi nevoja që të frekuentohen në mënyrë të përditshme. Rezulton se në rrugën kryesore janë të vendosura dhe ofrojnë shërbime të përditshme shumë institucione publike dhe private që ofrojnë shërbime të nevojshme për banorët e kësaj Njësie Administrative. Për të funksionuar në mënyrë efektive dhe të sigurt në punë, arsim dhe jetën e përditshme, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses fizik në të njëjtat hapësira, punësim, mallra, shërbime dhe pjesëmarrje në komunitet, si të gjithë qytetarët e tjerë.

Komisioneri konstatoi se, Bashkia Kurbin, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike²⁷ që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në trotualet në rrugën kryesore përballë Njesisë Administrative dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, nga Bashkia Kurbin, përbën diskriminim sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kurbin, në lidhje me mosgarantimin e aksesueshmërisë në trotualet, në rrugën kryesore përballë Njesisë Administrative dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Kurbin, të marrë masa të menjëhershme për:
 - a. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në trotualet në rrugën kryesore përballë Njesisë Administrative dhe Qendrës Shëndetësore Mamurras, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
 - b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj

²⁷ VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

VII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS DHE ETNISË

29. D.B., kundër DVASHK Shkodër

VENDIM NR. 48, DATË 14.02.2024

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim strukturor
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Mos shqyrtimi i kërkesës së ankueses për legalizim të banesës, nga ana e DV ASHK Shkodër, e ka vënë atë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të racës së saj.

FAKTET

Subjekti ankues është pjesë e komunitetit egjiptian dhe në vitin 2008 i është djegur shtëpia, e cila për shkak të pamundësisë për ta rregulluar, ka mbetur në atë gjendje deri në vitin 2017, kur në sajë të disa donacioneve të ndryshme nga shoqata dhe qytetarë, është ndihmuar lidhur me rindërtimin e saj.

Pas rikonstruksionit të banesës ka aplikuar për legalizimin e rindërtimit dhe është interesuar vazhdimisht tek Kadastra²⁸, e cila, në përgjigjen e fundit që i ka kthyer ankueses, e informon atë se nuk rezulton që ajo të ketë aplikuar.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të saj nga ana e DVASHK Shkodër, për shkak të racës, si dhe dhe të merren masa për legalizimin e banesës së saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolli 12 i saj;
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 97/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar;
- VKM Nr. 1178/2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”;

²⁸ Citim i ankueses referuar DV ASHK Shkodër.

- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (PKVBPPR) në Republikën e Shqipërisë (2021-2025).

KONKLUSIONE

Nisur nga analiza e fakteve, rrethanave dhe provave të depozituara, Komisioneri vlerësoi se, veprimet e DV ASHK Shkodër kundrejt ankueses, janë haptazi në kundërshtim dhe keqzbatim të dispozitave ligjore përkatëse, lidhur me kërkesën e paraqitur nga subjekti ankues për legalizim të banesës së saj (ndërtim pa leje).

Pavarësisht faktit se, objekti ndërtimor/banese e subjektit ankues-objekt gjykimi pranë KMD-së, sipas imazheve satelitore dhe ajrore të produkteve të ortoimazherisë “Ortofoto 2015” ASIG, rezulton objekt pa mbulesë dhe funksion, në 2015-ën, dhe në kushtet kur banesa është ndërtuar në 2017-ën, ndërtim pa leje, rasti i ankueses duhet të trajtohej nga ASHK-ja (Drejtoria Vendore Shkodër në këtë rast) sipas rregullave të seksionit të I, Kreut III, të Ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 1/b, pikës 15, të VKM Nr. 1178/2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”, në zbatim të kriterëve përkatëse të përcaktuara në to, si dhe në përputhje me frymën e tyre.

Komisioneri vlerësoi se, DV ASHK Shkodër ka gabuar në interpretimin e klasifikimin që i bën aplikimit, kërkesës së ankueses, duke mos ia pranuar si të vlefshme kërkesën e paraqitur në vitin 2017, dhe duke pretenduar se duhet bërë një kërkesë e re, për të cilën duhet aplikuar në sistemin online të e-Albania, kundrejt faturës prej 3 000 (tre mijë) lekësh.

Komisioneri vlerësoi se, aplikimi i bërë apo kërkesa e ankueses e depozituar në vitin 2017, është e vlefshme dhe duhet konsideruar *e kryer*, de facto dhe de jure, dhe se duhet të vijohet me hapat e tjerë proceduralë nga ana e DV ASHK Shkodër, në varësi të kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore respektive, si dhe në transparencë e nëpërmjet një komunikimi të qartë e të kuptueshëm për subjektin ankues.

Komisioneri gjykoi se, DV ASHK Shkodër duke e klasifikuar në mënyrë të gabuar ankuesen tek subjektet të cilat duhet të kryejnë aplikimin për legalizim banese, objekt pa leje, në platformën online e-Albania, konform pagesës së faturës së aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh, është bërë pengesë për vijimin e mëtejshëm të hapave proceduralë për të vijuar me plotësimin e kërkesave të tjera për legalizimin e banesës së saj, duke konsideruar ai të pavlefshëm aplikimin e paraqitur prej saj në datë 20.11.2017.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, DV ASHK Shkodër, duhet të kishte ndërmarrë hapa konkretë e masat e duhura, duke vepruar edhe kryesisht, për shqyrtimin e kërkesës së ankueses për legalizim banese, objekt pa leje, dhe konsiderimin e vlefshëm të tij, për të vijuar më tej me hapat e tjerë proceduralë. Subjekti ankues nuk ka pse të ngarkohet me barrën e riaplikimit në sistemin

online e-Albania, e për më tepër kundrejt faturës në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh, kur ajo nuk ka një detyrim të tillë ligjor.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerësoi se, nga ana e DV ASHK Shkodër nuk janë bërë përpjekjet e veprimet e duhura, për të përmbushur kërkesën e ankueses, nga ana e tyre, por edhe detyrën funksionale për të cilën ky organ është krijuar dhe funksionon në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, DV ASHK Shkodër, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, subjektin ankues, përse i takon mos shqyrtimit të kërkesës së saj për legalizim objekti informal.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e *diskriminimit strukturor*, të subjektit ankues, D.B., për shkak të racës, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e DV ASHK Shkodër, lidhur me mos shqyrtimin e kërkesës së saj për legalizim të banesës.
- Referuar pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa nga DV ASHK Shkodër, për shqyrtimin e kërkesës, aplikimit me Nr. 1190 Prot., datë 20.11.2017, të subjektit ankues D.B., për legalizim banese.

30. R.H., kundër Emisionit “Xhadat”, (MCN TV)

VENDIM NR. 49, DATË 20.02.2024

Shkaku: Etnia
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në Emisionin *Xhadat*, Në televizionin MCN TV.

FAKTET

Në datën 11 Tetor, ora 16:22, në rrjetin social me titull “Xhadat”, është transmetuar pjesë nga emisioni “Xhadat”, MCN TV. Në këtë emision një nga folëset (gazetaret), ndër të tjera kanë thënë “... e ka bërë me beton, se po ta bënte hekur vinin kurbetërit dhe ja shisnin”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave);
- Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132);
- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 22, Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993.

KONKLUZIONE

Nga verifikimi i videos së publikuar *online* në rrjetin social *Facebook*, në momentin e paraqitjes së ankesës dhe videos të vendosur në dispozicion nga pala ankuuese, rezultoi se, në datën 11 Tetor, (emisioni i plotë është publikuar nga MCN Televizion në datën 10.10.2023 ndërsa në Facebook

është publikuar në datën 11 Tetor, fragment nga emisioni me titullin: *Ce s'e bëri pe ekuri Rrama kullkën në mes të Korçës po e bëri pe betoni?*) ora 16:22, në rrjetin social Facebook, në profilin me emërtimin “Xhadat”, është postuar pjesë nga emisioni “Xhadat”, i cili transmetohet në MCN TV. Në këtë emision, një nga folëset gazetare, ndër të tjera është shprehur se: “... e ka bërë me beton, se po ta bënte hekur vinin kurbetërit dhe ja shishnin”.

Ndërkohë, pas verifikimeve të mëtejshme, rezultoi se, emisioni është trasmetuar në datën 10.10.2023 dhe përmbajtja e plotë e emisionit aksesohet online në rrjetin YouTube në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=36U5970LhB4>. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së emisionit, konstatohet se, njëra nga drejtueset e emisionit ka përdorur shprehjen “kurbetërit”, në kuptimin që, nëse kulla e ndërtuar në qytetin e Korçës, nuk do ishte prej betoni, por si kulla e ndërtuar në Paris prej hekuri, do të vinin “kurbetërit” dhe do ta shisni.

Pavarësisht kërkesave të Komisionerit drejtuar MCN Tv, ku iu kërkua në mënyrë të përsëritur për vënien në dispozicion të materialit në formë CD si dhe për të dhënë shpjegimet lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, nga ana e këtij subjekti nuk u vu në dispozicion asnjë informacion apo argument, lidhur me shprehjen e përdorur në emisionin e tij “Xhadat”, në adresë të komunitetit rom, transmetuar në datën 10.10.2023 në MCN TV dhe në vijim publikuar online në rrjetin social Facebook, në profilin e emisionit “Xhadat”, si dhe në YouTube, ku është publikuar i plotë ky emision.

Në këto kushte, për shqyrtimin e çështjes, Komisioneri u mbështet pikërisht në publikimin online të bërë nga ky televizion në rrjetin Facebook në faqen e emisionit “Xhadat” të publikuar në datën 11.10.2023, kostatuar në momentin e paraqitjes së ankesës, videos e cila u vu në dispozicion nga ankuesi, si dhe linkun e emisionit të sipërcituar, publikuar i plotë në YouTube. Komisioneri administroi materialet video të publikuara online nga subjekti MCN TV, duke e konsideruar materialin e transmetuar, si fakte që janë të njohura publikisht.

Referuar Fjalori Shqip termi “kurbetërit” ka kuptimin e fjalës “arixhinjtë”.

Për sa më sipër, termi *arixhi* është një nga mënyrat se si komuniteti rom identifikohet në zona të ndryshme të Shqipërisë. Përdorimi i këtij termi duke e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, me fenomene negative, bën që termi të marrë një konotacion negativ, duke nxitur ose përforcuar stereotipe negative kundrejt këtij komuniteti.

Referuar rastit në fjalë, drejtuesja e emisionit i referohet këtij komuniteti, duke i vendosur anëtarët e komunitetit rom në pozita inferiore dhe denigruese. Në këtë kuptim, nëpërmjet përdorimit të zhargonit të vjetër popullor, prezantuesja e emisionit, përforcon stereotipet e krijuara ndaj pakicës kombëtare rome dhe i vendos ata në pozita të pafavorshme e përçmuese në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

Rezulton se pjesa më e madhe e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme janë kryesisht anëtarë të komunitetit rom në Shqipëri.

Sa më sipër, drejtuesja e emisionit, referuar kësaj pakice i ka dhënë shprehjes së përdorur “*e ka bërë me beton, se po ta bënte hekur vinin kurbetërit dhe ja shisnin*”, kontekst dhe konotacion negativ, duke promovuar dhe nxitur një formë stigmatizimi duke nënkuptuar dhe etiketuar personat që i përkasin pakicës kombëtare rome në një mënyrë negative dhe duke nxitur në këtë mënyrë një stereotipizim negativ ndaj pjesëtarëve që i përkasin pakicës kombëtare rome.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerësoi se, pavarësisht faktit nëse shprehja e përdorur nga ana e drejtueses, në emisionin *Xhadat*, mund të mos ketë patur qëllim të drejtëpërdrejtë nxitjen e urrejtjes apo diskriminimit të komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes, të gjithë anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Për sa më sipër, Komisioneri thekson faktin se Televizioni MCN ka përforcuar dhe vijimësuar diskriminimin, për shkak të etnisë, në formën e gjuhës së urrejtjes të pakicës kombëtare rome, duke mosmbajtur një qëndrim kritik ndaj përdorimit të shprehjes së drejtueses, as gjatë emisionit dhe as në vijim të tij, për t’u distancuar nga sa më sipër. Përpos kësaj, ky televizion ka përforcuar diskriminimin ndaj këtij komuniteti, duke publikuar në faqen Facebook, emisionin *Xhadat* vetëm këtë fragment. Pozita e këtij subjekti rëndohet gjithashtu, pasi ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionerin, duke mos dhënë prapësimet e tij lidhur me sa më sipër.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të etnisë, në formën e “*gjuhës së urrejtjes*”, të pakicës kombëtare rome, nga ana e MCN TV, si pasojë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në Emisionin *Xhadat*, të datës 10.10.2023.
- Referuar pikës 1, MCN TV të shprehet me deklaratë publike (verbale apo të shkruar) në emisionin “*Xhadat*”, me anë të së cilës të kërkojë ndjesë publike ndaj pakicës kombëtare rome.
- Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, MCN TV të marrë masa të menjëherëshme për të hequr nga rrjetet sociale emisionin “*Xhadat*” të datës 10.10.2023 ose të eliminojë/mbulojë frazën diskriminuese të përdorur nga drejtuesja e emisionit, të publikuar në faqen www.youtube.com, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijeni mbi këtë vendim, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome.

31. F.Ll., kundër Bashkisë Kavajë

VENDIM NR. 112, DATË 24.04.2024

Shkaku: Raca/Etnia
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime/Strehim
Statusi: Zbatuar pjesërisht

Ankuesi F.Ll., është diskriminuar në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të “racës/etnisë” nga ana Bashkisë Kavajë.

FAKTET

Ankuesi F.Ll., është i datëlindjes 13.06.1969 dhe jeton në qytetin e Kavajës së bashku me familjen e tij, e cila përbëhet nga bashkëshortja dhe 5 (pesë) fëmijët, tri prej të cilëve në moshë të mitur. Ai deklaron se bashkëshortja dhe njëri prej fëmijëve të tij janë me aftësi të kufizuara. Ankuesi deklaron se djali i tij ka probleme të shëndetit mendor dhe i ka vënë flakën shtëpisë disa herë.

Ankuesi parashtroi se jeton prej 25 vitesh në një banesë në gjendje shumë të keqe banimi dhe të pabanueshme. Ai deklaron se i është drejtuar disa herë për ndihmë bashkisë por nuk ka marrë ndihmë prej saj, ndërsa aktualisht bashkia i ka komunikuar se do t’i zhvendosin në një vend tjetër, por sipas ankuesit vendi ku do t’i transferojnë ka kushte shumë më të këqia se vendbanimi i tij aktual. Ankuesi pretendon se bashkia ka gjendje pallate ku mund t’i sistemojë por nuk e bën pasi ata janë egjiptianë dhe nuk meritojnë të jetojnë në pallat.

Bashkia Kavajë parashtroi se ankuesi prej vitesh jeton në një godinë të bashkisë. Bashkia Kavajë pranon se, banesa ku jeton ankuesi është e amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje, por bashkia nuk mund të ndërhyjë aktualisht, sepse familja e ankuesit do t’ë transferohet në një ambient tjetër me kushte më të mira, në një afat sa më të shkurtër. Bashkia Kavajë nuk i kundërshtoi faktet e parashtuara nga ankuesi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Direktiva e Bashkimit Europian 2000/43/Këshillit Evropian, e 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

- Komenti i Përgjithshëm nr.4 *për të drejtën për një strehim të përshtatshëm*, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Rekomandimi (2005)4 “*Për Përmirësimin e Kushteve të Strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Evropë*”, miratuar me 23 shkurt 2005, nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës;
- Rekomandimi i ECRI-t Nr. 13 *Për Luftën Kundër Anti-Ciganizmit dhe Diskriminimin Kundër Romëve*, miratuar me datë 24 qershor 2011;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 22/2018 “*Për strehimin social*”;
- Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025).

KONKLUZIONE

Bashkia Kavajë, edhe pse pranon që banesa është në gjendje të amortizuar, nuk jep asnjë informacion, *së pari*, në lidhje me masat e marra nga ana e saj për të siguruar një zgjidhje emergjente të situatës së strehimit të ankuesit dhe familjes së tij, *së dyti*, në lidhje me masat afatmesme dhe/ose afatgjata të ndërmara për sigurimin e një strehimi afatgjatë dhe të qëndrueshëm për ankuesin dhe familjen e tij dhe afatet përkatëse kohore, dhe *së treti*, në lidhje me veprimet dhe përpjekjet e ndërmara nga Bashkia Kavajë ndër vite për të siguruar një strehim të përshtatshëm për ankuesin dhe familjen e tij, të gjitha këto duke mbajtur në konsideratë se ankuesi i përket një kategori vulnerabel të shoqërisë, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane.

Justifikimi i vetëm që jep Bashkia Kavajë është se bashkia nuk mund të ndërhyjë aktualisht sepse familja e ankuesit do të transferohet në një ambient tjetër, sipas saj me kushte më të mira, në një afat sa më të shkurtër. Bashkia Kavajë nuk jep asnjë informacion se në cilat ambiente do të transferohet ankuesi dhe familja e tij dhe kur. Duke deklaruar se transferimi do të bëhet brenda një afati të shkurtër nuk është i mjaftueshëm, ndërsa ankuesi dhe familja e tij vazhdojnë në kushte të mjerueshme dhe aspak dinjitoze, por edhe të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e tyre pasi banesa pas zjarrit pothuajse është e shkatërruar pa dyer e dritare.

Ankuesi jeton në një ambient tek ish Fabrikës së Qelqit, që prej rreth 25 vitesh fakt ky që u pretendua nga ankuesi dhe nuk u kundërshtua nga ana e Bashkia Kavajë. Ambjenti në të cilin ankuesi jeton prej një periudhe të gjatë, konfirmohet edhe nga Bashkia Kavajë se është një godinë e bashkisë, pra ankuesi është strehuar nga ana e Bashkisë në këtë banesë. Rrjedhimisht, Bashkia Kavajë ka qenë në dijeni të plotës të situatës së strehimit të ankuesit.

Gjatë gjithë periudhës që ankuesi është strehuar nga Bashkia Kavajë në godinën e ish Fabrikës së Qelqit, strehim i cili nuk ka qenë një zgjidhje përfundimtare e situatës së ankuesit, Bashkia Kavajë nuk informoi të ketë ndërmarrë asnjë masë për të përfshirë ankuesin në ndonjë nga programet e

strehimit social në mënyrë për të siguruar një zgjidhje përfundimtare dhe të qëndrueshme të problematikës.

Gjithashtu, Bashkia Kavajë, pranon se banesa është e amortizuar, edhe pse nga pamjet e administruara konstatohet se gjendja e banesës është në kushte të mjerueshme dhe plotësisht të pabanueshme, nuk informoi Komisionerin në lidhje me masat konkrete të ndërmarra për të siguruar një tjetër strehim në kushtet e emergjencës në të cilat ndodhet banesa e ankuesit. Ndërsa ankuesi dhe familja e tij jetojnë në kushte të papërshtatshme dhe aspak dinjitoze, justifikimi i Bashkisë Kavajë konsiston vetëm në faktin se ajo nuk mund të ndërhyrë në përmirësimin e banesës aktuale të amortizuar pasi ankuesi dhe familja e tij do të transferohen në një ambient tjetër me kushte më të mira, por pa dhënë informacion në lidhje me vendodhjen e ambientit, i cili nga ana tjetër kundërshtohet nga ankuesi si një propozim i papërshtatshëm nga ana e bashkisë, dhe në një afat të shkurtër nga njëra anë, por të papërcaktuar nga ana tjetër.

Rezulton se përgjatë 5 viteve të fundit Bashkia Kavajë ka sistemuar me strehim vetëm 3 familje egjiptiane, nëpërmjet programit të banesave me kosto të ulët.

Të dhënat e administruara tregojnë se, egjiptianët dhe romët, ende jetojnë në një masë të madhe në kushte të këqija strehimi, në raport me pjesën tjetër të popullsisë dhe se zgjidhjet e strehimit kanë qenë të pamjaftueshme. Ky ndryshim në situatën e tyre gjeneron një detyrim pozitiv për të marrë parasysh një ndryshim të tillë dhe në përputhje me rrethanat për t'iu përgjigjur me masat e duhura. Prandaj, duke pasur parasysh kushtet e këqija dhe të vazhdueshme të strehimit për anëtarët e pakicës kombëtare egjiptiane, së bashku me faktin se Bashkia Kavajë nuk arriti të provojë se ka marrë masa të mjaftueshme për të siguruar që egjiptianët të jetojnë në kushte banimi që plotësojnë standardet minimale, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Kavajë, me anë të mosveprimeve të saj, e ka diskriminuar ankuesin, për shkak të races/etnisë.

Bashkia Kavajë ka patur detyrime pozitive për të bërë dallimet e nevojshme në lidhje me ankuesin që i përket pakicës kombëtare egjiptiane, për shkak të kushteve dhe rrethanave të ndryshme në të cilat ndodhet kjo kategori e shoqërisë. Pabarazinë faktike në strehimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare egjiptiane dhe fakti që kjo kategori është më tepër e ekspozuar ndaj kushteve të papërshtatshme të banimit dhe përmbushjes së standardeve më minimale të jetesës, e ngarkojnë Bashkinë Kavajë me detyrimin për të bërë dallimet e nevojshme në trajtimin e kësaj kategorie në lidhje me sigurimin e një strehimi të përshtatshëm. Bazuar në provat e administruara, rezultoi e provuar se Bashkia Kavajë ka dështuar në përpjekjet e saj për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm të ankuesit. Komisioneri evidenton faktin se, Bashkia Kavajë ka reflektuar mosveprim, neglizhencë dhe pasivitet në marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm të ankuesit dhe familjes së tij.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit F.Ll., në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të “racës/etnisë” nga ana Bashkisë Kavajë.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Kavajë duhet të marrë masa për:
 - ✓ sigurimin në mënyrë emergjente të një strehimi të përshtatshëm, për ankuesin dhe familjen e tij;
 - ✓ sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, për ankuesin dhe familjen e tij.

VIII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES FAMILJARE

32. M.Z., në cilësinë e përfaqësueses ligjore të nipërve të saj E., dhe E.Z., kundër
Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 59, DATË 06.03.2024

Shkaku: Gjendja familjare
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Fëmijët e mitur, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë, janë diskriminuar nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë e Arsimit dhe Sportit, për shkak të për shkak të *gjendjes familjare* si fëmijë nën kujdestari, duke i mohuar mundësinë për të përfituar bursë, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues.

FAKTET

M.Z., në bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është caktuar, kujdestare e fëmijëve të mitur (nipi dhe mbesa e saj), E., dhe E.Z. Referuar certifikatës së gjendjes familjare të datës 27.07.2021, fëmijët e mitur E., dhe E.Z., figurojnë të regjistruar si pjestarë të familjës, e cila përbëhet prej 4 personash. (Gjyshi, gjyshja, nipi dhe mbesa).

Në bazë të certifikatës së vdekjes datë 21.10.2019, rezultoi që nëna e dy fëmijëve të mitur M.V., ka ndërruar jetë në datën 09.10.2018. Me Vërtetimin e Njesisë Administrative Nr. 6, rezulton e provuar se M.Z., është banore i kësaj njësie dhe nuk trajtohet me ndihmë ekonomike apo pagesë paaftësie.

Në datën 31.05.2023, M.Z., ka plotësuar një Formular Aplikimi Nr. M-11862 prot., për marrjen e informacionit në lidhje me heqjen e bursave të nipërve të saj E., dhe E.Z., për vitin shkollor 2022-2023. Formulari është i shoqëruar me dy Dëftesat për klasat respektive të nipërve të saj ekselent, për përfitimin e bursave të shtetit për nxënësit.

Fëmijët e mitur, nuk janë kualifikuar përfitues të bursës për vitin shkollor 2022-2023, nga ana e Bashkisë Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;

- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës;
- GJEDNJ Çështjet Molla kundër Greqisë, Fábíán kundër Hungarisë, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, Çështja Thlimmenos kundër Greqisë, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012, *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 121/2016, *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996, *“Për statusin e jetimit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996, *“Për statusin e të verbrit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000, *“Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 57/2019, *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10289, datë 17.06.2010, *“Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit”*;
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, *“Për statusin e invalidëve të punës”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 18/2017 *“Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”*;
- Vkm Nr. 666, datë 10.10.2019, i Këshillit të Ministrave *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*;
- VKM Nr. 866, datë 24.12.2019, ka miratuar *Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020-2023*;
- VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015, ka miratuar *Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020*;
- Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*.

KONKLUZIONE

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm në bazë të të cilit fëmijët rezultojnë përfitues dhe faktit që:

- Fëmijët plotësonin më shumë se një kriter të VKM-së Nr. 666/2019;
- Fëmijët për vitin 2021-2022 e kanë përfituar bursën sipas kriterit 2.3/b të VKM-së dhe rezultojnë që vijnë në mbartim kriterin në bazë të të cilit kanë rezultuar përfitues.
- Fëmijët për vitin 2022-2023, kanë aplikuar brenda afateve ligjore, me të njëjtin shkak,

Fëmijët nën kujdestari të subjektit ankues, nuk kanë përfituar bursën sipas kriterit 2.3/b të VKM-së. Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Komisioneri gjeti një diferencim në trajtim të nxënësve E.Z., dhe E.Z., edhe me nxënësit përfitues, emrat e të cilëve ndodheshin në të njëjtën listë të dërguar nga shkolla, duke hedhur poshtë pretendimin e Bashkisë se përzgjedhja e fituesve varet nga koha kur shkolla e dërgon listën.
- Nga ana e Bashkisë Tiranë, në cilësinë e pushtetit vendor, nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e problematikës për nxënësit që plotësonin kriteret për vitin shkollor 2022-2023, por që nuk rezultuan përfitues për arsye të mungesës së kuotave të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Bashkia Tiranë për vitin shkollor 2023-2024 u shpreh se edhe këtë vit numri i aplikantëve që plotësonin kriteret ishte më i lartë se numri i kuotave të vëna në dispozicion nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por që ajo do ti plotësojë nga buxheti i saj. Bashkia Tiranë nuk ofroi asnjë shpjegim objektiv dhe të arsyeshëm se pse një veprim të tillë nuk e ndërmori dhe për vitin paraardhës (2022-2023).
- Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri gjatë shqyrtimit të ankesës Nr. 134, datë 29.06.2023, e Qendrës për Advokim Social në cilësinë e përfaqësueses së një grupi nxënësish, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë me pretendimin për diskriminim, për shkak të *racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë*, përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë, A.L., ndër të tjera parashtroi: “VKM²⁹ ka një dhe një specifikë. Ai që ka përfituar një vit përpara është vazhdues i përfitimit sepse nuk i ndryshon gjendja. Psh, fëmijët që jetojnë me një prind gjallë nuk i ndryshon statusi dhe ata janë automatikisht fitues dhe ti e ke të pamundur si organ zbatues që të bësh një lloj përzgjedhje në këtë rast sepse ti e ke numrin statik tashmë ...”³⁰.
- Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim në rastin objekt shqyrtimi pasi fëmijët për vitin 2021-2022 e kanë përfituar bursën sipas kriterit 2.3/b të VKM-së dhe rezulton që vijnë të mbartin kriterin në bazë të të cilit kanë rezultuar përfitues, gjithashtu janë njëkohësisht edhe fëmijë me një prind duke i përjashtuar ata nga e drejta e përfitimit të bursës.
- Pretendimi i Bashkisë se fëmijet janë përjashtuar nga e drejta e bursës për shkak se numri i kuotave të dërguara nga Ministria është më i ulët se numri i përfituesve nuk qëndron në këtë rast pasi fëmijet janë në të njëjtën gjendje si një vit më parë dhe duhet të vijonin të ishin përfitues. Bashkia nuk solli pranë Komisionerit fakte dhe prova që të justifikojë veprimet e saj.
- Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin mësimor 2022-2023 por edhe pasi është ngritur ky shqetësim nga ana e Bashkisë Tiranë dhe për vitin 2023-2024, nxënësit E.G.Z., dhe E.G.Z.,

²⁹ VKM-së Nr. 666/2019, në vitin 2022, i ndryshuar

³⁰ Referuar audio seancës dëgjimore datë 05.10.2023, ankesës Nr. 134, datë 29.06.2023

janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga MAS, duke iu mohuar e drejta për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3.

Komisioneri vlerësoi se, qëllimi i VKM-së Nr. 666/2019, në vitin 2022, i ndryshuar, është ndër të tjera të mbështesë financiarisht, kategori përfituese të veçantë, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë të ardhura nën pagën minimale, përfshirë edhe fëmijët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim të formës së prerë, nxënës me një prind, në mënyrë që këtyre fëmijëve tu garantohet e drejta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve plotësojnë kriteret respektive të parashikuara në VKM duhet të kishte parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i plotësonin kushtet për përfitimin e saj.

Pra, Komisioneri arriti në përfundimin se, mospërfitimi i bursës për vitin shkollor 2022-2023 të fëmijëve E., dhe E.Z., si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i ka ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3/b *"Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate"* të Vendimit Nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave *"Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar"*, për shkakun e diskriminimit të pretenduar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të nxënësve E.Z., dhe E.Z., nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për shkak të *gjendjes familjare* si fëmijë nën kujdestari.
- Bashkia Tiranë, të marrë masa, për dhënien e tarifës së bursës për vitin 2022-2023 sipas kriterit të parashikuar në VKM-në Nr. 666, datë 10.10.2019 *"Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike"*, të ndryshuar.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit të marri masa konkrete për sigurimin e numrit të kuotave të nevojshme gjatë hartimit të planit të tyre, për çdo bashki.
- Për të shmangur situatën e krijuar në rasin konkret, rekomandohet Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit kuotave në propocion me nevojat e bashkisë.

IX. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË

33. Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë kundër Gardës së Republikës

VENDIM NR. 188, DATË 27.06.2024

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë (përkatësia në sindikatën e Gardës)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjektet ankues janë punonjës të Gardës së Republikës dhe së bashku kanë formuar Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë. Pas këtij momenti, për shkak të organizimit sindikal, ndaj drejtuesve të sindikatës janë marrë masa disiplinore për largimin nga puna, ndërsa ndaj anëtarëve të tjerë masa disiplinore “Vërejtje”.

FAKTET

Subjektet ankues janë punonjës të Gardës së Republikës. Me vullnetin e tyre të lirë ata janë organizuar në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë. Në vijim, me kërkesë të B.N., në cilësinë e Kryetarit të Sindikatës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vendosi regjistrimin e organizatës sindikale me emërimin Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë (GRSH) me objekt veprimtarie përfaqësimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të të gjithë anëtarëve të sindikatës të cilët janë punëmarrësit e Gardës së Republikës.

Kryetari i Sindikatës, B.N., ka vënë në dijeni përmes njoftimit zyrtar Gardën e Republikës, për regjistrimin si person juridik të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe anëtarësisë së saj, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përmbushje të qëllimeve dhe veprimit sindikal, në televizionin MCN TV, rezultoi se përfaqësues të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Kryetari, B.N., Kryetarja e Rrjetit të Gruas, M.H., dhe Zëvendëskryetari, A.L.L., kanë dhënë intervistë³¹ duke ngritur shqetësimet e punonjësve të Gardës së Republikës, sa i përket kushteve të punës dhe pagesës së orëve shtesë. Intervista e dhënë prej tyre është transmetuar në edicionin e lajmeve.

Pas këtij momenti, nga ana e Sektorit të Informimit të Brendshëm dhe Standardeve Profesionale, të Gardës së Republikës, janë njoftuar përfaqësuesit e Sindikatës të cilët kishin dhënë intervistat sipërcituar se dalja publike e pa autorizuar dhe dhënia e intervistës në një kanal televiziv përbën

³¹ <https://www.youtube.com/watch?v=DpOqCi-Efnc>

shkelje të disiplinës, pasi kanë cenuar rëndë imazhin dhe integritetin e institucionit në opinionin publik, si dhe veprimet e tyre bien ndesh me Rregulloren e Gardës. Gjithashtu, Garda e Republikës ka nisur ecurinë dhe ka marrë masa disiplinore ndaj të gjithë anëtarëve të tjerë të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe Protokolli 12 i saj;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Konventa Nr. C087: *“Për lirinë e asocimit dhe mbrojtjen e së drejtës së organizimit”*;
- Konventa Nr. C098: *“Zbatimi i parimeve të së drejtës së organizimit dhe marrëveshjeve kolektive”*;
- Konventa Nr. C135: *“Për mbrojtjen dhe krijimin e lehtësirave për përfaqësuesit e punëtorëve”*;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Jurisprudenca e GJEDNJ.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 33/2021 *“Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”*;
- VKM me Nr. 777, datë 15.12.2023 *“Për miratimin e Rregullores së Gardës”*.

KONKLUZIONE

Nga provat e administruara, Komisioneri konstatoi se sapo është vënë në dijeni të regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe ngritjes së strukturave të saj, Garda e Republikës, në cilësinë e punëdhënësit ka nisur menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore ndaj anëtarëve të saj. Njëkohësisht, në rolin përfaqësuesve të saj, përkatësisht Kryetari, B.N.; Kryetarja e Rrjetit të Gruas, M.H., dhe Zëvendëskryetari, A.Ll., kanë nisur të evidentojnë përmes daljeve në media problematikat që lidhen me kushtet e punës së punonjësve të Gardës. Për këtë, Garda e Republikës, pavarësisht faktit që këto subjekte daljen e tyre në media e kanë bërë në cilësinë e përfaqësuesve të Sindikatës, ndaj tyre ka filluar ecuria disiplinore dhe janë marrë masa disiplinore të përjashtimit nga Garda të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të saj, si dhe shtyrje të afatit të gradimit për 2 vjet për Kryetaren e Rrjetit të Gruas.

Në këtë kuadër, Komisioneri konstatoi se:

- Zgjidhja e marrëdhënieve të punës me B.N., i cili është Kryetar i Sindikatës dhe A.Ll., i cili është Zëvendëskryetar i saj, si dhe marrja e masës disiplinore ndaj M.H., e cila është Kryetarja e Rrjetit të Gruas, është bërë në kundërshtim me garancitë ligjore që parashikohen në kuadër të lirisë sindikale, pasi punëdhënësi Garda e Republikës nuk ka respektuar parashikimet e nenit 181 të Kodit të Punës;
- Marrja e masave disiplinore ndaj anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, është e kundërligjshme dhe ka ardhur si pasojë e mosrespektimit, si dhe në kundërshtim të akteve normative sipërcituar në këtë vendim. Ky veprim i kundërligjshëm i Gardës së Republikës, në cilësinë e punëdhënësit, ka sjellë pasoja të rënda në ushtrimin e misionit dhe veprimtarisë së Sindikatës dhe anëtarëve të saj, në kundërshtim të hapur edhe me nenin 184 të Kodit të Punës, sipërcituar.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Garda e Republikës ka diskriminuar subjektet ankueses në të drejtën e tyre për punësim, pasi marrja e masave disiplinore ndaj tyre dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkaqe të mbrojtura nga LMD, përkatësinë në sindikatë.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të anëtarëve themelues të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, në të drejtën për punësim dhe profesion, për shkak të përkatësisë në sindikatë, nga ana e Gardës së Republikës.
- Konstatimin e diskriminimit të B.N., M.H. dhe A.Ll., në të drejtën për punësim dhe profesion, për shkak të përkatësisë në sindikatë, nga ana e Gardës së Republikës.
- Në referim të pikës 1 dhe 2, Garda e Republikës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të anëtarëve themelues të Sindikatës duke shfuqizuar në mënyrë të menjëhershme masat disiplinore “Vërejtje” dhe “Shtyrje të afatit të gradimit për 2 vjet” për M.H.
- Në referim të pikës 2, Garda e Republikës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer në vendin e mëparshëm të punës B.N., dhe A.Ll.
- Rekomandohet Këshilli i Ministrave, që në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të marrë masat për rishikimin dhe riformulimin në mënyrë objektive, të justifikuar dhe të qartë, të parashikimeve të nenit 158, pika 13/dh të VKM-së Nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, duke pasur në vëmendje lirinë dhe të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale.

X. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE

34. J.M., kundër OST sh.a.

VENDIMI NR. 264, DATË 08.10.2024

Shkaku: Gjendje shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë/Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja J.M., është diskriminuar në të drejtën për punësim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe është viktimizuar për shkak të ankesës së paraqitur tek KMD.

FAKTET

Ankuesja J.M., ka filluar punë pranë OST sh.a., në datën 01.12.2020. Ankuesja pretendon se, marrëdhënia juridike e punës mes palëve ka vijuar në normalitet juridik, deri në muajin janar të vitit 2023, moment i emërimit të Drejtores së re të Departamentit të Administrimit (DA) të OST sh.a., E.D. Që prej momentit të emërimit të E.D., në krye të DA, ankuesja pretendon se ndaj saj ka patur një tendencë negative si pasojë e të cilës më pas janë gjeneruar edhe konflikte me natyrë punë. Më datë 28.03.2023 ndaj ankuses është vendosur dhënia e masës disiplinore “Vërejtje” dhe në vijim më datë 30.05.2023, ankuesja është njoftuar për fillimin e një tjetër procedure disiplinore ndaj saj. Në lidhje me këtë situatë, ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesën Nr. 102 Regj., datë 30.05.2023, duke pretenduar se ishte duke u diskriminuar nga ana e punëdhënësit OST sh.a, ndër të tjera në lidhje me procedurat disiplinore të ndërmarra ndaj saj nga ana e punëdhënësit. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri nëpërmjet vendimit Nr. 251, datë 13.12.2023, ka konstatuar diskriminimin e ankuses.

Në datën 03.07.2023, eprori direkt i ankuses, E.D., Drejtore e DA, ka kryer vlerësimin e performancës së ankuses për periudhën janar - qershor 2023. Rezulton se vlerësimi i performancës së ankuses për këtë periudhë është 2.5 pikë, i cili sipas rregullave të vlerësimit të performancës vlerësohet: “*Ka nevojë për përmirësim*”. Ankuesja e ka kundërshtuar vlerësimin e performancës për periudhën janar - qershor 2023.

Në janar të vitit 2024, është kryer procesi i vlerësimit të performancës së punonjësve për periudhën korrik-dhjetor 2023. Nga ana e eprores E.D., Drejtore e DA, vlerësimi përfundimtar i performancës së ankuses është 2.55 pikë, i cili klasifikohet si: “*Ka nevojë për përmirësim*”. Gjatë periudhës janar - shkurt 2024, ankuesja nuk ka qenë në punë, pasi ka qenë me raport mjekësor Vlerësim i është komunikuar ankuses në datë 19.02.2024. Pasi ankuesja është paraqitur në punë dhe ka marrë

dijeni për vlerësimin e ka ankimuar atë. Ndërkohë që Formulari i Vlerësimit të Performancës nuk i ishte komunikuar akoma ankueses, në datën 15.02.2024, eprori direkt i ankueses, i është drejtuar Administratorit të OST sh.a duke propozuar uljen në detyrë të ankueses. Ankuesja nuk është informuar në lidhje me këtë propozim i cili prek të drejtat e saj në marrëdhënien e punës, sikurse janë pozicioni i punës dhe paga. Me datë 27.02.2024, Administratori i OST sh.a informon ankuesen për uljen në detyrë. Ankuesja e ka kundërshtuar ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë. Ankuesja i komunikoi punëdhënësit se nuk e pranonte pozicionin e ri të punës dhe se e konsideronte zgjidhje të kontratës së punës.

Në lidhje me provueshmërinë e shkakut të “*gjendjes shëndetësore*”, nga aktet e administruara konstatohet se, ankuesja për periudhën janar 2023 – shkurt 2024, ka qenë në kushtet e paaftësisë së përkohshme në punë, konfirmuar nëpërmjet raporteve mjekësore, gjithsej 74 ditë pune dhe konfirmuar nga vetë punëdhënësi OST sh.a. Në këto kushte, Komisioneri konsideron se shkak i gjendjes shëndetësore, rezulton i provuar.

Ankuesja pretendoi se, është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme në lidhje me vlerësimin e performancës në punë për periudhën Korrik-Dhjetor 2023 dhe më pas nëpërmjet vendimit të marrë nga punëdhënësi/OST sh.a për ndryshimin e pozicionit të saj të punës duke e ulur në detyrë nga Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse (DSHM), Departamenti i Administrimit (DA) në pozicionin Teknik Specialist Ekspert, pranë Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Departamenti i Administrimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesja J.M., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë procesit të vlerësimit të performancës në punë për periudhën korrik-dhjetor 2023 dhe ndryshimit të pozicionit të punës/uljes në detyrë nga Drejtore e DSHM, në DA në Teknik Specialist Ekspert, pranë Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, në DSHM, DA. Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

- Mungesat në punë të ankueses për shkak të paaftësisë për punë si pasojë e gjendjes shëndetësore, gjatë periudhës janar 2023 – dhjetor 2024, kanë ndikuar duke ulur vlerësimin e performancës në punë të ankueses për të dy periudhat gjashtëmujore të vlerësimit të performancës, janar - qershor 2023 dhe korrik - dhjetor 2023.
- Vendimi i punëdhënësit/OST sh.a për ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë të ankueses është bazuar në vlerësimin e performancës në punë për vitin 2023, performancë e cila ka pësuar ulje për shkak të mungesave në punë të ankueses të cilat kanë ndodhur për shkak të paaftësisë për punë të ankueses si pasojë e gjendjes shëndetësore.
- Shprehimisht në vendimmarrjen e punëdhënësit/OST sh.a., për ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë të ankueses deklarohet se ky vendim bazohet në memon e datës 15.02.2024, nëpërmjet të cilës E.D., Drejtore e DA, propozon uljen në detyrë të ankueses. Një nga arsyet ku bazohet ky propozim për uljen në detyrë, shprehimisht deklarohet se janë mungesat në punë të ankueses, ku relatohet se në total ankuesja ka munguar 74 ditë pune me raport mjekësor.
- Mungesat në punë të ankueses janë të gjitha të justifikuara nëpërmjet raporteve mjekësore, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Rezultoi se gjendja shëndetësore e ankueses e cila ka sjellë si pasojë mosparaqitjen në punë të ankueses ka shërbyer si arsye dhe ka ndikuar, njëkohësisht, si në vlerësimin e performancës së ankueses, ashtu edhe në vendimin e punëdhënësit/OST sh.a për uljen në detyrë të ankueses. Komisioneri vlerësoi se rezulton e provuar lidhja shkakësore midis trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja në lidhje me vlerësimin e performancës dhe uljen në detyrë dhe shkakut të gjendjes shëndetësore. Gjithashtu, rezultoi e provuar se, procesi i vlerësimit të performancës në punë dhe procedura e ndjekur në lidhje me vendimin e punëdhënësit për ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë të ankueses, janë kryer në kundërshtim me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, Kodin e Punës, dhe rregulloret e brendshme të punëdhënësit.

Komisioneri vlerësoi se krijohet prezumimi se, ankuesja është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore në lidhje me vlerësimin e performancës në punë për periudhën korrik-dhjetor 2023 dhe uljen në detyrë. Në këto kushte, punëdhënësi/OST sh.a., kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të diskriminimit dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses se këto veprime janë kryer për shkak të gjendjes shëndetësore.

Komisioneri vlerësoi se, në kuadër të procesit të vlerësimit të performancës në punë, punonjësi, vlerësohet për mënyrën se si ai ka performuar në kryerjen e detyrave të tij funksionale, pra se si ai i ka kryer këto detyra gjatë kohës që ai ka qenë në punë dhe nëse ai zotëron aftësitë dhe karakteristikat e nevojshme profesionale. Komisioneri vlerëson se, për sa kohë që mungesat në punë të ankueses, rezultojnë të gjitha jo vetëm të justifikuara, por edhe një ushtrim i të drejtave që

punëmarrësi gëzon në kuadër të marrëdhënies së punës, të garantuara nga Kodi i Punës, kontrata kolektive dhe ajo individuale, barra për të siguruar menaxhimin efektiv dhe cilësor, koordinimin e punëve apo gjurmën e punës, është përgjegjësi e punëdhënësit/OST sh.a., që të sigurojë mbarëvajtjen e punës nëpërmjet strukturave të tij dhe me kostot e tij. Punëmarrësi nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të siguruar mbarëvajtjen e punëve, kur ai nuk është prezent në punë për shkaqe të justifikuara dhe të garantuara nga kuadri ligjor dhe aktet e brendshme të punëdhënësit.

Punëdhënësi/OST sh.a., nuk arriti të provojë se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, nuk ka lidhje shkakësore me shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesja, ndërsa justifikimet e paraqitura rezultuan plotësisht të pabazuara. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me trajtimin e ankueses gjatë vlerësimit të performancës në punë dhe uljen në detyrë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesja, mbetet shkak i diskriminimit “gjendja shëndetësore”. Komisioneri vlerësoi se gjendja shëndetësore e punëmarrësit, nuk duhet të jetë pengesë për gëzimin nga ana e personit të të drejtës së tij për punësim dhe profesion, për sa kohë që nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Gjatë procesit të vlerësimit të performancës në punë për periudhën korrik - dhjetor 2023, shprehimisht deklarohet se: *“Ankuesja ka cituar përpara KMD-së pohime të paprovuara me fakte duke i adresuar personalisht për drejtorin e DA-së. Këto pohime janë hedhur poshtë nga KMD. Prova për këtë është dosja e administruar e KMD-së në arkivë ku pretendohen fakte të pavërteta për diskriminim personalisht për drejtorin e DA-së. Citimi i pohimeve të gënjeshtra pa prova, përpara institucioneve publike për eprorin është thyerje e rëndë e rregullave të etikës por dhe më tej në kufijtë e shpifjes.”*

Ushtrimi i të drejtës për tu ankuar për veprime ose mosveprime që cenojnë të drejtat në kuadër të marrëdhënies së punësimit, përbën një të drejtë të punëdhënësit. LMD, specifikisht garanton të drejtën e punëmarrësit për t’u ankuar nëse pretendon se është diskriminuar në vendin e punës. Ushtrimi i të drejtës për tu ankuar për diskriminim, pavarësisht nga fakti nëse pretendimet e personit që ankohen nuk rezultojnë të provuara, nuk mund të konsiderohen si thyerje e rëndë e rregullave të etikës.

Pas paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit në datën 30.05.2023, ankuesja ka vijuar të ekspozohet ndaj trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm për të cilin, jo vetëm nuk konstatohet një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm, por fakti që ankuesja ka ngritur pretendime për diskriminim para KMD, ka ndikuar drejtpërdrejtë në vlerësimin e performancës në punë dhe për rrjedhojë në vendim-marrjen për ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë, pasi kjo e fundit sikurse deklaroi edhe vetë punëdhënësi është bazuar në vlerësimin e performancës në punë të ankueses.

Komisioneri arrin në përfundimin se, provohet plotësisht se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses si, për sa i përket vlerësimit të performancës për periudhën korrik - dhjetor 2023, ashtu edhe vendimi i datës 27.02.2024 i punëdhënësit për ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë të ankueses, ka ardhur si rezultat edhe i paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit.

Komisioneri arrin në përfundimin se, punëdhënësi, Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OST sh.a), e ka diskriminuar ankueses J.M., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe ankuesja është viktimizuar, në lidhje me vlerësimin e performancës në punë për periudhën korrik - dhjetor 2023 dhe ndryshimin e pozicionit të punës/uljen në detyrë të ankueses.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses J.M., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.
- Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankueses J.M., nga ana e Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a.
- Në referim të pikës 1 dhe 2, të Vendimit, Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke e anuluar vendimin Nr. 1073/1 Prot., datë 27.02.2024 “*Miratim ndryshim pozicioni*”, të Administratorit të OST sh.a dhe rikthyer ankuesen J.M., në pozicionin e mëparshëm të punës.

XI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR

35. D.D., kundër D.B., Kryetar i Komisionit të Konkurencës

VENDIM NR. 55, DATË 05.03.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër (*qendrimit të kundërt të mbajtur gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj*)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejt/Udhëzim për diskriminim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në institucionin e Autoritetit të Konkurencës dhe është larguar nga puna, për shkak të “*qendrimit të kundërt të mbajtur gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj*”, nga ana e D.B., Kryetar i Autoritetit të Konkurencës.

FAKTET

Ankuesja D.D., ka qenë në marrëdhënie pune në shërbimin civil pranë institucionit të Autoritetit të Konkurencës (AK), në pozicionin “Sekretare e Përgjithshme”. Me shkresën datë 27.06.2023 “*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*”, Kryetari i Autoritetit të Konkurencës, D.B., në cilësinë e eprorit direkt, i ka kërkuar Komisionit të Disiplinës, të fillojë ecurinë disiplinore për D.D., me detyrë Sekretare e Përgjithshme. Me urdhrin datë 27.06.2023 “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, të Kryetarit të Autoritetit të Konkurencës, është urdhëruar ngritja e Komisionit Disiplinor, për ndjekjen e procedurës së ecurisë disiplinore të propozuar nga eprori direkt, për D.D., me detyrë Sekretare e Përgjithshme. Komisioni i Disiplinës, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e eprorit direkt të ankuseses, në mbledhjen e datës 27.06.2023, ka vendosur pezullimin e ankuseses deri në marrjen e vendimit përfundimtar, si dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj, me motivacionin për shkelje shumë të rëndë të parashikuar në gërmën “a”, pika 2, të nenit 57, të Ligjit Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Komisioni Disiplinor, me shkresën datë 29.06.2023 “*Njoftim për fillimin e procedimit Disiplinor*”, ka njoftuar ankuesen për pezullimin nga detyra dhe për nisjen e ecurisë disiplinore, duke i parashtruar shkeljet disiplinore të pretenduara në ngarkim të saj, si dhe e ka bërë me dije se shqyrtimi i shkeljeve të pretenduara në ngarkim të saj do të bëhej në datën 07.07.2023 ora 11:00.

Në datën 03.07.2023, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC), duke pretenduar se urdhri për ngritjen e Komisionit Disiplinor, i nxjerrë nga Kryetari i Komisionit të Konkurencës dhe njoftimi për fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj, i nxjerrë nga Komisioni i Disiplinës, ishin në kundërshtim me ligjin. Me urdhrin Nr. 54,

datë 04.07.2023, KMSHC, ka urdhëruar nisjen e verifikimit të ligjshmërisë së aktit administrativ Nr. 359/1 Prot., datë 27.06.2023 *“Urdhër për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*, të nxjerrë nga institucioni i Autoritetit të Konkurencës si dhe aktit *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”*, të nxjerrë nga Komisioni i Disiplinës pranë Autoritetit të Konkurencës. Nëpërmjet këtij urdhri është kërkuar që Komisioni i Disiplinës të pezullojë procedimin disiplinor ndaj ankueses, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për vlerësimin e ligjshmërisë, nga ana e KMSHC. Në datën 07.07.2023, është mbledhur Komisioni i Disiplinës dhe ka vlerësuar se urdhri i KMSHC për pezullimin e procedurës disiplinore, nuk ka bazë ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë.

Me shkresën datë 17.07.2023, *“Për pezullimin për shkak të ligjit”*, ankuesja i është drejtuar Njesisë Përgjegjëse dhe për dijeni Komisionit të Konkurencës, duke kërkuar nga Njësia Përgjegjëse në Autoritetin e Konkurencës, konstatimin e pezullimit për shkak të ligjit, në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar. Me urdhrin datë 14.07.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, D.D., është emëruar në detyrën e Këshilltarit në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me shkresën datë 17.07.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, pranë Autoritetit të Konkurencës, ankueses i është kërkuar që ta paraqesë kërkesën nga e para në formatin e duhur, si dhe të përcaktojë afatin për të cilin po kërkonte pezullimin. Ankuesja ka paraqitur një kërkesë tjetër me datë 17.07.2023, duke sqaruar se afati kërkohet në rastet e parashikuara nga Ligji Nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar *“Pezullimi me kërkesë të nëpunësit”*, duke rikërkuar edhe një herë që Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurencës, të zbatojë detyrimin që ka sipas ligjit, konstatimin e pezullimit për shkak të ligjit. Ankuesja ka theksuar se, është emëruar në një pozicion pune jashtë shërbimit civil.

Me shkresën datë 18.07.2023, Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurencës, i ka kthyer përgjigje ankueses në lidhje me kërkesën për pezullim nga shërbimi civil, duke konfirmuar pezullimin nga shërbimi civil. Pasi ankuesja ka marrë dijeni për shkresën sipërcituar, ka bërë ankesë pranë KMSHC. Me urdhrin Nr. 60, datë 20.07.2023, të KMSHC *“Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit administrativ Nr. 359/22 Prot., datë 18.07.2023, me objekt pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil, të nxjerrë nga njësia përgjegjëse, në institucionin e Autoritetit të Konkurencës”*. Ky urdhër i është komunikuar Autoritetit të Konkurencës me datë 20.07.2023.

Me vendimin Nr. 1003, datë 18.07.2023, Komisioni i Konkurencës, në institucionin e Autoritetit të Konkurencës, bazuar në kërkesën për pezullim datë 17.07.2023, të paraqitur nga ankuesja, ka vendosur: *“I. Largimin nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurencës së D.D., dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të punës me Autoritetin e Konkurencës. II. Përfundimin e marrëdhënies financiare nga data 17.07.2023 ...”*.

Rezulton se në datën 18.07.2023, midis D.D., Th.K., dhe Dh.S., është mbajtur procesverbali me datë 18.07.2023, në të cilin relatohet se procesverbali mbahet me qëllim dorëzimin e detyrës dhe inventarit fizik të gjendjes materiale, nga ana e ankueses.

Me vendimin Nr. 71, datë 25.07.2023, *“Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative që pasqyrojnë ndryshime në ecurinë e marrëdhënies në shërbimin civil, për pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, të nxjerra nga njësia përgjegjëse dhe Komisioni i Konkurencës, në institucionin Autoriteti i Konkurencës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë, brenda afatit të caktuar”, KMSHC, ka vendosur: “Të paralajmërojë institucionin e Autoritetit të Konkurencës, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë: 1. Drejtori i Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, të anulojë shkresën Nr. 359/22 Prot., datë 18.07.2023, si një akt i paligjshëm, i nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 54, pika 1, germa a), të Ligjit Nr. 152/2023, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e germës d), të nenit 109, të Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Pas këtij veprimi, me qëllim rregullimin e pasojave, njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 3, të nenit 54, Ligjit Nr. 152/2013, të konstatojë pezullimin nga shërbimi civil për shkak të ligjit, për periudhën përkatëse të emërimit, për punonjësen D.D. 2. Pas konstatimit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 66, germa e/2, të Ligjit Nr. 152/2013, i ndryshuar, të deklarojë me vendim lirimi nga shërbimi civil për nëpunësen D.D., për shkak të ligjit. 3. Komisioni i Konkurencës të konstatojë pavlefshmërinë absolute, sa i takon pikës 1 dhe 3, të vendimit Nr. 1003, (Nr. 359/23 Prot.), datë 18.07.2023, pasi ato kanë dalë në tejkalim të kompetencave të këtij organi, në zbatim të germës i), të nenit 108, dhe neneve 110 dhe 111, të Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”...”*

Komisioni i Disiplinës është mbledhur në datën 28.07.2023 dhe referuar procesverbalit të mbajtur gjatë këtij takimi, mbledhja është mbajtur me qëllim që të njihen anëtarët e rinj të Komisionit të Disiplinës me shkeljet në ngarkim të D.D., dhe për të dëgjuar prapësimet e saj. Komisioni i Disiplinës ka vendosur ta ftojë edhe njëherë D.D., duke përcaktuar se mbledhja e radhës do të zhvillohej në datën 08.09.2023.

Me datë 11.08.2023, ankuesja i është drejtuar Autoritetit të Konkurencës me një kërkesë, nëpërmjet të cilës kërkon sqarime në lidhje me pagën e muajit korrik 2023, pasi ka konstatuar se, në llogarinë e saj bankare është arkëtuar rreth 50% e pagës takuese që i korrespondon periudhës deri më 17 korrik, datë kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë institucion. Në lidhje me këtë kërkesë, ankueses i është kthyer përgjigje me shkresën datë 25.08.2023, ku sqarohet në lidhje me pagën e muajit korrik 2023, si dhe bëhet me dije se, dorëzimi i detyrës nga ana e saj nuk ishte bërë i plotë.

Ankuesja ka depozituar shkresën datë 29.08.2023, ku pretendon se arsyet e dhëna në lidhje me pagën e muajit korrik 2023, ishin të pabazuara në ligj, se ajo kishte bërë dorëzimin e e rregullt të detyrës dhe për këtë qëllim ishte mbajtur procesverbali i datës 18.07.2023. Në lidhje me vlerësimet e punës, ankuesja deklaron se është penguar në ushtrimin e detyrës personalisht nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurencës duke kaluar edhe në intimidim që ka çuar sipas saj deri në cenim të integritetit të saj profesional por edhe fizik, referuar kjo një ngjarje që pretendohet të ketë ndodhur në datë 03.07.2023, në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. Ajo kërkon në këtë shkresë që të garantohet integriteti dhe ligjshmëria e procesit nga çdo intimidim i mundshëm nga Kryetari i AK apo çdo person tjetër që mund të jetë pjesë e këtij procesi. Në lidhje me librezën e punës, ankuesja pretendon në këtë shkresë se, nga ana e institucionit nuk ishte kryer asnjë veprim për shkak se, me urdhër verbal të Kryetarit të Autoritetit të Konkurencës është penguar kryerja e veprimeve për plotësimin e saj nga personi përgjegjës dhe vendosja e vulës së institucionit.

Me shkresën datë 11.09.2023, ankuesja i është drejtuar Autoritetit të Konkurencës, ku ka deklaruar se, është paraqitur në datën 31.08.2023 pranë Autoritetit të Konkurencës, ku ka përmbushur disa detyrime ligjore të mbartura nga periudha e ushtrimit të funksionit të Sekretarit të Përgjithshëm. Ankuesja ka pretenduar se, nuk i është bërë me dije asnjë akt tjetër përveç disa vlerësime pune që i përkasin një periudhe të kaluar, konkretisht janar-qershor 2023, për të cilat ajo pretendon se është penguar në plotësimin dhe nënshkrimin e tyre. Në vijim, ankuesja shprehet se mbetet në pritje të konfirmimit dhe krijimit të kushteve nga ana e institucionit për përmbushjen e kësaj detyre.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme të ankueses, me shkresën datë 11.09.2023, Autoriteti i Konkurencës, i ka komunikuar ankueses se mund të paraqitet në datën 12.09.2023 nga ora 09:00-14.00, pranë këtij institucioni pasi duhet të përmbushte detyrimet në lidhje me nënshkrimin e disa procedurave prokurimi (të listuara në shkresë). Në vijim të komunikimeve të mësipërme, ankuesja i është drejtuar Autoritetit të Konkurencës me shkresën datë 15.09.2023, duke parashtruar se nuk i është mundësuar brenda afateve ligjore përfundimi i procesit të vlerësimit të punës së nëpunësve civilë për periudhën janar - qershor 2023, për shkak të veprimeve të paligjshme të institucionit. Ankuesja shprehet se, përveç procesit të vlerësimeve të punës, nuk mbart më asnjë detyrim në raport me institucionin. Sa më sipër, me urdhrin datë 15.09.2023, Kryetari i Autoritetit të Konkurencës, D.B., ka urdhëruar: *“1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vlerësimeve të punës për periudhën 01.07.2022 – 31.12.2022 ...”*.

Në vijim, Komisioni i Disiplinës, pasi ka analizuar provat materiale në lidhje me shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankueses, ka vendosur: *“I. Dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për D.D.”*.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit të 12, i saj;

- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Mbështetur në provat e administruara, Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesja D.D., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë procedurës së ecures disiplinore, ndryshimit të ecures së marrëdhënies në shërbimin civil për ankuesen në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm” pranë Autoritetit të Konkurencës, nëpërmjet procedurës së ndjekur për pezullimin nga shërbimi civil, si dhe aplikimit ndaj saj të masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Referuar parashtrimeve të depozituar nga D.B., ky i fundit konfirmon faktin se, në datën 26.06.2023, ka patur një takim me D.D., të cilës i ka “ofruar” që të largohej me dorëheqje nga detyra, si një “formë e butë largimi”, pasi ai kishte humbur besimin te D.D., dhe nuk mund të punonin më bashkë, për shkak se kishte marrë dijeni se nga ana e ankuses gjatë ushtrimit të detyrës ankuesja kishte tjetërsuar faktet dhe ligjin.

Mbështetur në legjislacionin e analizuar, D.B., qoftë në cilësinë e pretenduar të eprorit direkt të ankuses, qoftë në cilësinë e një zyrtari me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, nuk ka të drejtë që të “*ofrojë mundësi për forma të buta largimi nëpërmjet dorëheqjes*”. Pra, D.B., nëpërmjet “ofrimit të mundësisë për forma të buta largimi nëpërmjet dorëheqjes” ka synuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të ankuses, në dukje në mënyrë të vullnetshme nëpërmjet dorëheqjes. Megjithëse pranimi i dorëheqjes apo çdo veprim tjetër që lidhet me marrëdhënien e punës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurencës është kompetencë e Komisionit të Konkurencës dhe jo posaçërisht e Kryetarit të Komisionit, sikurse është shprehur edhe D.B., në parashtrimet e tij.

Komisioneri vlerëson se, D.B., Kryetar i Komisionit të Konkurencës, qoftë nëpërmjet veprimeve të tij të drejtëpërdrejta, ashtu edhe nëpërmjet mosveprimeve nga ana e tij, duke lejuar situata në kundërshtim me ligjin dhe duke mos marrë masa për të rregulluar veprimet dhe sjelljet në kundërshtim me ligjin, e ka ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm. Në cilësinë e titullarit të institucionit të Autoritetit të Konkurencës, Kryetarit të Komisionit të Konkurencës dhe Kryetarit të Komisionit të Disiplinës, D.B., me veprimet dhe mosveprimet e tij të drejtëpërdrejta, së bashku me udhëzimet e shprehura të vendosura nëpër praktika të ndryshme,

pavarësisht se nuk janë kërkesa të drejtpërdrejta ndaj anëtarëve të Komisionit të Disiplinës apo njërive/personave të tjerë përgjegjës të ngarkuar nga ligji me kompetenca të caktuara në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, tregojnë preferencë ose inkurajim për të trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavourshme ankuesen.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se D.B., Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, ka diskriminuar ankuesen në të drejtën për punësim, për shkak të *“qendrimit të kundërt të mbajtur nga ankuesja gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj”*. Për rrjedhojë, D.B., Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses D.D., në të drejtën për punësim, në formën e *“diskriminimit të drejtpërdrejtë”* dhe *“udhëzimit për diskriminim”*, për shkak të *“qendrimit të kundërt të mbajtur nga ankuesja gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj”*, nga ana e D.B., Kryetar i Komisionit të Konkurrencës.
- Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, D.B., Kryetar Komisionit të Konkurrencës, duhet të marrë masa për ndalimin e diskriminimit dhe mospërsëritjen e situatave të ngjashme ndaj ankueses D.D., të cilat cenojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në të drejtën për punësim.

36. A.B., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k., L.Xh.,³² dhe F.B.³³

VENDIM NR. 192, DATË 08.07.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër (*ankesës për diskriminim kundër eprores direkte L.Xh.*)
Forma: Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Albchrome” sh.p.k. Ndaj saj është marrë masë për largim nga puna për shkak se është ankimuar për diskriminim kundër eprores së saj direkte.

FAKTET

Në vitin 2018, ankuesja, A.B., ka lidhur marrëdhëniet e punës me Shoqërinë “Albchrome” sh.p.k., duke u punësuar në pozicionin “Junior-Coordinator and data analyst”, në Departamentin e Shitjeve.

Në momentin e emërimit në Departamentin e Shitjeve, komunikimi mes saj dhe drejtueses së departamentit, L.Xh., ka qenë i rënduar. Lidhur me këtë, më datë 18.01.2023, ankuesja i është drejtuar me e-mail F.B., dhe Administratorit të shoqërisë, duke i bërë me dije lidhur me pakënaqësitë sa i përket vlerësimit të punës së bërë nga ana e drejtueses së departamentit.

Fillimisht, ankuesja dhe L.Xh., kanë shkëmbyer mes tyre e-maile lidhur me proceset e punës së departamentit, ku A.B., pretendon se është përjashtuar nga disa prej tyre, të cilat i ka edhe pjesë të përshkrimit të punës.

Duke qenë se nuk ka gjetur zgjidhje, në vijim, përmes e-mail-it, i është drejtuar Departamentit të Burimeve Njerëzore, F.B., me ankesë ndaj eprores së saj L.Xh., duke pretenduar se ndihej e diskriminuar, e përjashtuar nga detyrat e saj, e bullizuar, e dëmtuar emocionalisht dhe në stres në mjedisin ku ajo punon. Nga ana e Departamentit të Burimeve Njerëzore, ankueses i është komunikuar se ankesa e saj është marrë në konsideratë dhe është ftuar në takim për të paraqitur të gjitha faktet në të cilat ajo mbështet ankimin e saj, por pa caktuar një datë.

Shoqëria Shoqëria “Albchrome” dhe F.B., nuk kanë marrë masa për të shqyrtuar rastin dhe ankesën për diskriminim të paraqitur nga ankuesja, por në vijim ndaj saj janë marrë masa disiplinore duke e larguar nga puna.

³² Në cilësinë e eprores direkte të ankueses.

³³ Në cilësinë e Drejtores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Administratës së Shoqërisë “Albchrome”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të gjithë dokumentacionit e parashtrimeve të palëve, Komisioneri vlerësoi se, ankuesja A.B., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k., F.B., në cilësinë e përfaqësueses së punëdhënësit dhe L.Xh., si eprore direkte e saj, sepse:

- Veprimet dhe mosveprimet e L.Xh., në cilësinë e eprores direkte të ankueses, duke e përjashtuar nga detyrat e saj funksionale; duke ndryshuar vlerësimin e punës nga performuese e mirë në performuese shumë e dobët dhe përdorimit të gjuhës fyese, e kanë ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.
- Veprimet dhe mosveprimet e F.B., në cilësinë e drejtueses së Burimeve Njerëzore dhe përfaqësueses së shoqërisë në marrëdhëniet e punësimit, duke mos ruajtur anonimatit e ankesës së saj; duke mos i dhënë përgjigje ankesës për diskriminim; duke mos i vënë në dijeni aktet e brendshme rregullatore të shoqërisë dhe duke marrë masë disiplinore për audio regjistrimin e bërë pavarësisht se nuk ka ndonjë akt rregullator të brendshëm lidhur me këto raste, e kanë ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.
- Veprimet dhe mosveprimet e punëdhënësit, Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k., sipërcituar, kanë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket trajtimit jo efektiv të ankesës së saj për diskriminim, duke i mohuar vazhdimësinë e marrëdhënieve të punësimit dhe larguar nga puna. Gjithashtu, Shoqëria “Albchrome” ka dështuar në zbatimin e pikës 4, të nenit 15 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtë punëmarrësit që ka bërë ankesën, ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi, duke e larguar përfundimisht nga puna.

Në konkluzion të sa më sipër, bazuar në vlerësimin e analizimin e fakteve e legjislacionit në fuqi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në përfundimin se L.Xh., ka ekspozuar

ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm, në formën e viktimizimit, në të drejtën për punësim, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte pas “*ankesës për diskriminim kundër eprores direkte të saj L.Xh.*”. Për rrjedhojë, L.Xh., në cilësinë e eprores direkte të ankueses, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses A.B., në të drejtën për punësim, në formën e viktimizimit, për shkak të “*ankesës për diskriminim kundër eprores direkte L. Xh.*”, nga ana e Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.
- Konstatimin e diskriminimit të ankueses A.B., në të drejtën për punësim, në formën e viktimizimit, për shkak të “*ankesës për diskriminim kundër eprores direkte L.Xh.,*”, nga ana e L. Xh.
- Konstatimin e diskriminimit të ankueses A.B., në të drejtën për punësim, në formën e viktimizimit, për shkak të “*ankesës për diskriminim kundër eprores direkte L.Xh.,*”, nga ana e F.B.
- Shoqëria “Albchrome” sh.p.k., të marrë masa për të bërë me dije të gjithë punëmarrësit lidhur me aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë. (si Rregullore, Kode, Politika të Brendshme etj.)
- Shoqëria “Albchrome” sh.p.k., të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin për Ligjin Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, duke e afishuar atë në mjediset publike të Shoqërisë³⁴.

³⁴ Referuar nenit 13/2 të LMD-së, në të cilën parashikohet se: “*Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara*”.

37. L.M., kundër Inspektoratit Shtetëror, Teknik dhe Industrial

VENDIM NR. 207, DATË 22.07.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Inspektoriatin Shtetëror, Teknik dhe Industrial . Atij i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës pa të drejtë, duke e diskriminuar për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit.

FAKTET

Subjekti ankues, ka filluar marrëdhënien e punës me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial më datë 17.01.2020, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës individuale të punës me kohëzgjatje të pacaktuar, dhe ka kryer pranë këtij subjekti funksionet dhe detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Asistencës Ligjore, në Drejtorinë e Çështjeve Juridik në periudhën 17.01.2020 - 19.01.2023 dhe detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike, në periudhën 19.01.2023 - 26.02.2024.

Në të gjitha pozicionet e punës që ka mbajtur pranë punëdhënësit, ISHTI-t, ka kryer detyrat e ngarkuara me devotshmëri, përgjegjësi dhe përkushtim, fakt të cilin e tregojnë edhe vlerësimet e vazhdueshme në punë, të gjitha “shumë mirë”.

Kryeinspektori ka vendosur lirim të tij nga detyra, me motivacionin “shkelje e parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit”, sipas përcaktimeve të nenit 11/1, të Kodit të Punës. Ankuesi ka pretenduar se largimi i tij nga puna është bërë për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit dhe jo për motivin e cituar në shkresë.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim nga ana e ISHTI-t, si dhe marrjen e masave për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke e rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në përfundim të analizës së fakteve, provave e legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se punëdhënësi nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, lidhur me procedurën e ndjekur për lirim të tij nga detyra.

Komisioneri konstatoi se, punëdhënësi nuk ka provuar se:

- Ankuesit t’i ishte komunikuar dhe bërë e ditur shkelja e pretenduar (cilësuar si cenimi i parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit);
- Që atij t’i ishte krijuar mundësia për t’u njohur me aktet e provat kundër tij, të cilat provonin sipas punëdhënësit cenimin e mirëbesimit dhe bashkëpunimit; Këto akte e prova nuk u depozituan as para KMD-së, megjithëse u kërkuan në mënyrë të përsëritur;
- Ankuesit i i janë ofruar dhe garantuar mundësi reale për t’u mbrojtur efektivisht nga masa ekstreme e dhënë kundrejt tij, duke i zgjidhur marrëdhëniet e punës në mënyrë të menjëhershme me të, për më tepër kur ai nuk ka justifikuar e provuar se është në plotësim të këtij kushti, pra në rrethanat e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës³⁵.
- Që ka respektuar parimin e kontradiktorialitetit, si pjesë thelbësore e procedurës kontestimore.
- Që masa e marrë për lirim të tij nga detyra është e arsyetuar, proporcionale, e drejtë, dhe e bazuar në fakte, prova e ligj.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, shkelja e procedurës për largimin e ankuesit nga detyra, ka cënuar rëndë të drejtat e tij si punëmarrës për një proces të rregullt, të drejtë e ligjor.

Punëdhënësi nuk ka depozituar asnjë provë që të vërtetojë se ndaj ankuesit është zbatuar procedura ligjore lidhur me njoftimin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës/largimin nga detyra, të drejtën për t’u njohur me pretendimet e provat e depozituara kundër tij, për t’u dëgjuar, mbrojtur e paraqitur prapësimet e provat në mbrojtje të tij.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e pranuar nga punëdhënësi/ISHTI, se, shkak për largimin e ankuesit nga puna/lirim nga detyra, është bërë qëndrimi i tij kritik kundrejt punëdhënësit, duke e konsideruar atë si cenim të parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit. Ky fakt jo vetëm është pranuar nga punëdhënësi, por i ka shërbyer atij edhe si një ndër arsye për të justifikuar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të.

³⁵ Referuar analizës së pjesës III/A, të Vendimit.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri, gjykoj se, veprimet e punëdhënësit (lirimi i tij nga detyra) haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga ky konflikt mes tyre dhe qëndrimi kritik ndaj Kryeinspektorit, dhe se atij i është cenuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta për punë dhe e ushtrimit të detyrës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, L.M., në të drejtën për punësim, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror, Teknik dhe Industrial (ISHTI), për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”.
- Në referim të pikës 1, ISHTI, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

38. H.M., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.

VENDIM NR. 302, DATË 05.12.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër/“*për shkak të deklaratave/qëndrimeve të tij në media*”
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, duke u larguar nga puna për shkak të deklaratave/qëndrimeve të tij në media ndaj Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.

FAKTET

H.M., në datë 08.09.2014, ka filluar punë si “*Mbledhës ferrokromi*”, pranë Uzinës së Ferrokromit Burrel.

Rezulton se në datë 16.02.2022, mes H.M., dhe Administratorit të Uzinës, E.I., ka pasur një konflikt fizik, i cili është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Në datë 02.02.2024, H.M., nëpërmjet medias ka bërë një deklaratë me video, e cila më pas është pasqyruar në media të ndryshme online³⁶. Në datë 07.02.2024, punonjësit e Uzinës së Ferrokromit Burrel kanë dalë në protestë³⁷ për të kërkuar përmirësimin e kushteve të punës, rritje të pagës dhe largimin e drejtorit për një incident të dy viteve më parë.

Në këtë protestë ka marrë pjesë dhe ankuesi, i cili ka deklaruar për mediat të njëjtat parashtrime si në datën 02.02.2024, si dhe ndër të tjera ka kërkuar largimin e E.I., dhe ka cituar faktin që ky i fundit shantazhon punonjësit për shkak se ata nuk janë pjesë e sindikatës që Shoqëria “Albchrome” ka nënshkruar Kontratën Kolektive.

Pas daljes publike në media, ankuesi është thirrur nga ana e punëdhënësit dhe ndaj tij është marrë masa disiplinore e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Subjekti ankues ka pretenduar se punëdhënësi (përfaqësuar nga shtetasi E.I.) e ka ngarkuar që të bëjë punë të ndryshme, e ka vënë në presion të vazhdueshëm dhe është ankuar vazhdimisht për punën dhe për kushtet e pagës.

³⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=IxG409rI-mk>
<https://alfapress.al/aktualitet/dhunoi-punetorin-denohet-nga-gjykata-drejtori-i-ufk-burrel-shantazhon-i93980>
<https://faxweb.al/dhunoi-punetorin-denohet-nga-gjykata-drejtori-i-ufk-burrel-shantazhon-deshmitare/>
<https://dosja.al/aktualitet/dhunoi-punetorin-denohet-drejtori-i-uzines-ne-burrel-shantazhon-deshm-i350627>
<https://zeri.ai/aktualitet/dokument-kapi-per-fyti-punetorin-denonet-nga-gjykata-drejtori-i-ufk-b-i191494>

³⁷ [Burrel/ Metalurgët në protestë: Duam rritje pagash, përshkallëzim nëse s’na plotësohet kërkesa \(VIDEO\) - Shqiptarja.com.](#) <https://www.youtube.com/watch?v=oorqUx4O0wY>

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike³⁸;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 “*Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 107, datë 9. 2. 2011 “*Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe përfaqësuesit të punëmarrësve*”.

KONKLUZIONE

Nisur nga shqyrtimi i akteve dhe dokumentacionit të sjellë pranë KMD, pavarësisht se ankuesi nuk ka pretenduar diskriminim për shkak të deklaramit/qëndrimit publik të bërë në media, Komisioneri gjykon se, pas analizimit të akteve, deklarimeve të palëve, fakteve dhe rrethanave në tërësinë e tyre, duhet të mbajë në konsideratë dhe të vlerësojë kryesisht këtë shkak, klasifikuar si “*çdo shkak tjetër*”, në listën e shkaqeve të LMD-së, i cili përbën shkak, për të cilin Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ofron mbrojtje.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se lirimi i tij nga detyra, ka ardhur pikërisht për shkakun e konstatuar kryesisht, nga KMD, për shkak të deklarimeve apo qëndrimeve publike të H.M., lidhur me konfliktin që ka pasur me Administratorin e Uzinës së Ferrokromit Burrel, deklarime për të cilin vetë punëdhënësi/Shoqëria “Albchrome”, ka dëshmuar e pranuar se ka shërbyer si motivacion për largimin e ankuesit nga detyra.

Në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, ky justifikim i përdorur nga Shoqëria “Albchrome” për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtën e tij kushtetuese për lirinë e shprehjes.

Është e pajustificuar që ankuesit në cilësinë si palë e prekur në konfliktin e datës 16.02.2022, t’i mohohet e drejta e fjalës në publik dhe liria e shprehjes, për një çështje që ai e konsideron të drejtë

³⁸ Rezoluta 2200A(XXI) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, miratuar më 16 dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 23 mars 1976, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991.

dhe ka mbështetjen edhe të punonjësve të tjerë, të cilët në protestën dhe deklaratimet e bëra në datë 07.02.2024, kanë kërkuar dhe përmirësimet e kushteve të punës nga ana e Shoqërisë “Albchrome”.

Komisioneri gjykon se, shfaqja dhe bërja publike e mendimeve, opinioneve, problematikave dhe të metave, në një vend demokratik nuk mund të konsiderohen si deklaratime që prishin imazhin e Shoqërisë, pasi njohja me problemet që shqetësojnë punonjësit e Shoqërisë, i shërben mbrojtjes dhe përmirësimit të kushteve të punës të punonjësve.

Megjithatë, Komisioneri evidenton faktin se, në raste të veçanta edhe liria e shprehjes ka kufizimet e saj, veçanërisht kur shfaqet në formën e shpifjes, përhapjes së panikut apo edhe gjuhës së urrejtjes. Por, siç rezultoi, Shoqëria “Albchrome”, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në organet kompetente që të dëshmonte se e ka konsideruar lirinë e shprehjes të përdorur nga ankuesi, si jo ligjore apo që ajo të kishte sjellë pasoja konkrete negative, për vetë Shoqërinë apo për punonjësit e Shoqërisë.

Bazuar në aktet shkresore të vëna në dispozicion nga palët, deklaratimet e tyre, si dhe në analizën ligjore të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës mes punëmarrësit/subjektit ankues dhe punëdhënësit/Shoqërinë “Albchrome”, Komisioneri krijon bindjen se, procedura e ndjekur për largimin e ankuesit nga puna, nuk motivohet nga shkaqe ligjore dhe nuk ndjek një qëllim të ligjshëm apo të jetë e justifikuar objektivisht. Përkundrazi ajo bie ndesh dhe është në kundërshtim me gjithë mbrojtjen ligjore që parashikohet nga legjislacioni kombëtar e ndërkombëtar, përse i takon gëzimit të së drejtës së ankuesit për t’u shprehur, për të informuar publikun lidhur me qëndrimin e tij personal, si palë e dëmtuar në ngjarjen e datës 16.02.2022.

Duke iu referuar faktit të gjithë pranuar nga palët në proces, se largimi i tij nga puna ka ardhur pikërisht se ai ka dalë publikisht në media, me deklaratat personale dhe qëndrimin e tij lidhur me ngjarjen e datës 16.02.2022³⁹, Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga ky qëndrim i tij dhe se atij i është cenuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është liria e shprehjes.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Shoqëria “Albchrome” ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të deklaratimeve të tij publike në media.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit H.M., në të drejtën për punësim, për shkak të

³⁹ Pavarësisht interpretimit dhe kuptimit të ndryshëm nga palët: Shoqëria “Albchrome” nënkupton se ankuesi ka shfrytëzuar intervistën për të kërcënuar dhe fajësuar indirekt Shoqërinë për neglizhencë në mos marrje të masave ndaj Drejtorit të Uzinës, ndërsa ankuesi referon se ankohet për vendimin e gjykatës që po i vonohet dhe për mënyrën se si është trajtuar në punë.

deklaratave/qëndrimeve të tij në media, nga ana e Shoqërisë Albchrome shpk.

- Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankuesit H.M., në të drejtën për punësim nga E.I., në cilësinë si drejtues i Uzinës së Ferrokromit Burrel.
- Në referim të pikës 1, Shoqëria “Albchrome” sh.p.k., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës.

39. A.P., kundër Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.

VENDIM NR. 307, DATË 18.12.2024

Shkaku: Çdo shkak tjetër/“*për shkak të deklaratave/qëndrimeve të tij në media*”
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, duke u larguar nga puna për shkak të deklaratave/qëndrimeve të tij në media ndaj Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.

FAKTET

A.P., në datë 19.03.2021, ka filluar punë si “Mbledhës Fe-Cr”, pranë Uzinës së Ferrokromit Burrel. Nga data 01.08.2021, deri më datë 06.03.2024, ankuesi ka mbajtur pozicionin e Derdhësit.

Rezulton se në datë 16.02.2022, mes H.M., dhe Administratorit të Uzinës, E.I., ka pasur një konflikt fizik, i cili është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Gjatë procesit gjyqësor, ankuesi dhe 6 (gjashtë) punonjës të tjerë të Uzinës së Ferrokromit Burrel, kanë dëshmuar lidhur me ngjarjen.

Në vijim, ankuesi nuk është promovuar në detyrë nga ana e Administratorit Lokal i Uzinës së Ferrokromit Burrel edhe pas kërkesave të eprorëve të tij.

Në datë 02.02.2024, A.P., nëpërmjet medias ka bërë një deklaratë me video, e cila më pas është pasqyruar në media të ndryshme online⁴⁰. Në datë 07.02.2024, punonjësit e Uzinës së Ferrokromit Burrel kanë dalë në protestë⁴¹ për të kërkuar përmirësimin e kushteve të punës, rritje të pagës dhe largimin e drejtorit për një incident të dy viteve më parë.

Në këtë protestë ka marrë pjesë dhe ankuesi, i cili ka deklaruar për mediat të njëjtat parashtrime si në datën 02.02.2024, si dhe ndër të tjera ka kërkuar largimin e E.I., dhe ka cituar faktin që ky i fundit shantazhon punonjësit për shkak se ata nuk janë pjesë e sindikatës që Shoqëria “Albchrome” ka nënshkruar Kontratën Kolektive.

⁴⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=IxG409rI-mk>
<https://alfapress.al/aktualitet/dhunoi-punetorin-denohet-nga-gjykata-drejtori-i-ufk-burrel-shantazhon-i93980>
<https://faxweb.al/dhunoi-punetorin-denohet-nga-gjykata-drejtori-i-ufk-burrel-shantazhon-deshmitare/>
<https://dosja.al/aktualitet/dhunoi-punetorin-denohet-drejtori-i-uzines-ne-burrel-shantazhon-deshm-i350627>
<https://zeri.ai/aktualitet/dokument-kapi-per-fyti-punetorin-denonet-nga-gjykata-drejtori-i-ufk-b-i191494>

⁴¹ [Burrel/ Metalurgët në protestë: Duam rritje pagash, përshkallëzim nëse s'na plotësohet kërkesa \(VIDEO\) - Shqiptarja.com](#); <https://www.youtube.com/watch?v=oorgUx4O0wY>

Pas daljes publike në media, ankuesi është thirrur nga ana e punëdhënësit dhe ndaj tij është marrë masa disiplinore e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike⁴²;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 *“Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 107, datë 9. 2. 2011 *“Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe përfaqësuesit të punëmarrësve”*.

KONKLUSIONE

Nisur nga shqyrtimi i akteve dhe dokumentacionit të sjellë pranë KMD, pavarësisht se ankuesi nuk ka pretenduar diskriminim për shkak të deklaramit/qëndrimit publik të bërë në media, Komisioneri gjykon se, pas analizimit të akteve, deklarimeve të palëve, fakteve dhe rrethanave në tërësinë e tyre, duhet të mbajë në konsideratë dhe të vlerësojë kryesisht këtë shkak, klasifikuar si *“çdo shkak tjetër”*, në listën e shkaqeve të LMD-së, i cili përbën shkak, për të cilin Ligji Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ofron mbrojtje.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se lirimi i tij nga detyra, ka ardhur pikërisht për shkakun e konstatuar kryesisht, nga KMD, për shkak të deklarimeve apo qëndrimeve publike të A.P., lidhur me konfliktin që ka pasur me Administratorin e Uzinës së Ferrokromit Burrel, deklarime për të cilin vetë punëdhënësi/Shoqëria *“Albchrome”*, ka dëshmuar e pranuar se ka shërbyer si motivacion për largimin e ankuesit nga detyra.

⁴² Rezoluta 2200A(XXI) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, miratuar më 16 dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 23 mars 1976, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991.

Në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykoi se, ky justifikim i përdorur nga Shoqëria Albchrome për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtën e tij kushtetuese për lirinë e shprehjes.

Është e pajustificuar që ankuesit në cilësinë dëshmitarit në konfliktin e datës 16.02.2022, t'i mohohet e drejta e fjalës në publik dhe liria e shprehjes, për një çështje që ai e konsideron të drejtë dhe ka mbështetjen edhe të punonjësve të tjerë, të cilët në protestën dhe deklaratimet e bëra në datë 07.02.2024, kanë kërkuar dhe përmirësimet e kushteve të punës nga ana e Shoqërisë “Albchrome”.

Komisioneri gjykoi se, shfaqja dhe bërja publike e mendimeve, opinionëve, problematikave dhe të metave, në një vend demokratik nuk mund të konsiderohen si deklarime që prishin imazhin e Shoqërisë, pasi njohja me problemet që shqetësojnë punonjësit e Shoqërisë, i shërben mbrojtjes dhe përmirësimit të kushteve të punës të punonjësve.

Megjithatë, Komisioneri evidentoi faktin se, në raste të veçanta edhe liria e shprehjes ka kufizimet e saj, veçanërisht kur shfaqet në formën e shpifjes, përhapjes së panikut apo edhe gjuhës së urrejtjes. Por, siç rezultoi, Shoqëria “Albchrome”, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në organet kompetente që të dëshmonte se e ka konsideruar lirinë e shprehjes të përdorur nga ankuesi, si jo ligjore apo që ajo të kishte sjellë pasoja konkrete negative, për vetë Shoqërinë apo për punonjësit e Shoqërisë.

Bazuar në aktet shkresore të vëna në dispozicion nga palët, deklaratimet e tyre, si dhe në analizën ligjore të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës mes punëmarrësit/subjektit ankues dhe punëdhënësit/Shoqërinë “Albchrome”, Komisioneri krijon bindjen se, procedura e ndjekur për largimin e ankuesit nga puna, nuk motivohet nga shkaqe ligjore dhe nuk ndjek një qëllim të ligjshëm apo të jetë e justifikuar objektivisht. Përkundrazi ajo bie ndesh dhe është në kundërshtim me gjithë mbrojtjen ligjore që parashikohet nga legjislacioni kombëtar e ndërkombëtar, përse i takon gëzimit të së drejtës së ankuesit për t'u shprehur, për të informuar publikun lidhur me qëndrimin e tij personal, si dëshmitar në ngjarjen e datës 16.02.2022.

Duke iu referuar faktit të gjithë pranuar nga palët në proces, se largimi i tij nga puna ka ardhur pikërisht se ai ka dalë publikisht në media, me deklarata personale dhe qëndrimin e tij lidhur me ngjarjen e datës 16.02.2022⁴³, Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga ky qëndrim i tij dhe se atij i është cenuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është liria e shprehjes.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Shoqëria “Albchrome” ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, nuk ka

⁴³ Pavarësisht interpretimit dhe kuptimit të ndryshëm nga palët: Shoqëria “Albchrome” nënkupton se ankuesi ka shfrytëzuar intervistën për të kërcënuar dhe fajësuar indirekt Shoqërinë për neglizhencë në mos marrje të masave ndaj Drejtorit të Uzinës, ndërsa ankuesi referon se ankohet për vendimin e gjykatës që po i vonohet dhe për mënyrën se si është trajtuar në punë.

ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkak të deklarimeve të tij publike në media.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit A.P., në të drejtën për punësim, për shkak të deklaratave/qëndrimeve të tij në media, nga ana e Shoqërisë “Albchrome” sh.p.k.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankuesit A.P., në të drejtën për punësim nga E.I., në cilësinë si drejtues i Uzinës së Ferrokromit Burrel.
- Në referim të pikës 1, Shoqëria “Albchrome” sh.p.k., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës.

XII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMEN NDËRSEKTORIALE

40. Z.T., kundër FSDKSH, MSHMS

VENDIM NR. 30, DATË 31.01.2024

Shkaku: Gjendje shëndetësore, Aftësia e kufizuar, Gjendje ekonomike
Forma: Diskriminim në formën e rëndë të tij dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi në vitin 2021 është diagnostikuar me sëmundjen “xxxxxx”, në stadin 3/A, dhe për trajtimin e saj i është nënshtruar kimioterapisë për një periudhë kohore 6 mujore. Nga mjekët i është rekomanduar trajtimi me lenalidomide, medikament i cili nuk përfshihet në listën e ilaçeve për trajtim spitalor dhe as në listën e ilaçeve të rimbursueshme dhe është shumë i kushtueshëm për mundësitë e tij financiare.

FAKTET

Subjekti ankues është shtruar për herë të parë në QSUNT, pranë Shërbimit të Hematologjisë me datë 10.12.2021, me numër statistikor A208842 dhe është diagnostikuar me “xxxxxx”, Stadi III/B IgG/Lambda në momentin e diagnozës (prognozë e keqe).

Pacientit i është filluar mjekimi sipas protokollit VED dhe ka bërë gjashtë cikle të plota. Në muajin shkurt 2023, konfirmohet progresion i sëmundjes dhe vendoset të fillohet mjekimi në linjë të dytë, sipas skemës VLD, dhe në kushtet kur mungon Lenalidomidi, fillohet skema zëvendësuese VAD.

Pacienti ka siguruar privatisht, barin Lenalodome dhe në këto kushte është filluar trajtimi sipas skemës VLD, kur është prezantuar për ciklin e dytë VAD, dhe me vete ka pasur Lenalidomidin e siguruar nga ai personalisht. Në këto kushte, ka kryer 3 cikle të mjekimit me VLD, me një ndërprerje mes ciklit të parë dhe të dytë, për shkak të pneumonisë, të kaluar në muajin mars 2023. Ka rezultuar në fund të muajit maj 2023, pa përgjigje ndaj mjekimit. Në muajin gusht 2023 pacienti është hospitalizuar në spitalin e Korçës me rëndim të gjendjes së përgjithshme dhe transferohet për vijimin e terapisë në Shërbimin e Hematologjisë, ku vërehet gjendje shumë e rënduar dhe progresion i sëmundjes dhe ka vijuar trajtimi i tij.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, të merren masat e nevojshme për zgjidhjen e problematikës së tij, lidhur me përfitimin e rimbursimit të medikamentit lenalidomide.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁴⁴
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 *“Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 107, datë 30.03.2009, *“Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar⁴⁵;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Rezoluta WHA70.12, *“Parandalimi dhe kontrolli i kancerit në kontekstin e një qasje të integruar”*;
- VKM Nr.135, datë 20.02.2013 *“Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime”*;
- Plan i Kombëtar i kontrollit të kancerit 2021-2031.

KONKLUZIONE

Komisioneri gjykoi se, pavarësisht se pretendimet e subjektit ankues orientohen kundër subjektit/FSDKSH, për mospërfshirjen e barit Lenalidomide në LBR, (referuar ankesës me nr. 154 regj., datë 18.07.2023, pranë KMD-së), gjatë procedurës për shqyrtimin e hetimin e këtij rasti, ka vlerësuar se, nisur nga sensibiliteti i problematikës, dinamika e ngjarjeve, kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve respektive, të përfshijë si palë kryesisht në këtë proces (përveç FSDKSH-së) edhe subjektet: MSHMS dhe QSUNT.

Njëherësh, Komisioneri vlerësoi se, nisur nga natyra e veçantë e rëndësia që mbart problematika e ngritur nga subjekti ankues, si dhe fakti që ajo prek një grup të caktuar personash (pacientësh të diagnostikuar me MM), në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, KMD shprehet, krahas ankuesit edhe për të gjithë kategorinë e personave të diagnostikuar me xxxxx, të ndodhur në kushte të njëjta me të, përsa i takon të drejtës së tyre për të përfituar nga të mirat dhe shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin e jetën, specifikisht përsa i takon ofrimit falas të trajtimit me barin Lenalidomide, sipas rekomandimeve përkatëse të mjekut specialist të fushës: qoftë përsa i takon ofrimit të këtij bari nga QSUNT, në rastet kur pacientët janë të hospitalizuar dhe e kryejnë trajtimin pranë QSUNT-së (pra, kur barin duhet ta ofrojë vetë qendra spitalore), qoftë për rastet kur ata e

⁴⁴ Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

⁴⁵ Neni 2 i Ligjit Nr. 10 107, datë 30.3.2009, *“Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, (i ndryshuar), parashikon: *“Kujdesi shëndetësor udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: a) e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e individit; b) garantimi i të drejtave të barabarta në kujdesin shëndetësor, bazuar në mosdiskriminim; c) sistemi i kujdesit shëndetësor funksionon mbështetur në efikasitet dhe cilësinë e shërbimit, duke garantuar sigurinë e pacientit dhe paanësinë; ç) pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm, pacientëve, konsumatorëve dhe qytetarëve; d) llogaridhënia ndaj qytetarëve.”*

kryejnë trajtimin në kushtet e shtëpisë (jashtë QSUNT-së), sipas rekomandimeve të mjekut specialist që i ndjek, duke e blerë atë në çdo farmaci që e disponon, duke e përfituar atë me rimbursim si pjesë e LBR-së.

Komisioneri gjykon se, është përgjegjësi direkte e MSHMS-së, (pasi sikurse e pranon vetë përmes pohimit se, për të përfshirë këtë bar në listën e barnave të shërbimit spitalor, nevojitet një kërkesë e motivuar nga ana e shërbimit përkatës, e cila është realizuar nga ana e QSUNT-së) që të veprojë e bëjë të mundur përfshirjen e barit Lenalidomide në listën e barnave të shërbimit spitalor, për të siguruar që pacientët me xxxxx, të marrin trajtimin e duhur me medikamente, bazuar në protokollin e përcaktuar nga mjeku specialist i fushës (në rastin konkret nga mjeku hematolog).

Komisioneri konsideron të pajustificuar dhe të pambështetur në argumenta përgjigjen e MSHMS-së, se në mungesë të këtij bari, ka terapi zëvendësuese, kjo për arsye se:

Protokolli i trajtimit të pacientëve me xxxxx, miratuar nga vetë MSHMS, përfshin trajtimin e tyre sipas skemave të caktuara mjekësore, duke kombinuar ilaçet, varësisht dhe të kushtëzuara nga stadi në të cilën ndodhet sëmundja, nga mosha e pacientit apo dhe shumë karakteristika të tjera, të cilat analizohen nga mjeku specialist që ndjek pacientët me xxxxx, rast pas rasti dhe sipas karakteristikave të secilit. Për rrjedhojë, është mjeku ai që përcakton se cila skemë është më e përshtatshme dhe më efektive për pacientin me xxxxx, në një fazë të caktuar të trajtimit të tij. Nëse mjeku specialist (siç ka ndodhur në rastin e subjektit ankues) rekomandon se skema në të cilën është përfshirë bari Lenalidomide është më efektive, atëherë ajo duhet zbatuar për më shumë efektshmëri dhe përmirësim të cilësisë së jetës së pacientit (pavarësisht faktit se ky trajtim nuk është jetëshpëtues).

Në rastin e subjektit ankues, mjekja A.P., pranoi se skema më efektive për trajtimin e subjektit ankues është ajo me barin Lenalidomide, dhe se ky bar nuk disponohet nga QSUNT-ja, por për interesin e shëndetit e jetës së pacientit është e detyruar t'ia komunikojë e rekomandojë atë. Por, nga ana tjetër, mjekja pranoi faktin se QSUNT-ja, në rast të pamundësisë për ofruar këtë bar, si dhe të pamundësisë së vetë pacientit për të siguruar atë privatisht, ofron në çdo rast aplikimin e skemës tjetër alternative, në mungesë të barit Lenalidomide, por duke pranuar dhe duke i bërë të ditur pacientit se ky trajtim është më pak efektiv se trajtimi që do ti ofronte skema me barin Lenalidomide.

Referuar shkresës me Nr. 1535/10 Prot., datë 24.10.2023, të Shërbimit të Hematologjisë/QSUNT, lidhur me trajtimin e subjektit ankues, nga Shefi i këtij Shërbimi citohet se: *"... lidhur me kërkesën e Komisionerit, nëse ka medikamente të tjera, të cilat kanë efekt të njëjtë me barin Lenalidomide për trajtimin e xxxxx, sqarojmë se medikamentet nuk përdoren në monoterapi, por të kombinuara, dhe se, kombinimet me Lenalidomide është vërtetuar se janë më efikase se kombinimet e tjera në trajtimin e xxxxx, psh: VLD, Dara-VLD etj, ku VLD (velcade, lenalidomide, dexametaxon) është konfirmuar se ka të njëjtën jetëgjatësi me kombinimet ku përfshihet dhe autotransplanti i palcës.)*

Pra, Komisioneri vlerësoi se, përgjegjësinë nëse duhet përdorur apo jo dhe momentin kur duhet aplikuar trajtimi mjekësor sipas skemës ku përfshihet kombinimi me barin Lenalidomide, duhet ta ketë vetëm mjeku specialist që trajton pacientin, dhe për sa kohë ky bar është pjesë e protokollit të miratuar nga MSHMS, për trajtimin e pacientëve me xxxx, ai duhet ofruar në mënyrë të vazhdueshme, sa herë të jetë e nevojshme, nga strukturat përgjegjëse, sipas rekomandimeve përkatëse të specialistëve të fushës.

Komisioneri gjeti të pa arsyetuar edhe qëndrimin e MSHMS-së, lidhur me pohimin se fondi financiar/ buxheti nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar një kërkesë të tillë.

Referuar informacionit të administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton e pranuar nga të gjitha palët në këtë proces se, deri aktualisht, bari Lenalidomide (*për përdorimin në trajtimin mjekësor të pacientëve me xxxxx*) nuk është një bar që përfshihet në listën e barnave të rimbuesueshëm (LBR).

Komisioneri gjykoi se, është përgjegjësi direkte e FSDKSH-së dhe strukturave përkatëse të saj që të miratojë projektin e paketave të propozuara nga komisionet teknike dhe t'ia dërgojë, përcjellë Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për procedim pranë Këshillit të Ministrave, shoqëruar me një raport financiar për mundësitë e mbulimit financiar nga Fondi të shërbimeve të paketave të propozuara. Miratimi i të cilave bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Komisioneri vlerësoi se, ankuesi dhe të gjithë personat në kushte të njëjta më të (diagnostikuar me xxxxx), janë cenuar dhe cenohen në të drejtën e tyre për trajtimin e duhur mjekësor me barin Lenalidomide, (në kushtet kur ky bar rekomandohet për trajtim nga mjeku specialist por nuk përfshihet në LBR, në mënyrë që të përfitohet me rimbursim nga pacienti) nga ana e institucionit përgjegjës për masat e veprimet që duhen ndërmarrë për përfshirjen e tij në LBR, që është FSDKSH.

Nga analizimi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykoi se, FSDKSH, me mosveprimin e saj, (lidhur me finalizimin e këtij propozimi duke e përcjellë tek struktura përkatëse, MSHMS) i ka ekspozuar pacientët me xxxxx, ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues, duke i mohuar atyre mundësinë për përfitimin me rimbursim të barit Lenalidomide, bar i cili do të ndikonte në trajtimin e duhur mjekësor të tyre, sipas rekomandimeve të mjekut specialist, duke u garantuar edhe një shërbim mjekësor të duhur e me dinjitet.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, në fomën e rëndë të tij dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, të subjektit ankues, Z.T., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si pasojë e mos garantimit të trajtimit të duhur shëndetësor, me medikamentin Lenalidomide, si shkak i mospërfshirjes së tij në listën e barnave për shërbimin spitalor.

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes shëndetësore, të të gjithë pacientëve me xxxx, në Republikën e Shqipërisë, (në kushte të njëjta me ankuesin) nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si pasojë e mos garantimit të trajtimit të duhur shëndetësor të tyre, me medikamentin Lenalidomide, si shkak i mospërfshirjes së tij në listën e barnave për shërbimin spitalor.
- Konstatimin e diskriminimit, në formën e rëndë të tij dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, të subjektit ankues, Z.T., nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), si pasojë e mos garantimit të trajtimit të duhur shëndetësor, me medikamentin Lenalidomide, si shkak i mosveprimit e mospërmbyshjes së detyrimit për miratimin e listës së barnave të rimbursueshme, ku të jetë i përfshirë edhe bari Lenalidomide, dhe përcjellen e saj Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për veprime të mëtejshme.
- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes shëndetësore, të të gjithë pacientëve me xxxxx, në Republikën e Shqipërisë, (në kushte të njëjta me ankuesin) nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), si pasojë e mos garantimit të trajtimit të duhur shëndetësor të tyre, me medikamentin Lenalidomide, si shkak i mosveprimit e mospërmbyshjes së detyrimit për miratimin e listës së barnave të rimbursueshme, ku të jetë i përfshirë edhe bari Lenalidomide, dhe përcjellen e saj Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për veprime të mëtejshme.
- Referuar pikave 1, 2, 3 dhe 4, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga të dy institucionet e MSHMS-së dhe FSDKSH-së, për zbatimin e sa më sipër.

41. K.A., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Lezhë.

VENDIM NR. 221, DATË 07.08.2024

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë dhe aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminimi në formën e rëndë dhe ndërsektorial
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces

Subjekti ankues dhe të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, janë diskriminuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me mosmarrjen e masave për ofrimin e njëjtë të shërbimit mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke u kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë.

FAKTET

Ankuesi, shtetasi K.A., referuar diagnozës së vendosur nga mjekët specialistë neuropsikiatër, është person me çrregullime të shëndetit mendor, prej më shumë se 20 (njëzet) vitesh. Në vitin 2020, ankuesi është arrestuar nga ana e Komisarariatit të Policisë Mirditë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit publik” dhe “Shkatërrim prone”, të parashikuara në nenin 236/2 e 150 të Kodit Penal.

Për këtë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur, caktimin e masës mjekësore “*mjekim i detyruar në një institucion mjekësorë*” për shtetasin K.P.A. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga ana e palës ankuese. Sakaq, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të dhënë ndaj të gjykuarit K.P.A. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë.

Në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, K.A., është vendosur fillimisht në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Krujë dhe më datë 27.11.2021, është transferuar nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, ku dhe ndodhet aktualisht.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Raporti i Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se institucionet kundër së cilave u adresua çështja (DPB, MD, MSHMS dhe IEVP Lezhë) ishin në dijeni të problematikës së shtetasit K.A., dhe personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të, dhe se kishin dështuar deri më tani të ndërmerrnin masat e duhura konkrete për zgjidhjen përfundimtare të situatës, gjë e cila pranohej edhe prej tyre.

Pavarësisht argumentit të sjellë nga palët e përfshira: DPB, MD, MSHMS se nga ana e tyre po punohet për hartimin e planeve afatshkurtëra dhe afatgjata për zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike dhe ndërtimit të një institucioni të veçantë mjekësor, gjë e cila sigurisht vlerësohet si një masë pozitive nga ana e Komisionerit; situata “de facto” e shtetasit K.A., nga viti 2021 e deri aktualisht mbetet e njëjtë. Pra, ai vijon të mbahet dhe trajtohet në ambjentet e IMP Lezhë, në kushte thuasje të ngjashme apo të njëjta me një institucion penitenciar, pavarësisht përmirësimeve të shtimit të stafit mjekësor apo dhe kushteve të tjera. Si ankuesi, rezultoi se ndodheshin edhe 445 shtetas të tjerë të akomoduar po aty. Për këta shtetas gjykata ka vendosur masën mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”.

Në kontekst të sa më sipër, ekzekutimi nga ana e prokurorisë i masave mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik” bie ndesh me parashikimet e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar (*për sa kohë nuk kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor që t’i deklarojë këta shtetas fajtorë për kryerjen e ndonjë vepre penale apo të ketë caktuar kufizimin e përkohshëm të lirisë së tyre*). Shtetasit, ndaj të cilëve është dhënë masa mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, vijojnë të mbahen në ambjentet e IMP Lezhë, duke iu mohuar shërbimin mjekësor në përputhje me protokollin e miratuar të çrregullimeve të shëndetit mendor.

Njëkohësisht ndesh me legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar bie dhe Ministria e Drejtësisë e cila mban në institucionet në varësi të saj, në mënyrë të paligjshme shtetas me kufizime të aftësisë mendore.

Pra, siç rezulton qartazi, subjekti ankues (*dhe të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të*) është diskriminuar në raport me personat e tjerë me çrregullime të shëndetit mendor që kurohen dhe trajtohen në spitalet psikiatrike të sektorit publik. Ankuesit dhe pacientëve të tjerë të akomoduar në sistemin e IMP Lezhë, pavarësisht përmirësimit të kushteve dhe kthimit të tij në një institucion mjekësor të posaçëm, nuk u ofrohet i njëjti shërbim mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke u kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë. Legjislacioni nuk i konsideron këta shtetas si persona me çrregullime të shëndetit mendor të përgjeshëm dhe pikërisht, ekzekutimi i masës mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” “de jure” dhe “de facto” bie ndesh me parashikimet ligjore të legjislacionit të brendshëm dhe standardet e vendosura në legjislacionin ndërkombëtar, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të formës së prerë që t’i deklarojë këta shtetas fajtorë për kryerjen e ndonjë veprë penale apo që të ketë caktuar kufizimin e përkohshëm të lirisë së tyre në ambientet e sistemit penitenciar.

Komisioneri, vlerësoi se shkak i përkatësisë në një grup të veçantë dhe aftësisë së kufizuar, veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme me njëri-tjetrin, duke e ekspozuar subjektin ankues ndaj trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, Komisioneri arriti në përfundimin se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe aftësisë së kufizuar, subjektin ankues të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, lidhur me mosmarrjen e masave për ofrimin e njëjtë të shërbimit mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke u kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë.

VENDIMI

- Në referim të pikës 1, MSHMS me bashkëpunimin e MD, deri në ngritjen e një institucioni të posaçëm përfundimtar:
 - ✓ Të marri të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen e ambienteve të Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë⁴⁶, sipas legjislacionit të cituar më sipër në këtë vendim, për akomodimin e shtetasve me vendim gjykate me masë mjekësore “Shtrim i detyruar në një institucion psikiatrik”, si një institucion i posaçëm mjekësor.
 - ✓ T’a pajisë atë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe të domosdoshme mjekësore dhe plotësimin e personelit të specializuar mjekësor dhe psiko-social.
- Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, MSHMS, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

⁴⁶Referuar paragrafit III, faqe 6 e vendimit.

- Rekomandohet sërish Prokuroria e Përgjithshme të udhëzojë në mënyrë të qartë të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, si dhe pranë gjykatave të Apelit, për zbatimin në mënyrë korrekte të Ligjit “*Për ekzekutimin e vendimeve penale në RSH*”, konkretisht, për zbatimin në mënyrë të ligjshme të vendimeve të gjykatës lidhur me masën mjekësore “*Mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik*”.

**42. V.Xh., kundër Kopshtit Nr. 2, Tiranë dhe Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore
pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve/Bashkia Tiranë**

VENDIM NR. 322, DATË 23.12.2024

Shkaku: Përgjegjësia prindërore dhe gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim në formën e udhëzimit për diskriminim, në formën e shoqërimit,
dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Nuk ka rekomandim

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Kopshtin nr. 2, Tiranë. Asaj i janë zgjidhur në mënyrë të padrejtë marrëdhëniet e punës, duke e diskriminuar për shkak të përgjegjësisë prindërore dhe të gjendjes shëndetësore të fëmijës së saj të mitur.

FAKTET

Ankuesja është emëruar mësuese pranë Kopshtit Nr. 2, Tiranë, marrëdhënie e cila është formalizuar nëpërmjet kontratës individuale të punës me Nr. 28/1 Prot., datë 24.10.2023, mes saj si punëmarrëse dhe Kopshtit Nr. 2, Tiranë⁴⁷, si punëdhënës.

Me Vendimin “Për marrjen e masës disiplinore”, Drejtori i Kopshtit Nr. 2, Tiranë, ka vendosur: *“T’i jepet masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, për V. Xh, me pozicion mësuese në Kopshtin nr. 2, me motivacionin: “Shkelje e rëndë e Kodit të Etikës dhe Sjelljes dhe mospërmbushje të detyrave funksionale që dikton pozicioni i punës, në mënyrë të përsëritur.”*

Ankuesja pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore, pranë DPÇK/Bashkia Tiranë, veprime të cilat pasqyrohen në masën disiplinore të dhënë kundrejt saj, paralajmërim për largim nga puna. V.Xh., pretendon se veprimet dhe sjellja diskriminuese kundrejt saj ka ardhur si pasojë e mungesës në punë për shkak të gjendjes shëndetësore të djalit minore, i cili ka qenë i shtruar në spital.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të konstatojë diskriminim të saj në marrëdhëniet e punësimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolli 12 i saj;

⁴⁷ Përfaqësuar nga Drejtorja e këtij Institucioni parashkollor, L.D.

- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Lidhur me veprimet e punëdhënësit lidhur me procedurën e ndjekur për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” kundrejt ankueses, Komisioneri vlerësoi se:

Vendimi “Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, për V.Xh., me pozicion mësuese në Kopshtin Nr. 2, me motivacionin: “Shkelje e rëndë e Kodit të Etikës dhe Sjelljes dhe mospërmbyllje të detyrave funksionale që dikton pozicioni i punës, në mënyrë të përsëritur”, nga ana e punëdhënësit, është tërësisht në shkelje të procedurës për dhënien e masave disiplinore, i pajustificuar, dhe krijon dyshimin e arsyeshëm se Drejtuesja e Kopshtit ka patur konflikt me ankuesen, pasi ka paraqitur ankesë kundër saj dhe po vetë si pjesë e KD-së, ka dhënë masë disiplinore.

Lidhur me veprimet e Drejtores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (DBNJSHM) pranë DPÇK-së, gjatë procedurës së ndjekur për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” kundrejt ankueses, Komisioneri vlerësoi se, Drejtorja e DBNJSHM/DPÇK, në tejkalim të detyrës së saj funksionale ka marrë pjesë në procedurën në fjalë dhe ka ndikuar drejtëpërsëdrejti në dhënien e masës disiplinore ndaj ankueses, fakt i cili provohet edhe nga dokumentacioni i mbajtur gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore kundrejt ankueses.

Sipas regjistrimit audio të transmetuar në emisionin Stop të datës 04.10.2024, Sh., shprehet se: “... unë arrij të sjell një njeri tjetër që të mos e dëgjoj më fjalën raport ... mundësisht një vajzë të re, që të mos ketë fëmijë ... unë si Burime Njerëzore nuk kam çka flas më ... e kam vendosur”.

Komisioneri thekson faktin se, përderisa regjistrimi audio dhe përmbajtja e komunikimeve të transmetuara në emisionin Stop (sipërcituar) nuk kontestohen për vërtetësinë e tyre dhe nga ana tjetër përputhet dhe lidhet si me deklaratimet e ankueses, por edhe me faktet e tjera shkresore, atëherë, ky regjistrim merret si provë nga Komisioneri dhe shqyrtohet në raport dhe në lidhje me provat e tjera.

Punëdhënësi dhe Drejtorja e DBNJSHM-së, kanë parashtruar si argumenta para Komisionerit se, arsyet për dhënien e masës disiplinore kundrejt ankuses, ishin për shkak të *shkeljes së rëndë të kodit të etikës dhe sjelles dhe mospërmbushje të detyrave funksionale në mënyrë të përsëritur*; ndërkohë që, gjatë shqyrtimit të çështjes, u provua e faktua e kundërta e pretendimeve të tyre kundrejt ankuses.

Komisioneri vlerësoi se, subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Drejtores së DBNJSHM/DPÇK-së, lidhur me pjesëmarrjen e ndikimin e saj të paligjshëm dhe dhe të pajustificuar, gjatë procedurës së ndjekur nga punëdhënësi, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” kundrejt mësueses V.Xh.

Sh ka arritur të ndikojë, “udhëzojë” drejtëpërsëdrejti në dhënien e masës disiplinore ndaj ankuses, duke përfutur nga pozicioni hierarkik më i lartë, në raport me Drejtoreshen e Kopshtit, e cila është nën vartësinë e DPÇK-së, ku Sh., mban pozicionin e Drejtores së Burimeve Njerëzore. Është pikërisht DPÇK që bën emërimin dhe vlerësimin e punës të të gjithë drejtorëve të kopshteve të Bashkisë së Tiranës, përfshirë edhe Drejtoreshen e Kopshtit nr. 2, Tiranë.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë përse i takon procedurës së ndjekur për dhënien e masës disiplinore kundrejt saj, si dhe motivacionit bazuar mbi të cilin është marrë. Në këtë kuptim, trajtimi i pafavorshëm ka nisur menjëherë pas marrjes së raporteve mjekësore për përkujdesje shëndetësore ndaj fëmijës së mitur.

Megjithatë formalisht, në vendimin e dhënë për masën disiplinore ndaj ankuses, Drejtorja e Kopshtit dhe KD, janë kujdesur që dhënien e masës ta justifikojnë me mungesën e sjelljes etike të ankuses në marrëdhëniet e punës-në fakt, në thelb dallohet qartë se motivimi real i dhënies së masës disiplinore lidhet me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga ankuesja-marrjen e raporteve mjekësore për përkujdesjen shëndetësore të fëmijës së mitur.

Në përfundim të analizës së tij, Komisioneri konstatoi se: punëdhënësi/ Kopshti Nr. 2, “Piter Pan”, Tiranë dhe Drejtorja e DBNJSHM/DPÇK-së, pranë Bashkisë Tiranë, kanë diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e saj për punësim, pasi subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, lidhur me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, bazuar jo në motivacionin e deklaruar prej tyre, por për shkak të *përgjegjësisë prindërore dhe të gjendjes shëndetësore të djalit të saj*.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit *në formën e udhëzimit për diskriminim; në formën e shoqërimit, dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial*, të ankuses V.Xh., në të drejtën për punësim, për shkak të përgjegjësisë prindërore dhe gjendjes shëndetësore të djalit të mitur, nga ana e



Kopshtit Nr. 2, “Piter Pan” Tiranë dhe Drejtores të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/DPÇK, pranë Bashkisë Tiranë.